



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë
2013**

Contact: *Tel/fax:* + 355 4 2245078; *Mob.* + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: info@zgjedhje.al; koalicioni2013@gmail.com;
Website: www.zgjedhje.al;

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

23 QERSHOR 2013

RAPORT I NDËRMJETËM II

15 Mars - 23 Maj 2013

Tiranë, më 27 Maj 2013

Mbështetur financiarisht nga:

Fondacioni Kombëtar për Demokraci – SHBA (NED-USA)

Assist Impact / USAID

OSFA SOROS

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë të KVV-së dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe ato të donatorit!

PËRMBAJTJA

	<i>faqe</i>
I. Përmbledhje ekzekutive	5
II. Konstatime	
A. Situata politike	7
B. Kuadri ligjor	7
C. Administrimi i zgjedhjeve	12
C1. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	13
C2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor	22
C3. Komisionet e Qendrave të Votimit	26
D. Listat dhe identifikimi i zgjedhësve	26
E. Regjistrimi i subjekteve politike dhe kandidatëve	31
F. Fushata zgjedhore	33
G. Media	35
H. Pjesëmarrja e grave	37
K. Vëzhguesit	38
L. Ankesat dhe apelimet	39
IV. Rekomandime	41
V. Aksioni i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë	44
VI. Fjalorth	44
 SHTOJCË	
I. Letër e Hapur: Të zgjidhet ngërçi i pakuptimtë në Komisionin	
Qëndror të Zgjedhjeve - dt. 14/05/2013	46

II. Deklaratë: Fushata zgjedhore korrekte dhe

zbatimi i ligjit domosdoshmëri për ushtrimin e lirë

të vullnetit të votuesit - dt. 18/05/2013

57

III. Deklaratë: Transparenca e financimit të subjekteve elektorale

element kyç për një proces zgjedhor ligjor, transparent

dhe të barabartë – dt. 23/05/2013

63

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Fushata elektorale zyrtare po nis në një klimë të lartë polarizimi midis dy koalicioneve të mëdha të opozitës dhe mazhorancës, në një situatë të thelluar mosbesimi midis dy partive kryesore dhe me një KQZ të cunuar dhe funksionim jo-normal të saj.
- Ecuria e procesit zgjedhor sërish ka vënë në dukje mangësi në kuadrin ligjor, si pasojë e të cilit është afektuar edhe funksionimi i organit më të lartë të administrimit të procesit, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
- Megjithëse me një kuadër ligjor të përmirësuar për pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga media, ligji zgjedhor lë hapësirë për kthimin e disa dispozitave nga kontrolluese në mjete presioni ndaj medias private.
- Megjithë përpjekjen e KQZ-së për të funksionuar normalisht megjithëse vetëm me 4 anëtarë, konstatohet se në tërësi veprimtaria e deritanishme e KQZ-së në kuadër të përgatitjes për zgjedhjet e Kuvendit të datës 23 qershor, është e paplotë dhe vendimmarrja e saj nuk e mbulon në mënyrën e duhur sferën e detyrimeve ligjore, të caktuara ndaj saj prej Kodit Zgjedhor.
- Në lidhje me zbatimin e teknologjive të reja rezultojnë të pamarrat sot e kësaj dite akte shumë të rëndësishme, madje vërehet konfuzion në këtë pikë duke rrezikuar seriozisht zbatimin e tyre në këto zgjedhje.
- KZAZ-të kanë nisur punën dhe kanë përfunduar gjithashtu edhe procesin e trajnimit, ndërkohë që përse i përket funksionimit të Komisioneve të Qendrave të Votimit si dhe të Grupeve të Numërimit të Votave, KQZ ende nuk i ka miratuar aktet përkatëse.
- Procesi i saktësimit të të dhënave të listës së zgjedhësve u shoqërua me mosrespektim afatesh dhe mospërbushje të detyrimeve ligjore nga ana e institucioneve përgjegjëse.

- Listat e kandidatëve të miratuara nga partitë kryesore politike nuk i respektojnë kuotat gjinore.
- Fushata zgjedhore ka nisur në mënyrë të gjerë, në shkelje të ligjit zgjedhor.
- Gjatë kësaj fushate janë evidentuar një sërë shkeljesh si raste të përdorimit të burimeve të administratës shtetërore, përdorimi i fëmijëve, shfrytëzimi i aktiviteteve institucionale për fushatë elektorale si dhe janë shënuar edhe incidentete.
- Media ka pasqyruar gjerësisht fushatën elektorale duke e pasqyruar në tërësi me objektivitet megjithë ngarkesat negative që ajo ka shfaqur në jo pak raste. Përdorimi i mediave sociale prej partive dhe kandidatëve po shënon një dimension të ri komunikimi me qytetarët dhe simpatizantët e tyre.
- Pavarësisht se rritja e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit të grave ka qenë kryefjala e liderëve të partive politike dhe e konventave të organizuara posaçërisht për to, rezultoi se klasa politike kreu hapa prapa në këtë drejtim.
- Kolegji zgjedhor ka shqyrtuar vetëm çështje që kanë pasur të bëjnë me regjistrimin e partive politike, të refuzuara nga KQZ-ja për shkak të mungesës në dokumentacion apo në shkeljen e afateve.

II. KONSTATIME

A. SITUATA POLITIKE

Fushata elektorale zyrtare po nis në një klimë të lartë polarizimi midis dy koalicioneve të mëdha të opozitës dhe mazhorancës, e cila pati një rritje të ndjeshme menjëherë pas kalimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim në krahun opozitar.

Ky moment thelloi akoma më shumë mosbesimin midis kampeve politike dhe sidomos midis dy partive të mëdha PD e PS, çka u shoqërua me kryerje të veprimeve të njëanshme pa i konsumuar më parë në bisedime politike për situatën e re të krijuar, duke sjellë për rrjedhojë bllokimin e funksionimit normal të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Klima në dukje mjaft optimiste për të ardhmen e fushatës zgjedhore, duke patur parasysh diskutimet në distancë të elementëve programorë që përbënin platformat elektorale të dy partive kryesore, pas këtij momenti u përmbys.

Sërish, kryefjala e axhendave politike të liderëve dhe ekipeve drejtuese të dy partive kryesore, u bë konflikti politik duke akuzuar njëri-tjetrin për prishje të qëllimshme të procesit zgjedhor.

Kjo klimë e lartë konflikti politik la mënjanë çështje serioze që duhet të adresoheshin nga institucionet përkatëse dhe aktorët politikë si listat e zgjedhësve, zbatimi i teknologjive të reja, etj, madje duke ndikuar jo pak edhe në funksionimin normal të institucioneve lokale dhe qendrore një pejsë e mirë e të cilave nisën angazhimin ndjeshëm në fushatë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se kjo klimë lehtësoi propozimin dhe miratimin e listave të kandidatëve të partive kryesore politike të cilat u miratuan sërish në momentin e fundit dhe jo vetëm që nuk iu prezantua publikut së bashku me cilësitë e tyre, por as nuk morrën miratimin e forumeve të gjera brenda partive respektive, duke sjellë në parlamentin e ardhshëm individë që gëzojnë vetëm besimin e kryetarëve të partive.

Retorika e liderëve politikë, akuzat e ndërsjellta dhe qëndrimet fyese ndaj kundërshtarëve politikë janë karakteristikat e kësaj fushate zgjedhore, e cila pavarësisht afatit ligjor të parashikuar, ka ndezuar tashmë motorët duke shënuar dhe rritje të temperaturës politike si dhe incidentet e para elektorale.

B. KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor në këtë pjesë të procesit zgjedhor, që prej muajit mars e deri në pragun e fillimit zyrtar të fushatës elektorale, është vënë në provë disa herë.

Në shumë raste nga diskutimi publik dhe politik, fajësia e problematikës i është dhënë vetë kuadrit ligjor dhe në disa raste i është dhënë zbatimit të tij.

Por ka patur dhe të tjera pika të “*dobëta*” të kuadrit ligjor që nuk janë bërë pjesë e diskutimeve publike.

Nga vëzhgimi i bërë mbi këtë tematikë, ku fajësia ndonjëherë bie mbi ligjin dhe ndonjëherë mbi zbatimin e tij, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë vëren se mangësitë ligjore janë verejtur në këto çështje:

1) Ngërçi i krijuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

Muaji prill ishte një periudhë që riformatoi jo vetëm gjendjen politike, por solli ndryshime edhe në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve.

Pas largimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim nga koalicioni mazhoritar dhe rradhitjes si forcë opozitare, Partia Demokratike investoi Kuvendin e Shqipërisë në lirimin e Komisionerit Muho me argumentimin se me rikonfigurimin politik të ndodhur, edhe KQZ-ja kishte nevojë për rikonfigurim.

Kuvendi i Shqipërisë në seancën parlamentare të datës 15.04.2013 nëpërmjet një procedure joligjore votoi për lirimin nga detyra të komisionerit Ilirian Muho, me një projekt-vendim që u ndryshua tre herë në përmbajtje, me motivacionin “*si person i shkarkuar nga funksioni publik i prokurorit me dekret të Presidenit të Republikës nr. 3727 datë 13.03.2003, duke i fshehur Kuvendit, gjatë procedurës së emërimit, deklarimin e fakteve që pengonin emërimin në detyrën e anëtarit të KQZ*”.

Në vend të tij Kuvendi po në këtë seancë emëroi z. Klement Zguri si kandidatë e propozuar nga Partia Republikane, si forca e dytë më e madhe mazhoritare në parlament.

Pas kësaj vendimmarrje të Kuvendit, në mënyrë të njëpasnjëshme dhanë dorëheqjen në shenjë proteste për këtë ndërhyrje që u quajt e paligjshme në veprimtarinë e KQZ-së, komisionerët Denar Biba, Albana Shtylla dhe më pas Jani Jani.

Pas vakancave të krijuara, forcat politike opozitare nuk paraqitën në Kuvend kandidaturat e tyre për tre vendet vakante në KQZ, në zbatim të afatit ligjor të parashikuar prej 48 orësh, madje ende nuk i kanë propozuar ato.

Sipas deklarimeve publike të kryera nga përfaqësues të opozitës, kërkohet rikompozimi i gjithë KQZ-së duke e lënë kështu funksionimin e kësaj të fundit vetëm me katër 4 anëtarë.

Në vijimësi, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi lirimin e komisionerëve të KZAZ-ve të përzgjedhur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe emërimin e komisionerëve të propozuar nga Partia Republikane.

Argumentimi i përdorur nga KQZ-ja për këto ndryshime nuk kishte bazë ligjore, por që një argumentim në frymën e Kodit Zgjedhor për të ruajtur balancimin politik.

Gjithsesi, faktorët politikë e përshëndetën dhe ranë dakort me këtë zëvendësim dhe vendimmarrje të KQZ-së.

Formulimi aktual i komisioneve të administrimit zgjedhor ka për bazë përzgjedhjen politike apo propozimin nga partitë politike, i cili është i ngjashëm me përvojën zgjedhore të viteve 1991-1997. Një periudhë, që duhej të ishte marrë parasysh për gjatë Reformës Elektorale në hartimin aktual të Kodit Zgjedhor, për hir të traditës ligjore dhe përvojës në organizimin e zgjedhjeve që ofron. Ngërçi aktual nuk do të ekzistonte nëse do të ishte marrë parasysh praktika e dekretit presidencial të vitit 1996 për ndërtimin e KQZ-së. Në këtë dekret presidencial parashikohet qartë e në mënyrë të hollësishme se nëse partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në KQZ rishpërndahen brenda grupimit përkatës.

Komisioni i Reformës Elektorale nisur nga kjo praktikë duhej ta kish parashikuar këtë rast. Madje, **vetë legjislatori nëse do ishte treguar më i matur dhe më i vëmendshëm në përvojën e patur deri më sot, i kishte të gjitha mundësitë për të mos e lejuar pikëpyetjen ligjore që krijoi ngërçe** siç është rasti se “çfarë ndodh me KQZ-në kur kemi lëvizje politike”.

Apo, çfarë ndodh me vakancat në KQZ kur ato nuk plotësohen nga subjektet që parashikon ligji, rast i cili është i parashikuar disi në krijimin e vakancave në KZAZ. Pamaturia e legjislatorit vihet re edhe tek terminologjia e përdorur në dispozitën e cila përcakton se si përzgjidhen anëtarët e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Kodi përdor **togfjalëshat “parti të shumicës parlamentare” dhe “parti të opozitës parlamentare”, të cilat janë të paverifikueshëm formalisht**, dhe ligjërisht është e pamundur të sillen si një fakt. Edhe në traditën tonë ligjore janë të pakta referencat që mund të përdoren si argumente për të ngritur vijë ndarëse midis asaj se çfarë është njëra dhe çfarë është tjetra.

Mbi këtë çështje **mangësia e dytë në ligjin zgjedhor**, është se legjislatori nuk e ka të parashikuar se çfarë ndodh, aq më tepër në një periudhë zgjedhore, **kur subjektet politike nuk paraqesin kandidaturat për vendet vakante** në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.

Ky mosparashikim i Kodit Zgjedhor, mund të përdoret lehtësisht prej subjekteve politike si një mjet në bllokimin e veprimtarisë për KQZ-në.¹

2) Pasqyrimi i fushatës zgjedhore dhe pavarësia e medias

Ndryshimet e fundit të kryera në Kodin Zgjedhor, kanë sjellë disa risi në mbulimin e fushatës zgjedhore nga operatorët mediatikë.

Në rast të mos respektimit të raporteve kohore në minutazhin politik të edicioneve informative të operatorëve privatë, tashmë nuk është vetëm Bordi i Monitorimit të Medias që i propozon KQZ-së vendosjen e gjobave, **por është vetë KQZ e cila kryesisht apo me propozimin e KZAZ-ve, në çdo kohë, ka të drejtë gjobisë operatorin radioteleviziv².**

Dispozita nuk përcakton limite të masës së shkeljes, pra mjafton që koha mos të jetë e barabartë, dhe një KZAZ ka të drejtë që t’i propozojë KQZ-së gjobitjen e një operatori televiziv.

Nga ana tjetër duke qenë se KZAZ-të mund ta marrin një vendim të tillë në gjysmën e tyre vetëm me katër vota të mazhorancës dhe në gjysmën tjetër vetëm me katër vota të opozitës, ekziston hapësira e kanosjes apo goditjes për shkaqe me natyrë politike ndaj operatorëve të ndryshëm televizivë, me gjoba të cilat sikundër parashikohen në ligj janë në shifra të konsiderueshme³.

3) Akreditimi i vëzhguesve të huaj

Udhëzimi N.13 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizata joqeveritare shqiptare dhe të huaja,

¹ Për më tepër informacion lexo Letrën e Hapur që KVV i ka dërguar Liderit të Mazhorancës z. Berisha si dhe Liderit të Opozitës z. Rama më datë 14 Maj 2013 “Të zgjidhet ngërçi i pakuptimtë në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve” tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=45&gj=sh>.

² Neni 84, pika 2 gërma “a” e Kodit Zgjedhor: “Minutazhi politik i edicioneve informative ndahet në raporte kohore, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 81 të këtij Kodi. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie, KQZ-ja, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 500 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3 000 000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18.00 e ditës pasardhëse”.

³ Për më tepër informacion lexo Deklaratën e publikuar nga KVV më datë 18 Maj 2013 “Fushata zgjedhore korrekte dhe zbatimi i ligjit domosdoshmëri për ushtrimin e lirë të vullnetit të votuesit” tek: <http://zgjedhje.al/index.php?idart=46&gj=sh>

organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave” datë 22.04.2009 përbën një manual sesi mund të jesh vëzhgues në zgjedhje⁴.

Në pikën 2 të nenit 2 të udhëzimit përcaktohen dy kritere bazë për të qenë vëzhgues: “Vëzhguesi duhet të plotësojë kushtet për të qenë zgjedhës si dhe të jetë i padënuar penalisht”.

Në këtë pikë, është me vend të bëhet një dallim midis një personi që gëzon të drejtën për të votuar dhe një personi që është zgjedhës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në pikën 1 të nenit 45 e lidh të drejtën për të votuar (*active suffrage*) vetëm me kriterin moshë⁵.

Ndërsa Kodi Zgjedhor lidh të qenurin zgjedhës me të qenurit pjesë e listave të zgjedhësve, pasi vetëm në këtë pikë figuron në Kodin Zgjedhor përcaktimi se kush quhet zgjedhës.

Kushtet për të qenë zgjedhës Kodi i vendos në nenin 44⁶ të tij.

Nëse Kushtetuta mjaftohet vetëm me kriterin moshë, Kodi Zgjedhor ndër të tjera kërkon edhe që të jetë ligjërisht i zoti për të vepruar si dhe të jetë pjesë e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Në këtë logjikë, **shtetasit e huaj nuk mund të kenë të drejtën për të qenë vëzhgues** gjë të cilën vetë Kodi ynë e lejon.

Duke patur Kushtetutën në një anë që përcakton të drejtën e votes, por që nuk mjafton si rregullues, në anën tjetër Kodin Zgjedhor që përcakton zgjedhësin dhe vendos më shumë kritere, lind nevoja që pika 2 e nenit 2 të Udhëzimit N.13 të ndryshohet.

Përsa i përket kërkesës që vëzhguesit duhet të jenë penalisht të pastër, është një kriter i cili mund të rishihet, sepse është një kufizim i cili lë vend mjaft për të diskutuar në parim dhe që praktikisht është pa dobi dhe i pamundur të kontrollohet.

4) Kandidimi si deputet dhe dorëheqja e zyrtarëve të lartë

Diskutimi mbi nevojën e dorëheqjes së zyrtarëve të lartë të cilët kandidojnë për deputet është një diskutim që është kryer gati gjithmonë në të gjitha proceset zgjedhore të mëparshme.

Neni 63 pika 4 i Kodit Zgjedhor qartëson kush janë postet apo funksionet që e bëjnë të pamundur kandidimin si deputet⁷.

⁴ Udhëzimi N.13 është në vijueshmëri dhe për efekt zbatueshmërie të Kreut II të Kodit Zgjedhor (Neni 6-7).

⁵ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 45 “Liritë dhe të Drejtat Politike” pika 1: “Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.”

⁶ Neni 44 i Kodit Zgjedhor: “Kriteret për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve janë:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;
- c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- ç) të jetë i regjistruar në Regjistrimin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim RKGJC);
- d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit;
- dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone qendre votimi.”

⁷ Kjo dispozitë e Kodit Zgjedhor është në përputhje edhe me nenin 69 pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 69 pika 1 : “Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:

- a) gjyqtarët, prokurorët;
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv;
- c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;
- ç) përfaqësuesit diplomatikë;
- d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre;
- dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;

Në pikën “g”, kjo pikë e nenit përmend se “zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj” nuk mund të kandidojnë për deputet.

Kjo gjë është bërë shkak për debat edhe në mbledhjen e KQZ-së së datës 11.05.2013, ku si pjesë e rendit të ditës ishte miratimi i listave shumëëmërorë të kandidatëve të Partisë Demokratike për Zgjedhjet e Kuvendit të 23 Qershorit 2013.

Në këtë diskutim përfaqësuesi i Partisë Socialiste pretendonte se qenia si kandidatë e disa zyrtarëve me poste të larta ishte në kundërshtim me vullnetin e ligjit konkretisht me gjërmën “g” të sipërpërmendur.

Ndërsa, sipas komisionerëve të KQZ-së, pretendimi i përfaqësuesit të PS-së ishte i padrejtë sepse gjërma “g” ishte një dispozitë e referuar, pra që i referohej një dispozite tjetër, që legjislatori nuk e kishte plotësuar ende boshllëkun ligjor, andaj gjërma “g” nuk mund të përbëjë bazë ligjore.

Në vijimësi të shqetësimit të përdorimit të burimeve të administratës shtetërore, diskutimi i mësipërm merr një rëndësi të veçantë.

Në këtë frymë **legjislatori duhet të qartësojë më saktë se cilët janë ata zyrtarë të cilët nuk mund të kandidojnë për deputet** pa dhënë dorëheqjen nga posti i tyre.

Aktualisht në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i Nëpunësit Civil*”, nëpunësit civilë të nivelit të lartë janë⁸:

- a) Sekretari i Përgjithshëm
- b) Drejtor Departamenti
- c) Drejtor Drejtorie të Përgjithshme
- d) Pozicionet e barazvlefshme me tre të parat në institucionet e administratës publike qëndrore apo vendore.⁹

Kjo ndarje që bën ligji, në një interpretim të thjeshtë nuk lë shteg për paqartësi.

Në konsideratën e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, **të gjithë funksionarët që përmend dispozita e mësipërme duhet të dorëhiqen** nëse duan të kandidojnë si deputetë në parlament.

Pavarësisht pasaktësisë apo boshllëkut ligjor, ky duhet të jetë një **vendim i cili duhet të merret mbi moralin dhe vullnetin e çdo kandidati apo subjekti politik që i kandidon, në respekt të parimit madhor të barazisë në konkurrim.**

Legjislatori duhet të formalizojë më qartë kriteret për të vendosur kandidaturën për deputet . Gjërma “g” në pikën 4 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor ka nevojë të qartësohet nga ai formulim që është sot.

Gjithashtu, KVV sugjeron së paku unifikimin e terminologjive që përdor legjislatori në hartimin e dispozitave, siç është rasti i termit “zyrtar” apo “nëpunës”, për të shmangur në vijimësi problematikat në këtë pikë të ndjeshme apo edhe për të ndikuar në mbajtjen sa më larg të administratës.

e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji.”

⁸ Neni 11 pikal i Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i Nëpunësit Civil*”: “Klasat e nëpunësve civil janë këto:

- a) Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues.
- b) Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues.
- c) Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues.
- d) Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues.”

⁹ Neni 11 pika 2, Klasat, Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i Nëpunësit Civil*”

5) Kompetencat ligjore për auditët e financave të partive

Në pikën 3 të nenit 91, Kodi Zgjedhor i jep një hapësirë të madhe veprimi auditëve që verifikojnë pasqyrat financiare të subjekteve elektorale. Sipas tij, ata janë të plotfuqishëm t'i kërkojnë subjekteve zgjedhore çdo informacion që i nevojitet në punën e tyre.

Por, Koalicioni vëren se **as legjislatori dhe as KQZ-ja në udhëzimet e miratuara nuk i jep audituesit të gjitha mjetet e nevojshme për ta përdorur këtë hapësirë dhe liri në punën e tyre.**

Nga monitorimi në vazhdimësi i proceseve zgjedhore të 2009 dhe 2011, dhe të auditimeve financiare të kryera ndaj subjekteve pjesëmarrëse në to, konstatohen një sërë rastesh me shkelje, të evidentuara në raportin e auditëve sikundër janë:

- pamundësia e komunikimit dhe e kontaktit direkt me subjektin elektorale;
- ushtrimi i aktivitetit elektorale nga parti pa numër NIPT-i, çka është një detyrim ligjor për çdo subjekt juridik;
- deklarimi i pasqyrave financiare të pashoqëruara me fatura tatimore sikundër parashikohet nga ligji apo pa fatura fare;
- apo deklarimi i shpenzimeve zero gjatë aktivitetit elektorale të partisë, etj.

Madje, ka raste kur auditimet e subjekteve elektorale publikohen të paplota në faqen zyrtare të KQZ-së sikundër është detyrimi ligjor, apo nuk publikohen fare.

Situata aktuale në këtë drejtim i bëhet akoma më pak e kontrolluar duke pasur parasysh edhe një mangësi të vetë Kodit Zgjedhor.

Sipas tij, dhuruesit e shumave mbi 100 mijë lekë duhet ta kryejnë kalimin e parave “vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor”.

Në funksion të kësaj kërkesë të ligjit, subjekti zgjedhor “jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim”.

Nga dy dispozitat e mësipërme lind një problematikë jo e vogël, që sidomos në këtë proces zgjedhor shfaqet qartazi.

Një subjekt zgjedhor, qoftë i vogël apo i madh, **lëvizjet e veta financiare sidomos ato të rëndësishmet i bën para fillimit të fushatës.**

Nëse vëzhgimi i tyre fillon tre ditë pasi vetë fushata ka filluar, atëherë **nuk ka mbetur shumë për t'u mbikëqyrur në lëvizjet financiare të partive**¹⁰.

C. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Legjislacioni Zgjedhor parashikon se Zgjedhjet për Kuvendin administrohen nga komisionet zgjedhore të tre niveleve – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), 89 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5506 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).

Numërimi i votave do të bëhet në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), prej Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor si dhe Komisionet e Qendrave të Votimit përbëhen nga 7 anëtarë.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve. Trupa e re e KQZ-së, e nisi punën me datë 26.10.2012. Ndërsa KZAZ-të u ngritën me vendim të KQZ-së me 25.03.2013 dhe KQV-të duhet të emërohen prej KZAZ-ve deri me datë 03.06.2013.

¹⁰ Për më tepër informacion lexo Deklaratën e publikuar nga KVV më datë 23 Maj 2013 “Transparenca e financimit të subjekteve elektorale element kyç për një proces zgjedhor ligjor, transparent dhe të barabartë” tek: <http://zgjedhje.al/index.php?idart=47&gj=sh>

C1. KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Muaji prill ishte një periudhë që riformatoi jo vetëm gjendjen politike, por solli ndryshime në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve.

Pas largimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim nga koalicioni mazhoritar dhe rradhitjes si forcë opozitare, Partia Demokratike investoi Kuvendin e Shqipërisë në lirimin e komisionerit Z. Muho me argumentimin se me rikonfigurimin politik të ndodhur, edhe KQZ-ja kishte nevojë për rikonfigurim.

Kuvendi i Shqipërisë në seancën parlamentare të datës 15.04.2013 votoi për lirimin nga detyra të komisionerit z. Ilirian Muho, por me motivacion ndryshe nga si u nis dhe u deklarua në fillim. Motivacioni final ishte “*si person i shkarkuar nga funksioni publik i prokurorit me dekret të Presidenit të Republikës nr. 3727 datë 13.03.2003, duke i fshehur Kuvendit, gjatë procedurës së emërimit, deklarimin e fakteve që pengonin emërimin në detyrën e anëtarit të KQZ*”.

Në vendin e komisionerit z. Ilirian Muho, Kuvendi emëroi z. Klement Zguri, kandidaturë e propozuar nga Partia Republikane, si forca e dytë më e madhe mazhoritare në parlament.

Që nga data 16.04.2013, pas dorëheqjes së njëpasnjëshme të tre komisionerëve të propozuar nga opozita dhe mos propozimit nga opozita të kandidaturave të tjera për vakancat e krijuara, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka vazhduar punën dhe vendimmarrjen me katër anëtarë.

Kjo situatë konsiderohet si tejet shqetësuese për dy argumenta madhorë.

Së pari, duhet thënë që KQZ-ja si institucion konstituohet me shtatë anëtarë.

Ndonëse vendimmarrja e saj mund të vazhdojë me katër anëtarë, ky fakt e cënon legjitimitetin e institucionit.

Legjislatori i ka parashikuar katër votat si nevojë për të patur miratimin e vendimeve, por e ka parashikuar institucionin me shtatë anëtarë. Në të kundërt, do mjaftonte që institucioni i KQZ-së të konstitutohej me katër anëtarë.

Së dyti, vendimmarrja e cilësuar me 5 vota që Kodi Zgjedhor e kërkon për akte të caktuara është praktikisht e pamundur, duke sjellë kështu bllokimin e institucionit. Aktet të cilat kërkojnë domosdoshmërisht 5 vota listohen kryesisht në nenin 24 të Kodit Zgjedhor, por ndërkohë hasen edhe në dispozita të shpërndara nëpër Kod¹¹.

Në këtë gjendje që është, disa prej vendimeve të sipërpërmendura, **KQZ-ja i ka të pamundur t'i miratojë duke prodhuar ndalim të ecurisë së procesit zgjedhor pa patur asnjë mundësi ligjore për zgjidhje të bllokimit.**

¹¹ Neni 24 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me:

a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166, pika 3 të këtij Kodi;
b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi dhe vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve për rezultatin e zgjedhjeve për qeverisjen vendore;
c) kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi;
ç) shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore apo në të gjithë vendin dhe përsëritjen e tyre;
d) aktet me karakter normativ dhe që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet;
dh) propozimin për shkarkimin e anëtarit të KQZ-së, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij Kodi;
e) miratimin e strukturës organike të KQZ-së, si dhe rregulloren e funksionimit të KQZ-së;
ë) caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas nenit 76 të Kodit;
f) caktimin e zonave të administrimit zgjedhor, sipas nenit 27 të Kodit.

Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së.”

Nga ana tjetër, është vënë re se prej trupës aktuale të KQZ-së dhe administratës ka një qëndrim të ri, se **aktet e përdorura në zgjedhjet pararendëse mund të përdoren edhe për këto zgjedhje**, pa qenë e nevojshme të miratohen akte të tjera.

Kjo mund të jetë një nevojë për të shmangur ngërçet e mundshme që mund të lindin, por mbart një sërë pikëpyetje të rënda ligjore mbi vete.

Gjithashtu, ky qëndrim sjell **konfuzion në këtë proces zgjedhor që po ndodh dhe është një precedent negativ që krijohet për të ardhmen e proceseve zgjedhore dhe të vetë institucionit.**

Në këtë pikë, duhet sjellë në kujtesë që në planin e saj të veprimit, KQZ-ja e ka parashikuar vetë votimin e këtyre akteve, madje e ka miratuar me vendim atë.

Problematika në ecurinë e administrimit të procesit prej institucionit të KQZ-së

Konstatohet se veprimtaria e deritanishme e KQZ-së në kuadër të përgatitjes për zgjedhjet e Kuvendit të datës 23 qershor, **është e paplotë dhe vendimmarrja e saj nuk e mbulon në mënyrën e duhur sferën e detyrimeve ligjore**, të caktuara ndaj saj prej Kodit Zgjedhor.

Tashmë ka më pak se një muaj kohë përpara ditës së zgjedhjeve dhe **një sërë aktesh individuale dhe normative të cilat janë të domosdoshme për procesin zgjedhor, mbeten ende të pamiratuara.**

Për sa u përket akteve normative, vlen të theksohet se në bazë të parashikimeve të kodit zgjedhor (neni 23, pika 4), këto të fundit duhet të miratohen apo ndryshohen jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Një ndër mangësitë më të mëdha të konstatuar në këtë drejtim është mosmiratimi i *Rregullores së Organizimit dhe funksionimit të KQZ-së*, çka sipas ligjit duhet të qe kryer para datës 26 dhjetor 2012.

Por ka edhe akte të tjera që lidhen me aspekte të veçanta teknike të procesit zgjedhor si : Akti *“Për miratimin e rregullave për verifikimin e saktësisë së SEN në VNV, përdorimin dhe administrimin e SEN, procedurat e numërimit, vlerësimit të fletëve të votimit nga SEN, si dhe për nxjerrjen e rezultatit dhe administrimin e çdo të dhëne të prodhuar nga SEN”* dhe ai *“Për miratimin e procedurave të funksionimit të teknologjisë së SEV”*, të cilat rezultojnë të pamarra sot e kësaj dite.

I njëjti problem haset edhe me nevojën për vendimmarrje lidhur me caktimin e VNV-ve, si dhe të kriterëve për numrin e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV), dhe të mënyrës së funksionimit të tyre, **çështje që rregullohen gjithashtu nëpërmjet një akti normativ.**

Nga ana tjetër, vetë caktimi i VNV-ve, në bazë të Kodit zgjedhor, është një procedurë që duhet të ezaurohet jo më vonë se 40 ditë para zgjedhjeve.

Akte të tjera të munguara janë ato për miratimin e *“Manualit trajnues të GNV-ve”*, e *“Manualit të trajnimit për administrimin e SEN-it në VNV-të nga KZAZ-të dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore”* dhe atij *“Manualit të trajnimit për administrimin e SEV-it në Qendrën e Votimit”*.

Duke qenë se gjatë ecurisë së procesit zgjedhor një strukturë thelbësore është ajo e Komisionit të Qendrës së Votimit, **është i nevojshëm miratimi i aktit “Për organizimin dhe funksionimin e KQV-se”** së bashku me *“Manualin e KQV-se”*.

Një tjetër çështje për tu përmendur, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se tanimë fushata zgjedhore zyrtarisht ka nisur, është ajo e **vendimit sërish të munguar të KQZ-së lidhur me kohën e transmetimit për partitë politike në televizionin publik.**

Në lidhje me problematikat që janë hasur gjatë vëzhgimit të punës së administratës së KQZ-së dhe trupës së KQZ-së, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë liston këto problematika si më poshtë:

a) Rregullorja e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor e parashikon në nenin 184, pika 2, që jo më vonë se data 26.12.2012 KQZ-ja duhej të miratonte Rregulloren¹² e saj.

Në mbledhjen e 28.12.2012, në rendin e ditës ishte miratimi i Rregullores, por kjo pikë u shty duke e lënë kështu Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ta vazhdonte veprimtarinë e vet midis polemikave në interpretimin e Kodit Zgjedhor sesi duhej të ishte marrëdhënia midis vetë komisionerëve, midis trupës dhe administratës, etj.

Disa muaj më vonë, në mbledhjet e datave 13.03.2013, 15.03.2013, dhe 18.03.2013, diskutimi i Rregullores ishte rendi i ditës.

Projekt-rregulloret që ishin pjesë e diskutimit ishin tre. Drafti parë ishte i përgatitur prej ekspertit të Komisionit të Venecias pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve z. Bernard Owen. I dyti ishte i përgatitur prej dy komisionerëve znj. Albana Shtylla dhe z. Denar Biba, dhe i treti ishte i përgatitur prej administratës.

Gjatë këtyre tre mbledhjeve, dy ishin pikat mbi të cilat u krijua ngërçi në vendimmarrje dhe ku u vërejtjen dy grupime komisionerësh me qëndrime diametralisht të kundërta.

Pika e parë ishte statusi i zëvendës kryetarit. Sipas tre komisionerëve, z. Denar Biba, znj. Albana Shtylla dhe z. Jani Jani, zv/kryetari duhej të shihej nga rregullorja si një bashkëdrejtues me kryetarin, sepse e tillë sipas tyre ishte fryma e Kodit Zgjedhor.

Një pretendim që u kundërshtua prej komisionerëve të tjerë. Kjo pikë u kalua pa marrë zgjidhje dhe pa miratuar detajime të mëtejshme në rregullore, duke e ripërcaktuar sikundër është paraqitur në Kod.

Në këtë pikë, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka bërë publik qëndrimin e tij, duke e vlerësuar pozitën e zëvendës-kryetarit si një “atavizëm” ligjor nga Kodi Zgjedhor i vjetër.

Me Kodin Zgjedhor të amenduar së fundmi, kjo KQZ nuk e ka të nevojshëm pozicionin e zëvendës kryetarit për të balancuar kryetarin, çka në të vërtetë bie ndesh me frymën me të cilën konstituohet KQZ-ja.

Pika e dytë, e cila shkaktoi dhe pezullimin e diskutimeve të mëtejshme të neneve të rregullores, kishte të bënte me të drejtat që duhej të kishte pakica e mendimit në trupën e KQZ-së.

Të pozicionuar sërish si në rastin e parë, komisionerët mbrojtën qëndrime të ndryshme. Në diskutimin mbi të drejtën për ta thirrur mbledhjen e KQZ-së, njëri grupim kërkoi që kjo e drejtë e pakicës së mendimit në trupën e KQZ-së të ishte e pakufizuar në tematikën që mund të kishte mbledhja e thirrur. Ndërsa grupimi tjetër pretendonte se kjo nuk mund të lejohej, pasi konsiderohej si një mjet që e vinte trupën e KQZ-së nën drejtimin e pakicës.

Ngërçi i krijuar mbi këtë temë **solli dhe pezullimin e diskutimit të mëtejshëm të projekt-aktit për miratimin e rregullores, duke e lënë sërish vendimmarrjen dhe veprimtarinë e KQZ-së pa një akt shumë të rëndësishëm.**

¹² Neni 184 pika 2 e Kodit Zgjedhor: “Jo më vonë se 60 ditë nga mbledhja e parë, KQZ-ja e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së.”

b) Shkelje në dokumentacionin e pranuar nga KQZ-ja

Sipas Kodit Zgjedhor, “kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit” atëherë mund të përdoren si qendra votimi ndërtesa private¹³.

Por kjo mundësi që lejon Kodi Zgjedhor duhet të plotësojë 5 kushte:

- a) qendra e votimit në asnjë rast nuk mund të caktohet në banesa private.
- b) qendra e votimit nuk mund të caktohet në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore.
- c) qendra e votimit nuk mund të caktohet në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.
- d) propozimi për caktimin e tyre paraqitet me dy objekte alternative.
- e) vendimi për caktimin e qendrave të votimit private merret në konsultim me përfaqësuesit e akredituar të subjekteve në KQZ.

Në së paku katër mbledhje të ndryshme, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka patur pjesë të rendit të ditës përcaktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private. Mbledhjet kanë qenë të gjata dhe të shoqëruara më së shumeti me diskutime prej përfaqësuesve të forcave politike.

Këto diskutime marrin shumë kohë nga veprimtaria e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe ndikojnë në cilësinë e vendimmarrjes së saj.

Koalicioni në këtë pikë thekson se është e nevojshme të trajtohen dy aspekte:

I pari ka të bëjë me **moszbatimin e ligjit zgjedhor** ashtu siç ai parashikohet.

Në nenin 94, pika 4, gërma “d” parashikon që për përcaktimin e qendrave private “propozimi për caktimin e tyre paraqitet me dy objekte alternative”.

Në propozimet e depozituara në KQZ, dy objektet alternative mungonin në pjesën më dërrmuese të propozimeve.

Duke lënë mënjanë faktin që ky është një detyrim ligjor dhe mosrespektimi sjell sanksion, zbatimi i asaj dispozite do t’ia lehtësonte shumë punën KQZ-së.

Nëse KQZ dhe përfaqësuesit politikë aty, do të kishin përpara dy alternativa të mundshme për të zgjedhur, me shumë gjasa, administrata e KQZ-së nuk do të detyrohej të bënte verifikime të dyta kur nuk pranoheshin alternativat e para dhe nuk do të ndodhte që përfaqësuesit politikë të mundoheshin të sugjeronin alternativa të tjera që i shkonin atyre përshtat.

I dyti që vihet re, është që kjo pjesë e Kodit Zgjedhor ka nevojë të plotësohet me **disa kritere më shumë në përcaktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private**, për t’i lënë më pak vend diskrecionit të vendimmarrjes.

Duhet të vendosen kritere më të mprehta në përcaktim, për të mos u dhënë mundësinë përfaqësuesve të partive politike që ta shndrojnë një mbledhje me natyrë vendimmarrje logjistike në një diskutim politik të pakuptimtë.

¹³ Neni 93 pika 4 e Kodit Zgjedhor: “KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Propozimi për caktimin e tyre paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ.”

c) Kujdesi në përgatitjen e dokumentacionit prej administratës

- Në mbledhjen e datës 15.04.2013, projekt-vendimi i dorëzuar nga administrata për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 8 “Për miratimin e kritereve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore”, datë 25.03.2009, **mbante si bazë ligjore Kodin Zgjedhor para ndryshimeve të kryera.**

- Në mbledhjen e datës 11.05.2013, projekt-vendimi i dorëzuar nga administrata “Për miratimin e listave shumëemërore të partive politike të regjistruara në KQZ, si subjekt zgjedhor në Zgjedhjet e Kuvendit të datës 23 Qershor 2013” vërente se lista e kandidatëve e Partisë Socialiste kishte shkelje të kuatës gjinore në 4 zona zgjedhore. Me ndërhyrjen e komisionerit z. Hysen Osmanaj dhe Kryetares znj. Lefteri Lleshi, **u evidentua që ishin edhe dy zona të tjera zgjedhore që nuk e plotësonin kushtin e kuotës gjinore** në listën e kandidatëve të Partisë Socialiste, duke rezultuar në total në 6 zona zgjedhore.

- Në mbledhjen e datës 25.04.2013, projekt-vendimi i dorëzuar nga administrata “Për përcaktimin e planit për përmbushjen e projektit për sistemin elektronik të numërimit (SEN) në qarkun Fier, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013” në pikën e tij të katërt parashikonte: “Pranimi nga KQZ-ja i metodologjisë për provën paraprake”.

Vetë administrata gjatë relacionit që do të mbante **do pranonte që kishte bërë një lapsus**, sepse është administrata ajo që pranon metodologjinë për provën paraprake.

- Në mbledhjen e datës 14.05.2013, u votuan listat shumëemërore të 16 partive politike, të cilat ishin kthyer nga KQZ për plotësim.

Gjatë diskutimit të listës së Partisë Popullore Kristian Demokrate, administrata në relacion e vet nuk kishte vënë në dukje se në disa qarqe kjo parti nuk kishte zbatuar kuotat gjinore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Me ndërhyrjen sërish të komisionerit z. Hysen Osmanaj dhe Kryetares znj. Lefteri Lleshi **u pa që ishin 8 zona zgjedhore që nuk e plotësonin kushtin e kuotës gjinore** në listën e kandidatëve të Partisë Popullore Kristian Demokrate, për të cilat më pas u morën dhe masa e gjobës.

- Në datat 26-27.04.2013 Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve organizoi trajnimin e trajnuesve të komisionerëve të KZAZ-ve.

Në materialet e shpërndara pjesëmarrësve në trajnim, në lidhje me shenjat dalluese që do të përdoren në Zgjedhjet e 23 Qershorit 2013, hasej detyra e Zv/Kryetarit të KQV-së. Sipas ndryshimeve të bëra së fundmi në Kodin Zgjedhor, kjo detyrë nuk është më pjesë e Komisioneve të Qendrave të Votimit.

Lektori i asaj pjese të trajnimit, i kërkoi pjesëmarrësve mos t’a marrin parasysht këtë pjesë të materialit, **i cili ishte gabim pasi i referohej Kodit para ndryshimeve të Korrikut 2012.**

d) Transparenca dhe menaxhimi i punës nga administrata

- Faqja zyrtare e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është një aspekt shumë i rëndësishëm në funksionimin e KQZ-së, pasi jo vetëm që aty pasqyrohen të gjitha informacionet zyrtare të KQZ-së, por publikimi i materialeve në të është një ndër elementët detyrues që Kodi jep në funksion të rritjes së transparencës dhe bërjes publike të aktivitetit të KQZ-së.

Një shqetësim i konstatuar në këtë drejtim është publikimi i materialeve të pa plota ose mos publikimi fare i tyre.

Përmendim si shembull, që gati në çdo rast materialet e specifikuara si “Lidhje”, që bashkëshoqërojnë vendimet e marra nga KQZ, në faqen zyrtare nuk ekzistojnë për t’u shkarkuar.

Gjithashtu, vihet re që aty nuk janë publikuar disa prej vendime të marra nga KQZ-ja.

Po ashtu faqja zyrtare e KQZ-së u sulmua nga hacker-at duke dalë jashtëpërdorimit për disa ditë.

Mbi këtë ndodhi nuk pati asnjë pohim publik prej vetë institucionit, veç një e-mail-i të datës 08.05.2013 ku zëdhënësja për shtyp e KQZ-së vinte në dijeni për sulmin dhe kërkonte ndjesë për mosfunksionimin e faqes¹⁴.

- Përfaqësuesi i Partisë Socialiste, në mbledhjen e datës 19.04.2013, gjatë diskutimit mbi çështje jashtë rendit të ditës i bën me dije Kryetares se **ka dorëzuar prej 20 ditësh kërkesën për zëvendësimin e disa komisionerëve të KZAZ-ve**. Ndonëse ia kishte kujtuar këtë fakt edhe në një mbledhje pararendëse, kërkesa e tij ende nuk ishte bërë pjesë e rendit të ditës.

Kryetarja e KQZ-së e pranoi faktin e vonesës, por nuk dha arsye për këtë vonesë.

- Në mbledhjen e datës 14.05.2013, për pikën e rendit të ditës për listat e kandidatëve të Partisë Ligj dhe Drejtësi, si dhe në mbledhjen e datës 15.04.2013, për pikën e rendit të ditës për Listën e Qendrave të Votimit Private, **administrata kishte shpërndarë dy materiale të ndryshme** midis pjesëmarrësve në mbledhje.

Njëri mbante korigjimet e fundit të bëra dhe materiali tjetër nuk ishte i korigjuar, duke krijuar paqartësi midis folësve gjatë diskutimit, pasi iu referoheshin materialeve të ndryshme.

- Votimi i mbledhjes më datë 19.03.2013, për vendimin për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 7 “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhje”, datë 23.03.2009, mori 6 vota pro dhe një votë kundër të komisionerit z. Hysen Osmanaj. Argumentimi i këtij të fundit për votën e tij kundër, ishte fakti që Udhëzimi Nr. 7 ishte i mjaftueshëm dhe nuk i nevojiteshin ndryshimet që po i kryheshin.

Në faqen zyrtare të KQZ-së në internet, në njoftimin për publikun bëhet e ditur që **rezultati i votimit ka qenë me 7 vota pro**¹⁵.

e) Teknologjia SEN dhe SEV

Projektet pilote të teknologjisë së SEN-it (Sistemi Elektronik i Numërimit) dhe SEV-it (Sistemit Elektronik të Verifikimit) kanë patur një ecuri problematike.

Sipas Planit Orientues të Veprimit të KQZ-së, planet për përmbushjen për SEN-in dhe SEV-in duhej të miratoheshin në dhjetor të 2012¹⁶. Në fakt, Plani i Përmbushjes së SEN-it u votua nga KQZ-ja me 29.03.2013 dhe Plani i Përmbushjes të SEV-it u votua me 25.04.2013¹⁷.

¹⁴ Pjesë nga njoftimi i zëdhënësës së KQZ-së, datë 08.05.2013: “Duke ju kërkuar ndjesë që faqja zyrtare e web-it nuk është në funksion të plotë për shkak të problemeve që janë shkaktuar nga hakerat po ju nis listat e partive që do të kalojnë në mbledhjen e nesërme.”

¹⁵ http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=400%3Anjoftim-per-shtyp-19032013&catid=51%3Adeklarata-2010&Itemid=158&lang=sq

¹⁶ Vendimi Nr. 17 i KQZ-së, datë 06.12.2012: “Për miratimin e planit orientues të veprimit të KQZ-së për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”.

¹⁷ - Vendimi Nr. 181 i KQZ-së, datë 29.03.2013: “Për përcaktimin e planit për përmbushjen e projektit për Sitemin Elektronik të Numërimit të Zgjedhësve (SEN) në Qarkun Fier”.

Sipas pikës 6 të nenit 179/1 të Kodit Zgjedhor, procedurat e prokurimit të SEN-it dhe SEV-it duhet të mbylleshin me datë 23.12.2012¹⁸.

Kompania fituese për realizimin e projekteve SEN dhe SEV u shpall nga KQZ-ja kompania spanjolle INDRA, respektivisht në datat 08.02.2013 dhe në 23.03.2013.

Ndërsa kontrata me kompaninë INDRA për SEN-in u nënshkrua me 16.03.2013 dhe kontrata për SEV-in u nënshkrushua me 25.03.2013.

Teknologjia e SEN-it

Në lidhje me zbatimin e SEN-it, në Seksionin e Tretë të Shtojcës II të Kodit Zgjedhor kërkohet që deri me 25.03.2013 të kryhet Testimi Paraprak i SEN-it¹⁹. Kodi Zgjedhor kërkon që Testimi Paraprak të jetë i plotë dhe duke simuluar një numër real.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 02.04.2013 vendosi për një qëndrim ndryshe nga Kodi Zgjedhor.

Në këtë mbledhje, në relacionin e paraqitur, Administrata e KQZ-së deklaroi se do të organizoheshin dy testime.

Testimi i parë u quajt prej Administratës si detyrim ligjor i parashikuar, ndërsa Testimi i Dytë do kryhej thjesht për të provuar saktësinë e sistemit.

Testimi i parë, sipas vendimit të KQZ-së, do të kryhej në Tiranë dhe numri i fletëve që do përdorehin do të ishte 6000 fletë, pra rreth 3% e sasisë të përgjithshme që do të përdorehin me 23 Qershor 2013, për 15 qendra votimi, nga një prej ZAZ-ve të Qarkut Fier²⁰. Ndërkohë, Testimi i Dytë, ndryshe nga i pari do të ishte real, do zhvillohej në Fier, me 10% të sasisë të përgjithshme të fletëve.

Kodi Zgjedhor **parashikon vetëm një testim dhe ai parashikohet i plotë dhe me një numërim real**, kritere këto që sipas relacionit të Administratës i atribuohen Testimit të Dytë.

Testimi i parë u krye me datë 13.04.2013 në shkollën “Hasan Prishtina” në Tiranë. Në prani të shumë operatorëve të interesuar mbi procesin elektoral, sistemi procesoi 4.927 fletë votimi dhe kohëzgjatja e numërimit të fletëve ishte rreth 7 orë e 30 minuta²¹.

Në mbledhjen e datës 17.05.2013, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shqyrtoi projektvendimin “Për shqyrtimin e raportit mbi realizimin e provës së testit të datës 13 Prill 2013, lidhur me projektin e Sistemit Elektronik të Numërimit, SEN”.

KQZ-ja duke e vlerësuar testimin e 13.04.2013 si detyrim që vjen nga Kodi Zgjedhor, hartoi dhe një raport për këtë testim²².

- Vendimi Nr. 171, datë 25.04.2013: “Për përcaktimin e planit për përmbushjen e projektit për Sitemin Elektronik të Verifikimit të Zgjedhësve (SEV) në Qarkun Tiranë”

¹⁸ Neni 179/1 i Kodit Zgjedhor, pika 6: “Procedurat e prokurimit, si rregull, duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj përpara zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013.”

¹⁹ Seksioni 3 - Testimi paraprak i SEN-it, Shtojca II e Kodit Zgjedhor: “Jo më vonë se 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KQZ-ja zhvillon, në prani të përfaqësuesve të partive politike, vëzhguesve dhe medias, një provë të plotë, duke simuluar një numërim real, në lidhje me funksionimin e SEN-it.”

²⁰ Vendimi Nr. 182 i KQZ-së “Për miratimin e procedurave që do të ndiqen për plotësimin e fletëve të votimit (fletë votimi test) që do të përdoren gjatë testimit paraprak të sistemit të numërimit elektronik të votave” datë 02.04.2013: “Sasia e fletëve të votimit të cilat do të numërohen në testin e parë do të jetë 6000 (gjashëmijë) copë, për 15 qendra votimi, nga një prej ZAZ-ve të Qarkut Fier.”

²¹ Sipas raportit të kompanisë INDRA, të depozituar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, procesimi i fletëve filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 17:58.

²² Pika 1, Seksioni 3 “Testimi paraprak i SEN-it”, Shtojca II e Kodit Zgjedhor: “KQZ-ja harton një raport në lidhje me provën e zhvilluar, i cili shqyrtohet në seancë publike. Kur në raport janë konstatuar

Raporti i miratuar prej KQZ-së, **përmbante ndër të tjera edhe katër rekomandime**, të cilat iu përcollën kompanisë INDRA si përgjegjëse për teknologjinë SEN²³:

- 1) Sistemi nuk dallonte shenjimin në kuadratin e bardhë
- 2) Prova nuk filloi me gjenerimin e “raportit zero”
- 3) Skaneri nuk ndalonte automatikisht por duhet të ishte operatori që ta ndalonte
- 4) Koha e gjatë e procesimit të fletëve

Shqetësime në lidhje me testin e SEN, pati edhe nga Partia Socialiste, ekspërtetët e së cilës dorëzuan më datë 18.04.2013 në KQZ, një raport²⁴ i cili tërhoqte vëmendjen në disa drejtime, por që përmbledhet në dy kritika kryesore që testimi nuk arriti të tregonte se ishte i shpejtë dhe i saktë.

Teknologjia e SEV-it

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve më datë 17.05.2013 në ambjentet e KQZ-së zhvilloi testin (jozyrtar) për projektin pilot që do të implementohet në qarkun e Tiranës për Zgjedhjet për Kuvendin, të datës 23 Qershor 2013²⁵.

Sipas njoftimit për shtyp të dhënë nga KQZ-ja, “qëllimi i kësaj prove ishte vërtetimi i funksionimit të SEV përmes një simulimi të një procesi real në një shkallë më të zvogëluar”²⁶.

mangësi teknike, ato duhet të riparohen përpara ditës së zgjedhjeve, sipas afatit të përcaktuar nga KQZ-ja.”

²³ Pjesë e relacionit të mbajtur për projektvendimin “Për shqyrtimin e raportit mbi realizimin e provës së testit të datës 13 Prill 2013, lidhur me projektin e Sistemit Elektronik të Numërimit, SEN”, në mbledhjen e Komisionit Qendror të datës 17.05.2013: “1) Sistemi nuk dallonte në pjesën e kuadratisht të bardhë në të djathtë të partisë ku vendosej shenjimi nëse ishte shenjje apo shkrim. Në këtë mënyrë votuesi mund të vendos çdo shenjim në kuadratin e bardhë dhe sistemi e konsideron të vlefshëm.

2) Prova nuk filloi me gjenerimin e “raportit zero” i cili duhet të garantojë që paraprakisht në sistem nuk ka informacion të mbetur (detyrim i përcaktuar në aneksin II, pika 1.9 të kontratës).

3) Skanimi i dy fletëve përnjëherë dhe që skaneri nuk ndalonte automatikisht por duhet të ishte operatori që të konstatojë këtë fakt dhe të ndalonte skanerin, ishte një proces i cili nuk garanton saktësi 100%, pasi nuk mund të bazohet saktësia e makinerisë të vëmendja e operatorit.

4) Procesimi i fletëve filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 17:58 (Raporti Indra) nisur nga praktika e deritanishme, për një volum të tillë të numërimit të fletëve të votimit ngritja e 5 grupeve të numerimit do të kishte nxjerrë rezultat më të shpejtë.”

²⁴ Gjetjet/vërejtjet që kanë renditur ekspertët e Partisë Socialiste në raportin e datës 18.04.2013:

“1. Dokumentacioni në lidhje me testimin.

2. Raporti Zero nuk u gjenerua.

3. Kutitë nuk u numëruan sipas numrit rendor rritës.

4. Lexuesi i bar code-ve për kutitë e votimit nuk ekzistonte.

5. Procesimi i regjistrimit të kutisë nuk ishte transparent.

6. Nuk u testua procedura e rinumërimit në rastin kur ka mospërputhje të Procesverbalit të Mbylljes me numrin faktik të fletëve në kuti..

7. Nuk u bë verifikimi i saktësisë të SEN (verifikimi a-posteriori).

8. Paqartësi në informacionet e publikuara në tabela.

9. Procesimi i ndarjes së fletëve të kontestuara.

10. Probleme të verifikuara në procesin e ndarjes së fletëve.

11. Pamundësia për të korrigjuar veprime të operatorit gjatë vlerësimit manual.

12. Probleme me skanimin në rast të kapjes së dy fletëve.

13. Vlerësim për shpejtësinë e procesit të numërimit.

14. Lidhur me përgatitjen profesionale dhe trajnimin e KZAZ.

15. Çështje të Teknologjisë së Informacionit.”

²⁵ http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=449%3Adekrate-per-shtyp-18052013&catid=51%3Adeklarata-2010&Itemid=158&lang=sq

²⁶ Pjesë e Njoftimit për të Shtyp të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të datës 18.05.2013: “Gjatë testit u realizuan detyra të rëndësishme si:

- Montimi dhe testimi i hardwar-ve

Po sipas këtij njoftimi, KQZ-ja bënte me dije “se testi zyrtar dhe publik i Sistemit Elektronik të Verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), është parashikuar të realizohet në javën e parë të muajit qershor”.

Me Vendimin Nr. 271 të datës 25.04.2013, KQZ-ja miratoi “Planin për Përmbushjen e projektit SEV”.

Në pikën 23 të këtij plani parashikohej prova paraprake që u mbajt më datë 17.05.2013 dhe nuk parashikohen prova të tjera.

Data e mësipërme e parashikuar nga plani, përkon me atë që KQZ-ja e quajti test jo zyrtar, ndërkohë që **të ashtuquajturin prej KQZ-së si Test Zyrtar plani nuk e parashikon.**

Vonesat në procesin e zbatimit të teknologjisë së SEV-it, e kanë dëmtuar procesin në një pikë të rëndësishme.

Kodi Zgjedhor parashikon se jo më vonë se 60 ditë nga dita kur do të mbahen zgjedhjet, KQZ-ja mund të auditojë sigurinë dhe funksionimin e sistemit²⁷.

Vonesat në zbatimin e kësaj teknologjie në lidhje me dispozitën në fjalë, kanë sjellë që **KQZ-ja nuk e ka më mundësinë ligjore që ta auditojë sistemin për parregulltësitë që mund të ketë.**

Madje, KQZ edhe sikur të kishte mundësinë ligjore për ta audituar sistemin, çdo gjetje që mund të dalë nuk do të ketë kohë që të gjejë zbatim²⁸ më pas.

Në këtë rrjedhë problematikash, Kodi Zgjedhor kërkon që jo më vonë se data 24.05.2013, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të vendosë se cila do të jetë shtrirja e zbatimit të teknologjisë SEN²⁹.

Moskryerja e auditimit ia ka bërë akoma më të vështirë KQZ-së që të jetë e qartë sesi të përcaktojë gjeografinë e zbatimit. Raporti i një auditimi do ia bënte më të lehtë vendimmarrjen dhe përgjigjësinë KQZ-së në këtë pikë.

Gjithsesi, KQZ-ja nuk e mori një vendim të tillë brenda afatit ligjor. Me mos nxjerrjen e një vendimi të tillë **KQZ-ja ka pranuar apriori se SEV-i do zbatohet kudo.**

f) Plani orientues i veprimeve të KQZ-së

Në mbledhjen e datës 06.12.12, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve miratoi me vendimin numër 17 “Planin Orientues të Veprimeve të KQZ”.

Ky vendim në pikën dy vendos se “ngarkohen strukturat administrative të KQZ-së për zbatimin e këtij plani”. Kuptohet qartazi që ky plan nuk është vetëm një axhendë mbledhjesh dhe temash përkatëse.

- Konfigurimi i laptop-ve në Qendër Votimi

- Fillimi i votimit

- Regjistrimi i votuesve dhe dërgimi i të dhënave në Sistemin Qëndror

- Mbyllja e votimit

- Shkarkimi i informacionit të Kartave SD në vendin Qëndror”.

²⁷ Pika 4, Seksioni 4 “Përpunimi i të dhënave, raportet dhe administrimi i sistemit”, Shtojca III e Kodit Zgjedhor: “KQZ-ja mund të përzgjedhë një shoqëri për auditimin e jashtëm të sigurisë dhe funksionimit të sistemit. Auditimi dhe raportimi kryhen jo më vonë se 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Raporti i auditimit shqyrtohet në KQZ në seancë publike”.

²⁸ Pika 3 e “Qëllimi”-t, Shtojca III e Kodit Zgjedhor: “Akti normativ i KQZ-së mund të ndryshojë ndonjë nga procedurat e parashikuara në këtë shtojcë, nëse ndikon në optimizimin e SEV-it, por në çdo rast pa prekur parimet e përcaktuara në seksionin 2.”

²⁹ Pika 1, Seksioni 3 “Përdorimi i pajisjeve të leximit në qendrën e votimit dhe personeli”, Shtojca III e Kodit Zgjedhor: “Shtrirja e SEV-it dhe përcaktimi i qendrave të votimit, në të cilat, për arsye teknike, nuk mund të përdoret SEV-i, përcaktohen nga KQZ-ja jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.”

Duke qenë i materializuar në një akt individual, siç janë më së shumti vendimet e KQZ-së, por edhe duke patur një vendimmarrje imperative (detyruese), kuptojmë që emërtimi si plan “orientues” nuk qëndron i saktë. Ky plan orientues duhet të shihet si një akt, si edhe shumë dispozita të tjera në kuadrin ligjor për organizimin e zgjedhjeve, që nuk përmban në brendinë e tij shprehimisht sanksionin apo penalitetin për moszbatim.

Kjo mungesë e këtyre dispozitave nuk i zhvesh ato nga normativja, sepse gjenden të tjera dispozita që mund të qartësojnë se kush janë penalitetet për administratën shtetërore kur nuk përmbushet detyra apo kur ka shkelje në kryerjen e saj.

Kjo trajtesë është e nevojshme sepse disa herë në argumentimin e administratës apo të komisionerëve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, **pohohet që ai është një plan vetëm orientues.**

Në konsideratën e KVV-së, ai është një **akt që ngarkon detyrime në zbatimin e tij si të gjithë aktet e tjera.**

C2. KOMISIONET E ZONAVE TE ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Legjislacioni Zgjedhor parashikon se Zgjedhjet për Kuvendin administrohen në nivelin e dytë nga 89 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

Numërimi i votave do të bëhet në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), prej Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Përbërja e KZAZ-ve

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen sipas një formule përfaqësimi që synon të garantojë balancën politike³⁰. Anëtarët i shtatë në KZAZ-të me numër tek do të propozohet nga Partia Socialiste, ndërsa në KZAZ-të me numër çift propozohet nga Partia Demokratike³¹. Sekretari i KZAZ-ve është jurist dhe propozohet nga partia e cila propozon zëvendëskryetarin e komisionit (*neni 29/1/c*).

Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit/es, anëtarëve dhe sekretarit/es të KZAZ-së përcaktohen nga neni 33 i Kodit Zgjedhor³² si dhe në Udhëzimin Nr. 2 datë 25.02.2009 dhe Udhëzimin Nr. 3 datë 19.02.2013³³ të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

³⁰ Neni 29 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkrime, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtarët i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kritereve objektive të bazuara në:

i) përzgjedhjen rastësore;

ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;

c) sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së;”

³¹ Vendimi Nr. 3, datë 7.01.2013 i KQZ-së: “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve”

³² Neni 33 i Kodit Zgjedhor: “KZAZ-ja kryen këto detyra:

a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;

b) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtaërt e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi;

c) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë;

Pas dorëzimit nga ana e partive politike të listave të anëtarëve të KZAZ-ve, KQZ bëri verifikimet përkatëse dhe në mbledhjen e datës 25 mars 2013 vendosi konstituimin e tyre.

Përbërja e tyre në momentin e konstituimit i referohej balancave politike në Kuvendin e Shqipërisë. Kështu, dy anëtarë të KZAZ-së u propozuan nga Partia Demokratike, dy anëtarë u propozuan nga Partia Socialiste, një anëtar u propozua nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe një anëtar u propozua nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.³⁴

Por, lëvizjet që ndodhën brenda koalicionit të maxhorancës në parlament, të cilat pasuan edhe me shkarkimin e një prej anëtarëve të KQZ dhe emërimin në vend të tij të një anëtari përfaqësues të një force tjetër politike, u pasqyruan edhe në përbërjen e KZAZ-ve.

Me katër anëtarë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shqyrtoi në vazhdim rikonfigurimin e këtyre komisioneve.

Me Vendimin Nr. 265, të datës 23.04.2013, KQZ pranoi pjesërisht kërkesën e Partisë Republikane “Për përcaktimin e Partisë Republikane si parti që ka të drejtë të paraqesë propozime për anëtarë të KZAZ-ve, KQV-ve në rang vendi dhe të marrë pjesë në shortin për propozimin e anëtarit të GNV-së”.

Me këtë vendim KQZ-ja amendoi gërmën “c”, të pikës 1 të vendimit të KQZ-së Nr.1, datë 07.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”³⁵. Amendimi përcaktoi Partinë Republikane si parti e dytë më e madhe e mazhorancës, duke i dhënë të drejtën për të patur anëtarin e saj në KZAZ.

Me një tjetër vendim, KQZ-ja pranoi kërkesën e Lëvizjes Socialiste për Integrim për të patur anëtarin e saj në KZAZ³⁶, tanimë si forca e dytë më e madhe e opozitës.

ç) afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë;

d) administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;

dh) garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit;

e) merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit;

ë) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi;

f) regjistron subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore;

g) shpall kandidatët fitues për kryetar të njësisë vendore”

³³ Udhëzimi nr.3 data 19.02.2013 i KQZ-së: “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

³⁴ Vendimi Nr. 1 datë 7.01.2013 i KQZ-së: “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”.

³⁵ Vendimi Nr. 265 datë 23.04.2013 i KQZ-së: “Nisur nga fakti se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim deklaroi largimin e saj nga grupi i partive që i përkasin shumicës parlamentare, rezultoi se vendimi i KQZ-së nr. 1, datë 7.01.2013 pjesërisht nuk i përgjigjet më rrethanave apo kushteve konkrete, duke u bërë njëkohësisht edhe pengesë për rregullimin e mëtejshëm të marrëdhënieve juridike, pasi me kushtet e reja të krijuara, prish pikërisht baraspeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-ve. Në këto kushte KQZ si organi administrativ i cili ka nxjerr vendimin nr. 1, datë 7.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013” në bazë të nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative ka të drejtë të bëjë ndryshimin e tij, në mënyrë që të respektojë dispozitat e Kodit Zgjedhor për sa i përket përbërjes së KZAZ-ve.”

³⁶ Vendimi Nr. 270 datë 24.04.2013 i KQZ-së: “Për caktimin e anëtarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në përbërje të KZAZ-ve”

Me këtë vendim KQZ-ja amendoi gërmën “d”, të pikës 1 të vendimit të KQZ-së Nr.1, datë 07.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”.

Ndërkohë, në lidhje me anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, KQZ-ja u shpreh me Vendimin Nr. 272, datë 25.04.2013.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi se PBDNJ sipas Vendimit Nr.1, datë 07.01.2013, të amenduar me Vendimin Nr. 266 dhe Nr. 270, nuk ka më të drejtë të përfaqësohet me anëtarë në KZAZ, sepse nuk është më forca e dytë më e madhe e opozitës. Me këtë arsye KQZ vendosi për lirim të komisionerëve të KZAZ-ve të emëruar nga PBDNJ.

KVV në ecurinë e kësaj çështjeje vëren se pavarësisht legjitimitetit në frymën e Kodit, formalisht Kodi Zgjedhor i liston në mënyrë shteruese të gjitha rastet për shkarkimin apo lirim të komisionerëve të KZAZ-ve, dhe nuk parashikon argumentimin e përdorur më sipër nga KQZ³⁷.

Aktualisht, KZAZ-të funksionojnë me këtë përbërje: dy anëtarë të propozuar nga Partia Demokratike (plus një anëtar në KZAZ-të me numër çift dhe një sekretar në KZAZ-të me numër tek), 2 anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste (plus një anëtar në KZAZ-të me numër tek dhe një sekretar në KZAZ-të me numër çift), 1 anëtar i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe 1 anëtar i propozuar nga Partia Republikane.

Numri i ZAZ-ve ndryshoi nga 66 që ishin në 2009 në 89 ZAZ. Administrimi i procesit zgjedhor në nivelin e dytë në këto zgjedhje do të administrohet nga 23 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor më shumë se më parë, pra në total nga 89 KZAZ. Vendndodhja e 81 KZAZ-ve në këto zgjedhje është në qytet ndërsa e 8 të tjerave në fshat.

Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve

Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve është konsideruar prej KVV-së si një nga elementet më të rëndësishme, që ndikon direkt në mbarëvajtjen e procesit, pasi janë pikërisht këto komisione që administrojnë procesin në nivel lokal, madje ato mund të konsiderohen si “KQZ-të lokale”.

Në lidhje me procesin e trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve, KVV vëren se ai ka qenë i vonuar. Kodi Zgjedhor në nenin 21 pika 9 të tij³⁸ parashikon se **KQZ-ja organizon trajnimin dhe teston anëtarët e KZAZ-ve**, jo më vonë se 30 ditë nga dita e emërimit të tyre, **pra jo më vonë se data 24 prill 2013**.

Trajnimi i trajnerëve të KZAZ-ve, është bërë në datat 26 dhe 27 prill 2013. KQZ ka trajnuar 48 trajnerë të cilët duhet të trajnonin anëtarët e KZAZ-ve.

Sipas raportimeve të bëra nga vëzhguesit e KVV-së në terren, trajnimet e anëtarëve të KZAZ-ve janë bërë në datat 16, 17 dhe 18 maj 2013.

³⁷ Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 32 “Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së”.

³⁸ Neni 21 pika 9 e Kodit Zgjedhor: “KQZ kryen, me shpenzimet e veta, kurse trajnimi jo më vonë se 30 ditë pas emërimit të anëtarëve të KZAZ-ve dhe në përfundim të tyre, pas kryerjes së testeve, u jep atyre dëshminë përkatëse. Për anëtarët e KQV-ve kryen, me shpenzimet e veta, sesione kualifikimi për legjislacionin zgjedhor. KQZ-ja merr masa dhe organizon edhe programe për edukimin zgjedhor të shtetasve.”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin Nr. 19 datë 28.01.2013, ka miratuar strategjinë e trajnimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore për zgjedhjet e 23 Qershorit.

Në zbatim të strategjisë së trajnimit, Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve (Sektori i Trajnimeve), ka përgatitur Manualin e KZAZ-së.

Manuali i KZAZ-ve është miratuar nga KQZ me vendimin nr. 267 datë 23.04.2013, ndërkohë që në **planin e punës së KQZ ishte parashkikuar të miratohej në datën 23 janar 2013.**

Kuotat gjinore në përbërjen e KZAZ-ve

Kodi Zgjedhor parashikon zbatimin e kuotave gjinore për anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike.

Në nenin 29, pika 1, gërma ç³⁹ parashikohet se 30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.

Në propozimet e para të bëra nga partitë politike për anëtarë të KZAZ-ve, rezulton se Partia Socialiste ka propozuar 80 anëtare gra nga 267 gjithësej, Partia Demokratike 89 gra nga 267 anëtarë gjithësej, partia LSI 8 gra nga 89 gjithësej dhe PBDNJ 14 gra nga 89 anëtarë gjithësej.

Duhet theksuar se ndryshimet e bëra me propozimin e forcave politike apo ato që mund të bëhen **nuk duhet të ndikojnë në prishjen e këtyre balancave gjinore të formuara tashmë nëpër KZAZ.**

Vendet e Numërimit të Votave

Numërimi i votave do të bëhet në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), prej Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

VNV-të duhet të jenë në vende me hapësirë të madhe dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 12 datë 21.04.2009 të KQZ-së⁴⁰. Vendndodhja e VNV-ve caktohet me vendim të KQZ-së.

Duke i'u referuar nenit 94 pika 1 të Kodit⁴¹, KQZ-ja merr vendim për përcaktimin e VNV-ve jo më vonë se data 14 maj 2013. Aktualisht KQZ është ende në proces të caktimit të VNV-ve, **pra ende nuk është përfunduar ky proces nga ana e KQZ-së.**

³⁹ Nenin 29 pika 1 gërma “ç” e Kodit Zgjedhor: “30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.”

⁴⁰ Udhëzim Nr. 12 datë 21.04.2009: “Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”.

⁴¹ Neni 94 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendingun e Numërimit të Votave. Në përcaktimin e Vendingut të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen. Në përzgjedhjen e vendit të VNV-së, KQZ-ja i jep përparësi lehtësive logjistike të transportit rrugor, distancës nga qendrat e votimit dhe hapësirave të objekteve të mundshme. Si rregull, Vendi i Numërimit të Votave nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën. VNV-ja caktohet në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Vendet e Numërimit të Votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të Vendingut të Numërimit të Votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve. Në përzgjedhjen e vendit, KQZ-ja duhet të marrë parasysh edhe mundësinë për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, sipas pikës 4 të këtij neni.”

C3. KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT

Procesi i Votimi në Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013 do të kryhet në 5506 Qendra Votimi dhe do të administrohet nga 5506 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).

Komisioni i Qendrës së Votimi ndërtohet me të njëjtën formulë të ndërtimit të KZAZ-së.

Në bazë të nenit 36 pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQV-të emërohen nga KZAZ-të në çdo rast jo më vonë se data 3 Qershor⁴².

Sipas planit të punës së KQZ-së të miratuar me vendim nga ana e saj, **trajnimi i komisionerëve të qendrave të votimit duhet të bëhet brenda datës 23 maj 2013**, ndërsa **manuali i qendrave të votimit duhet të ishte miratuar brenda datës 5 prill 2013**, ndërkohë asnjë nga këto nuk është kryer ende.

KQZ-ja ende nuk ka një ndarje përfundimtare të adresave të qendrave të votimit, dhe për rrjedhojë edhe një ndarje të QV-ve që ndodhen në adresa private, publike apo të posaçme.

Sipas informacioneve të marra nga KQZ-ja, ende është duke u punuar për manualin e qendrave të votimit, i cili pritet të miratohet brenda javës së fundit të majit.

D. LISTAT DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Kodi Zgjedhor ka parashikuar në mënyrë të përmirësuar çështjen e listave të zgjedhësve si dhe mekanizmin përkatës. Ky mekanizëm në hartimin dhe saktësimin e listave të zgjedhësve përbëhet nga disa operatorë, si Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Njësitë Vendore, vetë zgjedhësit, etj.

Ky mekanizëm fillon automatikisht punë me dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës⁴³ dhe vazhdon deri në ditën kur do mbahen zgjedhjet.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 8 dhjetor 2012, urdhëron Zyrat e Gjendjes Civile të fillojnë procesin e hartimit të listave të zgjedhësve⁴⁴.

Jo më vonë se 30 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 3 janar 2013, ligji parashtron detyra përkatësisht për “Zyrat e Gjendjes Civile, të cilat pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre⁴⁵”, si dhe për Ministrinë e Brendshme dhe KQZ-në të cilat duhet të “publikojnë në faqet përkatëse zyrtare të internetit ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi”⁴⁶.

⁴² Neni 36 pika 2 e Kodit Zgjedhor: “Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Propozimet për anëtarë dhe sekretar të KQV-së bëhen jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme 20 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 37 dhe 38 të këtij Kodi. Në çdo rast emërimi i kryetarit dhe sekretarit bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.”

⁴³ Neni 51 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve, urdhëron zyrat e gjendjes civile të fillojnë procesin e hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me këtë Kod.”

⁴⁴ Neni 51 pika 4 e Kodit Zgjedhor

⁴⁵ Neni 51 pika 5 e Kodit Zgjedhor

⁴⁶ Neni 51 pika 7 e Kodit Zgjedhor

Gjatë kësaj faze për përgatitjen e listave të zgjedhësve, ngarkohet tërësisht Zyra e Gjendjes Civile.

Pjesë e mekanizmit të sipërpërmendur janë edhe Njësitë e Qeverisjes Vendore, Kryetarëve të të cilëve iu ngarkohen dy detyra kryesore prej Kodit Zgjedhor.

Detyrimi i parë është publikimi në mënyrë periodike çdo 30 ditë i listave paraprake⁴⁷ deri në shpalljen e listës përfundimare prej Gjendjes Civile në datën 14 Maj⁴⁸.

Detyrimi i dytë është njoftimi me shkrim i çdo zgjedhësi që banon në territorin e njësisë vendore, jo më vonë se 60 ditë nga data e publikimit të parë të listave, pra jo më vonë se data 4 Mars 2013.

Në këtë mekanizëm rol vendimtar kanë vetë zgjedhësit të cilëve iu sigurohet vënia në dijeni nëse figurojnë në lista si dhe mundësia e ankimit për të saktësuar apo korigjuar të dhënat e tyre në këto lista.

Deri në 60 ditë para datës së zgjedhjeve, qytetarët kanë të drejtë të dorëzojnë kërkesat për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë (listat paraprake) në zyrat e gjendjes civile⁴⁹.

Në rast refuzimi të kësaj kërkesë, ata kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës brenda pesë ditëve nga vënia në dijeni të refuzimit të kërkesës nga zyra e gjendjes civile⁵⁰.

Pas datës 14 maj 2013, nëse zgjedhësit vërejnë se kanë pasaktësi në të dhënat e tyre apo nuk figurojnë fare në lista, atëherë ai duhet t'i drejtohet gjykatës⁵¹ deri më datën 21 qershor.

Vendimi i gjykatës i jep zgjedhësit të drejtën të votojë në qendrën përkatëse të votimit, ku Komisioni i Qendrës së Votimit e shënon emrin e tij në një regjistër të posaçëm duke i bashkangjitur edhe vendimin e gjykatës.

Në zbatimin dhe funksionimin gjashtëmujor të këtij mekanizmi janë vërejtur disa problematika kryesore:

⁴⁷ Neni 51 pika 7 e Kodit Zgjedhor “*Publikimi, sipas pikës 4 të këtij neni, përsëritet në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve. Çdo publikim duhet të pasqyrojë çdo ndryshim të përbërësve zgjedhorë të RKGJC-së që është bërë nga publikimi paraardhës deri në momentin e publikimit të ri.*”

⁴⁸ Neni 56 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “*Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGJC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.*”

⁴⁹ Neni 54 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “*Me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 2 shkronja “c” të nenit 53, kërkesat për ndryshime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë nuk mund të paraqiten më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.*”

⁵⁰ Neni 55 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “*Kundër mospranimit të kërkesës për ndryshim të përbërësit zgjedhor, për shkaqet e parashikuara në nenin 53 dhe sipas procedurave të nenit 54 të këtij Kodi, mund të bëhet ankim nga kërkuesi në gjykatën e rrethit gjyqësor, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësisia e qeverisjes vendore. Ankimi bëhet jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni për vendimin ose nga kalimi i afatit për marrjen e vendimit mbi kërkesën nga zyra e gjendjes civile. Kërkesëpaditë, sipas këtij neni, përjashtohen nga pagesa e taksës së shërbimit gjyqësor.*”

⁵¹ Neni 57 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “*1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.*”

a) Mosrespektimi i afatave të parashikuara në Kodin Zgjedhor

Afatet kohore të kërkuara nga ligji zgjedhor ka qenë një nga pikat më të dobëta të këtij procesi. **Mosrespektimi i afatave të parashikuara ka krijuar shqetësime** ose ka krijuar handikape në funksionimin e mekanizmit.

Njoftimi me shkrim i zgjedhësve është elementi më i rëndësishëm në përgatitjen e listave.

Ky njoftim duhet përmbante qendrën e votimit, vendodhjen, adresën dhe numrin rendor të zgjedhësve në listën përkatëse të qendrës së votimit⁵².

Dorëzimi i njoftimit me shkrim nga personat e ngarkuar nga kryetarët e njësive vendore, shoqërohet dhe me firmosjen në momentin e marrjes së letrës së njoftimit prej qytetarit⁵³.

Ky proces duhej të ishte mbyllur brenda 60 ditëve nga data e publikimit të parë të listave, pra deri më datën 4 mars, **por në fakt filloi në ditët e para të muajit mars**, pasi në këtë kohë Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile gjeneroi pranë Zyra të Gjendjes Civile pranë Njësive Vendore modelin e njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

Në vazhdim, **Ministria e Brendshme nuk pati asnjë qëndrim ose raport zyrtar mbi këtë çështje.**

Përsa Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka monitoruar dhe vërejtur konstatohet se:

- **Nuk pati asnjë udhëzim prej Ministrisë së Brendshme** sesi duhej të vepronin Njësitet Vendore për të vazhduar një proces për të cilin praktikisht nuk ekzistonte më asnjë detyrim ligjor, pasi dispozitat ligjore që e rregullonin këtë proces e humbën fuqinë e tyre në datën 4 mars 2013.

- Në ato Njësi të Qeverisjes Vendore ku pati njoftim me shkrim të zgjedhësve, **nuk u morën firmat e personave që u njoftuan.** Pra nuk ka patur një formalitet ligjor në këtë njoftim dhe për më tepër lë shkas për fiktivitet.

- Nuk pati **asnjë shifër zyrtare sa zgjedhës u njoftuan dhe sa mbetën pa u njoftuar.**

Duke mos patur asnjë detyrim ligjor, njoftimi i zgjedhësve u bë sipas vullnetit të përfaqësuesve të njësive vendore, duke lënë shteg për njoftime të njëanshme sipas përkatësive politike të të zgjedhurve vendorë.

b) Mospërmbushja e detyrave ligjore nga Ministria e Brendshme

Në lidhje me ecurinë e saktësimin të listave, Ministria e Brendshme ka bërë pesë deklarata për shtyp⁵⁴.

Problematika që shihet në këto deklarata është numri i rekordeve të personave me pjesë të adresës zgjedhore të paidentifikuar (kodi i banesës i panjohur brenda një qendre votimi të caktuar).

Vetëm në deklaratën e datës 03.04.2013, Ministria e Brendshme jep një numër për rekordet e këtyre personave, që sipas saj janë rreth 545 000 për muajin janar dhe 405 779 për muajin prill.

Në deklaratat e tjera të mëparshme, **nuk pasqyrohet sesi ka lëvizur numri i rekordeve të këtyre personave dhe nuk thuhet se çfarë masash ka marrë kjo ministri.**

⁵² Neni 52 pika 2 e Kodit Zgjedhor: “Lajmërimi me shkrim përmban qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit.”

⁵³ Neni 52 pika 4 e Kodit Zgjedhor: “Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtar madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit. Kryetari i njësive së qeverisjes vendore raporton për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.”

⁵⁴ Deklarata për shtyp të Ministrisë së Brendshme, “Informacion rreth ekstraktit të Listës së Zgjedhësve”; datë 06.02.2013, datë 06.03.2013, datë 03.04.2013, datë 04.04.2013, datë 13.05.2013.

Në deklaratën e fundit, të datës 13.05.2013, Zv/ Ministri i Brendshëm z. Ferdinand Poni deklaroi se “nuk ka zgjedhës në Republikën e Shqipërisë pa adresë zgjedhore të identifikuar” dhe se “ky numër është zero”⁵⁵.

Sipas auditit teknikien z. Dashamir Cali në raportin e datës 10.04.2013, numri i personave me kod të banesës së panjohur brenda qendrës së votimit është 403 387 persona. Ndërsa auditit teknikien z. Genti Malko nuk jep shifër në raportin e tij mbi këtë temë.

Me numrin e rekordeve që jep Ministria e Brendshme dhe njëri prej auditëve teknikienë në muajin prill, bëhet fjalë për rreth 1/10 e votuesve që të jenë me kod të banesës së panjohur brenda qendrës së votimit.

Një fakt ky për të cilin Ministria e Brendshme duhet domosdoshmërisht të bëjë më shumë transparencë.

Sipas raportimit të auditit teknikien z. Dashamir Cali, gjatë të katër raporteve të tij në këto muaj ekzistojnë dy shqetësime të mëdha sipas tij.

Dy shqetësime kanë të bëjnë me rekordet e personave të dyshuar si të dubluar dhe personat që në ekstraktin e përbërësve zgjedhore kanë rubrika të parregullta⁵⁶.

Në raportin e tij të fundit të datës 10.04.2013, ai flet për 33 680 rekorde me dyshim të lartë si të dubluara dhe 4 038 rekorde me gabime në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë.

I ndryshëm është qëndrimi i auditit tjetër z. Genti Malko.

Në raportin e tij të datës 10.04.2013 flet për 2 928 rekorde të dyshuara si të dubluara.

Ndërkohë, edhe vetë Ministria e Brendshme, ka pranuar që në listën përfundimtare të zgjedhësve kanë mbetur 1 139 rekorde të dyshuara si dublime.

Ndonëse shifrat e sipërpërmendura i përkasin muajit prill (shifrat e dhëna nga auditët) dhe muajit maj (Ministria e Brendshme), vihet re lehtësisht një mospërputhje nga të gjitha referencat.

Këto mospërputhje në raportime para së gjithash vënë **pikëpyetje mbi profesionalizimin dhe ekspertizën e auditëve teknikienë, duke lënë vend për dyshime të forta në lidhje me objektivitetin apo politizimin e vullnetshëm të punës së tyre.**

Kjo mospërputhje shifrash duhej të përbënte shqetësim serioz për Ministrinë e Brendshme e cila duhej të sqaronte publikisht dhe me transparencë të plotë pozicionin e saj, si edhe për vetë Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve i cili duhet t'i merrte në shqyrtim seriozisht ato dhe të kërkonte shpjegime zyrtare përkatëse edhe nga auditët edhe nga Ministria e Brendshme.

⁵⁵ Njoftim për Shtyp i Ministrisë së Brendshme “Njoftim mbi gjenerimin e Listës Përfundimtare të zgjedhësve për Zgjedhjet e Përgjithshme të 23 qershorit 2013” datë 13.05.2013: “Nuk ka asnjë zgjedhës në Republikën e Shqipërisë pa adresë zgjedhore të identifikuar, - ky numër është zero! Ata shtetas që i quani me numrat 888 ose 999 e dinë mirë se në cilën bashki a komunë do të votojnë dhe numrin e qendës së votimit. Ajo që nuk dinë bashkitë apo komunat, në gjysmën e të cilave drejtojnë socialistët, është shtëpia ku këta qytetarë banojnë. Ndonjëherë shtëpia mund të jetë në Itali apo Amerikë apo vend tjetër, prandaj nuk ka se si të duket pjesa e adresës së banimit të shtetasit. Kjo vjen për shkak të detyrimit tone sine qua non, që të jetë në listë çdo qytetar mbi 18 vjeç, pavarësisht nëse e dinë apo jo adresën e shtëpisë së tij.”

⁵⁶ Janë përdorur shenja të pikësimit të pa lejuara nga ana drejtshkrimore dhe sintaksore, janë lënë pa plotësuar rubrika, ose janë bashkuar në një rubrikë të vetme dy informacione të njëpasnjëshme.

c) Mosmbikqyrja e procesit të përgatitjes së listave nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Ndryshe nga legjislacionet e mëparshme, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve prej disa vitesh nuk ka më rolin kryesor në përgatitjen e listave të zgjedhësve.

Gjithsesi, KQZ nuk është jashtë këtij procesi, përkundrazi, Kodi Zgjedhor i jep Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve rolin e vëzhguesit dhe të mbikqyrësit të përgatitjes së listave dhe institucioneve që janë të ngarkuara për këtë⁵⁷.

Në funksion të kësaj detyre, KQZ-së i jepet dhe një instrument efikas për ta kryer këtë detyrë, që janë dy auditët teknikienë, të cilët verifikojnë veprimet në bazën e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile⁵⁸.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë nëpërmjet qëndrimeve zyrtare⁵⁹ të tij i ka bërë të ditur publikisht nevojën për udhëzuar dhe të orientuar metodologjikisht auditët teknikienë në mënyrë që të krijojë lehtësisht një gjykim të saj mbi të dhënat që paraqiten.

Në marrëdhënien “raportim i auditëve teknikienë – qëndrim i KQZ-së”, KVV konstaton se **KQZ-ja raportimet e dy auditëve teknikienë ia ka përcjellë Ministrisë së Brendshme pa patur interesim për të ndjekur ecurinë e mëtejshme të zbatimit të tyre.**

Qëndrimi i trupës së komisionerëve të KQZ-së ka qenë indiferent në mbledhjet dëgjimore të raporteve të auditëve, madje Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në këtë proces duket se e ka parë veten thjesht si një “urë përcjellëse” e këtyre rekomandimeve.

d) Padijenja dhe mosrespektimi i detyrave nga Njësitë e Qeverisjes Vendore

Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë si detyrë kryesore publikimin periodik çdo 30 ditë të listave të zgjedhësve. Gjithashtu, ato kanë për detyrë ndarjen e qendrave të votimit në përputhje me kriterin numerik që vendos Kodi Zgjedhor, kryerjen e njoftimit me shkrim të zgjedhësve, përgatitjen e listave të personave të verbër, etj.

Në këto detyrime të Kodit Zgjedhor, gjatë vëzhgimit të KVV-së, është vërejtur një nivel i lartë i moszbatimit të tyre.

Më shqetësues është fakti së një nga arsyet për moszbatimin e detyrimeve ligjore është **mungesa e informacionit ligjor që kanë njësitë vendore për detyrat që mbartin.**

Me Vendimin Nr. 27, datë 22.02.2013, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve gjobiti 139 kryetarë të Njërive të Qeverisjes Vendore për mos paraqitje në kohë të listave të qendrave të votimit në përputhje me kriteret që vendos ligji zgjedhor.

Një veprim ky i domosdoshëm i KQZ-së që e ndihmoi procesin në ecurinë e vet, pavarësisht ekzistencën ende të saj, ndonëse e minimizuar ndjeshëm. Shembull i kësaj problematike të zgjatur është vendimi i KQZ-së i datës 17.05.2013, ku urdhëron Kryetarin e Komunës Bërdicë, qarku Shkodër, të bëjë ndarjen e Qendrës së Votimit 0215 duke krijuar qendër votimi shtesë brenda të së njëjtës zonë.

⁵⁷ Neni 50 pika 3 e Kodit Zgjedhor: “KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi. KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njërive të qeverisjes vendore”.

⁵⁸ Neni 61 pika 7 e Kodit Zgjedhor: “Auditët teknikienë i paraqesin një raport auditimi çdo muaj KQZ-së për gjetjet e auditimit, sipas detyrave të përcaktuara nga KQZ-ja ose për vërejtje apo çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes civile”.

⁵⁹ Raporti i Parë i Ndërmjetëm “Rekomandime”, datë 18.03.2013: “KQZ duhet të orientojë auditët teknikienë për mënyrat e raportimit në mënyrë që të krijojë një gjykim të drejtë mbi raportet që i paraqiten”. Për më shumë tek: <http://www.zgjedhje.al/uploads/File/KVV%20-%20Raport%20I%20-%2018Mars2013.pdf>

E. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në nenin 64 pika 1⁶⁰ parashikon se partitë politike duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim pranë KQZ-së jo më vonë se 70 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 14 prill 2013.

Në mbledhjen e datës 19 prill 2013, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shqyrtoi kërkesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore, ku rezultoi se kishin paraqitur kërkesën për regjistrim 71 parti politike.

KQZ miratoi kërkesën e 66 prej tyre si dhe vendosi për rrëzimin e kërkesës për 5 parti politike për shkak të pasaktësisë në dokumentacionin e paraqitur apo për shkak të paraqitjes së kërkesave jashtë afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor⁶¹.

Këto të fundit apeluan vendimin e KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor të Apelit dhe vetëm për dy prej tyre⁶², Kolegji vendosi regjistrimin si subjekte politike pranë KQZ.

Pas regjistrimit të partive politike për të marrë pjesë në zgjedhjet e 23 qershorit, neni 65 i Kodit Zgjedhor jep mundësinë që dy ose më shumë subjekte politike të mund të bashkohen dhe regjistrohen në KQZ si koalicionë zgjedhore jo më vonë se 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Pas propozimeve të bëra nga subjektet zgjedhore, KQZ shqyrtoi në mbledhjen e datës 3 maj 2013, projektvendimin për regjistrimin si subjekte zgjedhore të dy koalicionëve zgjedhore: “*Aleanca për Shqipërinë Europiane*” dhe “*Aleanca për Punësim, Mirëqënie dhe Integrim*”.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi regjistrimin e Koalicionit “*Aleanca për Punësim, Mirëqënie dhe Integrim*” si subjekt zgjedhor me 25 parti politike pjesëtare nga 27 parti politike të propozuara si pjesë e këtij koalicioni⁶³, si dhe regjistrimin e Koalicionit “*Aleanca për Shqipërinë Europiane*”, si subjekt zgjedhor me 37 parti politike nga 40 parti politike të propozuara si pjesë e këtij koalicioni⁶⁴.

Përfundimisht, në Zgjedhjet e 13 qershorit do të marrin pjesë koalicioni “*Aleanca për Shqipërinë Europiane*” i cili ka në përbërjen e tij 37 subjekte zgjedhore⁶⁵; koalicioni

⁶⁰ Neni 64 i Kodit Zgjedhor “*Regjistrimi i partive politike në zgjedhje*” pika 1: “*Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve*”.

⁶¹ *Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë, Partia e Pajtimit Kombëtar, Partia Alternativa Liberale, Partia e Emigracionit Shqiptar dhe Partia Civile.*

⁶² *Partia e Emigracionit Shqiptar dhe Partia e Pajtimit Kombëtar.*

⁶³ *Kjo sepse pasi KQZ bëri verifikimet përkatëse konstatoi se Partia Civile e Shqipërisë nuk ishte regjistruar si subjekt zgjedhor pranë këtij institucioni, në zbatim të Kodit Zgjedhor, neni 65 pika 1.*

⁶⁴ *KQZ pasi bëri verifikimet përkatëse konstatoi se Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë dhe Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë nuk ishin të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ.*

*Ndërsa Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, ka depozituar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve kërkesën me anë të së cilës njoftoj se marrëveshja për pjesëmarrje në koalicionin “*Aleanca për Shqipërinë Europiane*” ishte e pavlefshme, pasi PBPPSH kishte firmosur një tjetër marrëveshje për të qënë pjesë e koalicionit “*Aleanca për Punësim Mirëqënie dhe Integrim*”.*

⁶⁵ *Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Ambjentaliste, Partia Ardhmeria Shqiptare, Partia Bashkimi Republikan Shqiptar, Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, Partia e Çështjeve Shqiptare, Partia e Gjellbër, Partia e Punës e Shqipërisë, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Unitetit Kombëtar, Partia G99, Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia Komuniste e Shqipërisë 8-Nëntori, Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim, Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve, Partia Mendimi i Djathtë Liberal, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia Personat me Aftësi të Kufizuar, Partia Rruga e Lirisë, Partia Shqiptare Atdheu, Partia Socialpuntore Shqiptare, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Socialiste e Vërtetë 91, Partia Toleranca e Re e*

“Aleanca për Punësim, Mirëqënie dhe Integrim” i cili ka në përbërjen e tij 25 subjekte zgjedhore⁶⁶, si edhe 4 subjekte zgjedhore që do të garojnë më vete jashtë këtyre koalicioneve: Partia “Fryma e Re Demokratike”, Partia “Aleanca Kuq e Zi”, Partia “Lidhja për Drejtësi e Progres” si dhe Partia “Partia Popullore Kristian Demokratë”.

Kodi zgjedhor siguron gjithashtu të drejtën e individëve për të konkurruar si kandidatë të pavarur.

Duke u bazuar në nenin 69 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ-së kanë paraqitur kërkesë për të kandiduar si kandidatë të pavarur 7 kandidatë, 5 prej të cilëve janë kandidatë të propozuar nga zgjedhësit⁶⁷, ndërsa 2 të tjerët⁶⁸ duke qenë deputetë në legjislaturën e fundit të Kuvendit, përfitojnë lehtësira duke u përjashtuar nga detyrimi i mbledhjes së nënshkrimit të zgjedhësve mbështetës⁶⁹.

Nga 5 kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, dy prej tyre⁷⁰ nuk janë regjistruar nga KQZ për shkak të mangësive apo kalimit të afatit, ndërkohë që tre të tjerët nuk e vazhduan procesin e regjistrimit.

Listat shumëemërore të kandidatëve të 66 subjekteve politike⁷¹ u paraqitën pranë KQZ-së në orët e fundit të datës 6 maj 2013.

Partitë politike në këto zgjedhje nuk i kushtuan aspak rëndësi prezantimit të kandidatëve jo vetëm për publikun e gjerë, por as për elektoratin e tyre.

Shqipërisë, Partia Ligji dhe Drejtësi, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, Partia e Punës së Shqipërisë e Riorganizuar, Partia Demokracia Sociale, Partia Social Demokratë, Partia Aleanca Demokristiane, Partia Pajtimin Kombëtar si dhe Partia Aleanca Popullore.

⁶⁶ Partia Demokratike, Partia Republikane, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Agrare Ambjentaliste, Partia Lidhja Demokristiane, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Balli Kombëtar, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia e të Drejtave të Mohuara e Re, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Partia Konservatore, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Lëvizja Shqipëria e Re, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Demokracia e Re, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet si dhe Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare.

⁶⁷ Neni 69 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “Një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore, i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në nenin 63 të këtij Kodi, jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve”.

Kandidatët e paraqitur: z. Aziz Jata (në Zonën Zgjedhore Tiranë), z. Alket Troka (në Zonën Zgjedhore Fier), znj. Laureta Gjoni (në Zonën Zgjedhore Vlorë), z. Skënder Tufa (në Zonën Zgjedhore Tiranë) si dhe z. Sazan Guri (në Zonën Zgjedhore Tiranë).

⁶⁸ Z. Arben Malaj (në Zonën Zgjedhore Vlorë) dhe z. Dritan Prifti (në Zonën Zgjedhore Fier).

⁶⁹ Neni 69, pika 4 e Kodit Zgjedhor: “Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni nëse janë deputetë. Në këtë rast, kandidati paraqet një vërtetim me shkrim të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”.

⁷⁰ - KQZ ka marrë vendim për mosregjistrimin e znj. Laureta Gjoni si kandidate e pavarur në Zonën Zgjedhore Vlorë, për arsye se pas verifikimit të kryer nga administrata e KQZ rezultoi se të gjitha fotokopjet e letërnjoftimeve të zgjedhësve mbështetës, nuk ishin të nënshkruara prej tyre. Ky fakt bie ndesh me nenin 71, pika 2 (Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse.)

- Po ashtu, KQZ ka refuzuar kërkesën si kandidat i pavarur në Zonën Zgjedhore Tiranë, të z. Sazan Guri, për shkak të paraqitjes së kësaj kërkesë jashtë afatit ligjor të 14 Prill-it.

⁷¹ Neni 67 pika 1 të Kodit Zgjedhor: “Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve”.

Lista e kandidatëve u hartua dhe u dorëzua në momentet e fundit pranë KQZ-së, duke mbetur kështu veç kandidatë të cilët gëzojnë më së shumti besimin e kryetarit të partisë respektive dhe jo të forumeve të gjera të partive të tyre.

Sikundër ishte paralajmëruar nga organizatat e shoqërisë civile, rezultoi se listat e kandidatëve për deputetë në një pjesë të mirë të tyre nuk i respektuan dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor⁷², mbi balancën gjinore.

Në këto kushte KQZ vendosi të gjobisë për mosrespektimin e kuotës gjinore (pjesëmarrjen e ulët të grave) tre partitë kryesore politike⁷³.

Gjithashtu, sanksion ligjor u mor edhe për një subjekt tjetër zgjedhor i cili nuk kishte respektuar kuotën gjinore, përsa i përket përfaqësimit të burrave në listat e kandidatëve⁷⁴.

F. FUSHATA ZGJEDHORE

Megjithëse sipas nenit 77 të Kodit Zgjedhor fushata elektorale duhet të fillojë 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, është evidente tashmë që të gjitha partitë politike e kanë filluar atë.

Pothuajse në të gjitha qytetet e vendit janë hapur zyrat elektorale dhe janë zhvilluar takime elektorale nga partitë politike duke bërë prezantimet e kandidatëve për deputet në këto zona.

Madje fushata është hapur edhe zyrtarisht nga krerët e partive jashtë afateve të parashikuara ligjore.

Pavarësisht fillimit të hershëm të fushatës, që tani vërehen disa shqetësime që Koalicioni i adreson për t'i tërhequr vëmendjen subjekteve elektorale apo aktorëve të cilëve u adresohen në mënyrë që në ecurinë e mëtejshme të fushatës, tashme ligjore dhe zyrtare, të mund të zbatohet me korrektësi dispozitat ligjore dhe parimet për një fushatë të qytetëruar, të drejtë dhe të barabartë.

a) Përdorimi i burimeve të administratës shtetërore

Këto muaj fushata zgjedhore “pre-mature” ka sjellë në vëmendjen e mediave dhe publikut shqetësime mbi veprimtarinë e subjekteve politike.

Mediat dhe forcat opozitare kanë ngritur shqetësime të shpeshta dhe kanë servirur fakte shqetësuese për përdorim të burimeve të administratës shtetërore apo shkelje të tjera.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka informacione të besueshme, për raste konkrete ku administrata shtetërore imponohet për t'u bërë pjesë e fushatës elektorale pas orarit zyrtar apo për të marrë pjesë në takime elektorale të liderëve politikë në vendet e tyre të banimit apo edhe në qytete të tjera, apo për raste të tjera në shkelje të ligjit.

Takimet apo mitingjet elektorale të zhvilluara deri më tani, nga forcat e ndryshme politike, janë shoqëruar edhe me denoncime konkrete nga ana e medias por edhe e

⁷² Neni 67 pika 6: “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaroi vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi”.

⁷³ - Partia Socialiste e Shqipërisë u gjobit me 6 milionë lekë, për mos respektim të kriterit në gjashtë Zona Zgjedhore: Tiranë, Durrës, Elbasan, Kukës, Gjirokastër dhe Dibër.

- Partia Demokratike e Shqipërisë u gjobit me 4 milionë lekë për mos respektim të kriterit në katër Zona Zgjedhore: Elbasan, Dibër, Berat dhe Kukës.

- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim u gjobit me 4 milionë lekë për mos respektim të kriterit në katër Zona Zgjedhore: Berat, Kukës, Durrës dhe Gjirokastër.

⁷⁴ KQZ gjobiti me 8 milionë lekë Partinë Popullore Kristian Demokrate për mos plotësim të kriterit të gjinisë në tetë Zona Zgjedhore: Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Vlorë, Korçë dhe Dibër.

qytetarëve, për detyrimin e pjesëtarëve të administratës, për të qënë prezent në këto takime apo mitingje⁷⁵.

Por në asnjë rast **nuk ka patur përgënjeshtim apo qëndrime zyrtare në lidhje me akuzat e bëra.**

Gjithashtu, vihet re një **angazhim i drejtëpërdrejtë i ministrave⁷⁶ si dhe kryetarëve të njësive vendore⁷⁷** në fushatat e partive respektive.

KVV konstaton se pothuajse të gjithë **ministrat që zhvillojnë takime elektorale në zonat e tyre përdorin mjetet e institucioneve, madje edhe faqet zyrtare të internetit** të këtyre ministrave janë bërë dritare të fushatës elektorale partiake të ministrave⁷⁸ dhe forcës politike që ata përfaqësojnë.

b) Përdorimi i fëmijëve

Konstatohet se në takimet e tyre elektorale, forcat politike e kanë të vështirë të heqin dorë nga përdorimi i fëmijëve.

⁷⁵ Sipas televizionit Top-Channel në mitingun e datës 14 maj të PD-së në Tiranë, administrata është detyruar të jetë prezente madje disa prej personave pjesëmarrës në këtë miting kanë pohuar edhe presionin për të votuar për këtë forcë politike. Për më shumë shiko tek: <http://www.top-channel.tv/video.php?id=27145>

Media ka publikuar foto të mjeteve të ushtrisë të cilat përdoren për shtrimin e një rruge në komunën Përparim të Qarkut të Elbasanit. Ministri i Mbrojtjes i pyetur për këtë fakt nuk e ka mohuar një gjë të tillë. Në takimin e ministrit të ekonomisë z. Ridvan Bode në Pogradec mediat kanë publikuar foto të përdorimit të autoambulancës për transportimin e karigeve të takimit.

⁷⁶ Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, Ministri i Drejtësisë Eduart Halimi, etj, shfaqen pothuajse çdo ditë në kronika televizive në takime elektorale me qytetarë, si të mandatuar nga Partia Demokratike për zonat elektorale përkatëse, përkatësisht në Qarkun e Elbasanit dhe të Durrësit, ku dhe kryesojnë listat e partisë demokratike për këto qarqe. Për më shumë tek: <http://perpara.al/lajme>.

⁷⁷ Pothuajse të gjithë Kryetarët e Njësive Vendore janë të angazhuar në fushatat elektorale të partive që ata i kanë kandiduar për postin që mbajnë, madje nuk ngrurrojnë as të përdorin apo detyrojnë administratat lokale të institucioneve që ata drejtojnë.

Kryetari i Bashkisë së Vlorës z. Shpëtim Gjika në një deklaratë për mediat pozicionet si funksionar partiak dhe sulmon një kandidat të pavarur: “... Ne, si përfaqësues të mandatuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë e të zgjedhur me votë popullore në pushtetin vendor, në emër edhe të të gjitha strukturave të PS në Vlorë... . Ndaj ju bëjmë thirrje z. Malaj, të hiqeni mënjandë e të mos na futeni në mes, se rrezikoni të bëheni parzmorë e mburojë e Sali Berishës. Ne e kemi të qartë se çdo votë që mund të marrësh ti, është votë pro Sali Berishës... .”

Për më shumë tek: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/05/16/shpetim-gjika-socialistet-e-vlores-nuk-dotam-beshtesin-arben-malajn-votat-e-tij-shkojne-per-pd/>

Kryetari i Bashkisë së Tiranës Z. Lulzim Basha mori pjesë në hapjen zyrtare të fushatës së Partisë Demokratike në Tiranë më datën 13.05.2013, ku ka sulmuar kreun e opozitës dhe ka bërë thirrje për votimin e Partisë Demokratike: “... Shqiptarët janë para kësaj zgjedhje, ata do zgjedhin më shumë puënsim, jetë më të mirë, modelin që punon për të përmirësuar jetën e tyre, ju do të zgjidhni integrimin, do zgjidhni PD dhe alternativën e saj për ta cuar përpara”. Për më shumë tek: <http://time.ikub.al/0e433f23a3/aad5b0c00ee74d9e56d8e8978aae75cd/Lajm-Partia-Demokratike-hap-ne-Tirane-fushaten-elektorale.aspx>

⁷⁸ - Ministria e Arsimit, Njoftim për Shtyp i vendosur në faqen zyrtare të internetit me datë 29.04.2013: “Sot zoti Rama lëshoi nga selia e tij mavi sulme të padëgjues ndonjëherë, këtë radhë ndaj fëmijëve dhe të rinjve, duke u thënë që 57 përqind e tyre janë analfabetë. ... Zoti Rama gjithashtu i ka fyer ata duke u thënë se atyre u intereson vetëm të pijnë, të lozin kumar dhe të jenë në Facebook... . Partia Demokratike beson se ky brez është ndër më të talentuarit, inteligjentët dhe motivuarit në historinë e kombit, se ata meritojnë zgjidhje konkrete për të vazhduar përpara me shkollimin dhe jo pranojnë e durojnë ofendimet djallëzore të zotit Rama, të prodhuara nga salloni i tij mavi”. Për më shumë tek: <http://www.mash.gov.al/njoftim.php?id1=12&id=391>

- Ministri Olldashi reagon ndaj një deklaratë të Edi Ramës me një deklaratë në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit: “Reagim i ministrit Olldashi ndaj deklaratës së Edi Rames. Olldashi: Ky qenka me karavidhe se Pandi!”. Për më shumë tek: <http://www.mppt.gov.al/>.

Në një pjesë të konsiderueshme të mitingjeve apo takimeve elektorale të të gjitha forcave politike **vihet re prania e fëmijëve të cilët përdoren si dekor**, apo edhe si pjesë aktive dhe mbështetëse e stafeve organizatore duke mbajtur flamuj, parrulla, etj.

Gjithashtu edhe nga vëzhguesit e KVV-së, por edhe nga media ka patur jo pak raste **kur janë denoncuar mësues apo drejtorë shkollash të cilët kanë lënë mësimin dhe së bashku me nxënësit janë bërë pjesë e mitingjeve elektorale.**

Megjithëse një pjesë e mirë e denoncimeve të bëra nga media janë me fakte dhe të dhëna konkrete, **nuk ka patur asnjë prononcim zyrtar të institucioneve të përfshira apo të drejtorive arsimore, apo edhe të Ministrisë së Arsimit** që të japë shpjegime apo të bëjë thirrje publike për ndalimin e fenomeneve të tilla.

c) Incidente

Fushata zgjedhore megjithëse “*pre-mature*”, ka shënuar edhe incidente të ndryshme të pasqyruara nga media si dëmtim zyresh elektorale, posterash, konfliktime fizike midis simpatizantëve apo anëtarëve të forcave të ndryshme politike, etj, të cilat ndikojnë negativisht për një klimë të qetë, të domosdoshme për ecurinë normale të një fushate zgjedhore⁷⁹.

d) Premtimet elektorale

Pjesë e rëndësishme e takimeve elektorale, janë premtimet që bëhen nga krerët e subjekteve politike apo nga kandidatët në garë.

Koalicioni vëren se edhe në këtë fazë të hershme të fushatës ka një prirje të klasës politike për të bërë premtime të ekzagjeruara apo premtime të cilat bien ndesh me parime të tjera siç është zbatimi i ligjit dhe barazia përpara tij⁸⁰, etj.

G. MEDIA

Kodi Zgjedhor parashikon me një kuadër ligjor të përmirësuar për pasqyrimin e fushatës elektorale nga mediat, e cila zgjat prej datës 24 maj deri në 21 qershor 2013. Kodi Zgjedhor parashikon se për monitorimin e pasqyrimin të fushatës elektorale nga operatorët mediatikë, ngrihet Bordi i Monitorimit të Mediave (BMM) prej KQZ-së. Afati i ngritjes së Bordit të Monitorimit të Medias nga KQZ ishte data 13 prill 2013, por **ky bord u ngrit më datën 3 maj 2013**, me vendimin nr. 278 të KQZ-së. Deri në këtë moment media, pavarësisht fillimit në mënyrë joligjore të fushatës, ka transmetuar gjerësisht takimet elektorale të subjekteve zgjedhore si dhe spotet elektorale të disa prej tyre.

⁷⁹ Sipas raportimeve nga media, në datën 31 mars gjatë një mitingu të partisë Aleanca Kuq e Zi në Elbasan, drejtuesi i saj është goditur me sende të forta <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/04/01/incident-ne-tubimin-e-ak-ne-elbasan-kreshnik-spahiu-goditet-me-sende-te-forta/>

Në datën 19 dhe 24 prill media raporton për dëmtim të zyrave elektorale të Partisë Socialiste në Cërik e Librazhd, si dhe 14 në Maj dëmtohet dhe dhunohet zyra elektorale e LSI në Korçë.

⁸⁰ - Kryetari i Partisë Socialiste z. Edi Rama, në një takim në Elbasan më datën 15 maj 2013, deklaroi: “... Ne zotohemi se nuk do të njohim asnjë gjobë që është vendosur në 4 muajt e fundit përpara 23 qershorit. Madje, çdonjëri që ka marrë një gjobë që nga fillimi i muajit mars, duhet ta mbajë atë me krenari si një certifikatë në betejën me këtë regjim të korruptuar. ...”. Për më shumë tek: <http://www.panorama.com.al/2013/05/16/rama-nuk-do-njohim-asnje-gjobe-te-vendosur-ne-4-muajt-e-fundit/>

- Kryeministri z. Sali Berisha në një takim në Gjirokastrë më datën 20 maj 2013 deklaroi: “... Emigrantë të cilitdo komunitet, i ftoj të vijnë në Shqipëri e të investojnë, 3 deri në 5 vjet pa asnjë takse. ...”. Për më shumë tek: <http://www.panorama.com.al/2013/05/20/berisha-fton-emigrantet-te-investojne-ne-shqiperi-asnje-takse-per-5-vjet/>

Transmetimi i parakohshëm i **spoteve elektorale preku barazinë në kohën e transmetimit** të spoteve elektorale midis subjekteve zgjedhore, duke favorizuar në kohë mediatike subjekte të caktuara.

Transmetimi gjatë kësaj periudhe ndodhi në një boshllëk ligjor, pasi sipas Kodit Zgjedhor vetëm pas datës 24 Maj, kur fillon zyrtarisht periudha e fushatës zgjedhore, Bordi i Monitorimit të Medias por edhe vetë operatorët mediatikë në zbatim të dispozitave dhe kohës së parashikuar për çdo subjekt, kujdesen që koha mediatike të jetë e barabartë dhe në respekt të dispozitave ligjore të parashikuara.

Koalicioni ka konstatuar se gjatë kësaj periudhe në disa prej mediave audivizive është shfaqur (madje vazhdon ende) **një spot (reklamë televizive) e Ministrisë së Mbrojtjes** mbi “*anëtarësimin e Shqipërisë në NATO*”.

Ky transmetim është në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor, i cili në Nenin 84 pika 10 sanksionon se “*institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, u ndalohen reklamat, me përjashtim të atyre që i shërbejnë qëllimit të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për aspekte të procesit zgjedhor ose njoftime të tjera të parashikuara nga ligji*”.

Gjatë fushatës elektorale (të parakohshme), Koalicioni i ka kushtuar vëmendje edhe gjuhës së përdorur nga aktorët politikë si dhe pasqyrimin e saj në median audio-vizive dhe të shkruar.

a) Gjuha e përdorur

Vihet re se fjalimet e mbajtura nga liderat e partive politike si edhe nga drejtues të lartë të tyre, janë shpesh më nota fyese dhe denigruese për kundërshtarin politik.

Megjithëse takimet elektorale ndërtohen mbi qëllimin primar të prezantimit të alternativave apo programeve në dobi të interesave të qytetarit, ato në pjesën më të madhe kohës së tyre përdoren si tribuna për të sulmuar kundërshtarin politik⁸¹.

Media në tërësinë e saj e ka pasqyruar me objektivitet këtë mënyrë të diskutuarit dhe të bërit politikë nga drejtuesit e klasës politike, dhe fare pak ka mbajtur qëndrim ndaj formave apo zhargoneve fyese të përdorura.

b) Pasqyrimi nga media

Media është një mjet shumë i fuqishëm komunikimi shumëplanësh e cila nëpërmjet gjuhës apo imazhit përmbush një mission madhor: të qenurin e vërtetë, objektive dhe e paanshme.

⁸¹ - Ministria e Integritetit znj. Majlinda Bregu në konventën kombëtare për punësimin të Partisë Demokratike datë 30 Mars 2013: “... A e dini se socialistët janë ziliqarë dhe mendjepalarë?”. Për më shumë tek:

<http://www.gazetatema.net/web/2013/03/30/lajm-i-fundit-e-turpshme-konventa-e-pd-per-punesimin-kthehet-ne-arene-sharjesh-per-edi-ramen/>

- Kreu i PS-së z. Edi Rama reagon në Tëitter pas deklaratave të Berishës nga Gjirokastra më datë 20 Maj 2013: “... Sdi te fitoje pa vjedhur, sdi te qeverise pa vjedhur sdi te ike ndryshe vecse duke iu pervjedhur te vertetave te hidhura te keqeverisjes!... Bredh neper Shqiperi e genjen gjithë ditën! Ndalet ne Berat genjen. Iken ne Vlore genjen. Zbret ne Gjirokaster genjen. Dhe rrudhet perdite!” . Për më shumë tek: <http://www.panorama.com.al/2013/05/20/rama-berishes-do-genjesh-dhe-nje-muaj-e-do-ikesh-si-genjeshitari-me-i-madh-qe-shqiptaret-paten-mbi-krye/>

- Kryeministri Sali Berisha në fjalën e mbajtur para banorëve të zonës së Lezhës më datë 29 Prill deklaroi: “... Aleanca tjetër cila është? Jua them unë, si ka thënë kryetari, por si do ju vinte ta thoja unë Sali Berisha. Do thoja fundërrina bashkohuni kundra qelbësirës. ... Aleanca e tyre nuk është e vërtetë, 4 parti komuniste, 3 partie serial-killerash e hajdutësh”. Për më shumë tek: <http://www.balkanweb.com/kryesore/1/berisha-aleanca-e-majte-qelbesirat-bashke-kundra-meje-halat-e-lalzit-do-u-ngecin-ne-fyt-130298.html>

Në pasqyrimin e takimeve elektorale në media të ndryshme, vihet re se disa prej tyre **nuk i shpëtojnë dot toneve polarizuese.**

Madje, në disa prej tyre kjo tendencë e politikave editoriale prek edhe elementë parimorë si balancën në transmetimin e lajmit apo objektivitetin në pasqyrimin e tij.

c) Përdorimi i mediave sociale

Media sociale është një mjet i cili tashmë po përdoret fort nga politikanët dhe subjektet elektorale për një komunikim akoma më të shpejtë, intensiv e dinamik me publikun.

Madje nga partitë politike vërehet një rëndësi e veçantë që i jepet kësaj forme të komunikimit me simpatizantët apo anëtarët e tyre.

Koalicioni vlerëson përdorimin e këtyre formave të fuqishme të komunikimit si dhe nxit aktorët politikë por edhe qytetarët që në këtë komunikim të mbizotërojnë etika qytetare dhe fryma konstruktive, duke mos i lënë vend në asnjë rast gjuhës së urrejtjes apo nxitjes së frymës së përçarjes apo konfliktit.

H. PJESËMARRJA E GRAVE

Rritja e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit të grave ka qenë kryefjala e liderëve dhe partive politike, madje ka qenë motoja e disa konventave të organizuara prej tyre, por pas regjistrimit të kandidatëve për Kuvendin e Shqipërisë, **rezulton se në këtë drejtim kemi një hap prapa të klasës politike.**

Neni 67 pika 6 e Kodit Zgjedhor parashikon se *”Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini”*,

Ndërkohë sipas nenit 164 të Kodit Zgjedhor, nëse një grua deputete dorëhiqet, Kodi siguron që ajo të zëvendësohet me një grua, pavarësisht se kush është në rradhë në listën e kandidatëve.

Gjithashtu, në nenin 29 pika 1 gërma ç⁸², Kodi detyron dy partitë e mëdha (PD dhe PS) që në listat e tyre për anëtarë të KZAZ-ve, së paku 30% e listës, në rang vendi të jenë gra.

Pas depozitimit të listave shumëemërore për kandidatë në Kuvend, sipas Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Partia Socialiste nuk e ka zbatuar kuotën gjinore 30% dhe vendosjen e një gruaje kandidate ndër tre emrat e parë në listë në 6 qarqe nga 12, Partia Demokratike nuk e ka zbatuar në 4 qarqe nga 12 dhe Lëvizja Socialiste për Integrim në 4 qarqe nga 12.

Konkretisht, nga 140 emra të propozuar për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë nga Partia Socialiste vetëm 38 janë gra, ndërsa nga Partia Demokratike vetëm 36 janë gra⁸³. Pjesa më e madhe e partive të tjera më të vogla e kanë zbatuar kuotën gjinore, por edhe disa prej tyre kanë dështuar në këtë pikë.

Si rrjedhojë e moszbatimit të kuotës gjinore, për qarqet e caktuara KQZ vendosi gjobë ndaj këtyre partive⁸⁴.

⁸² Neni 29 pika 1 gërma ç e Kodit Zgjedhor: *“30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini”*.

⁸³ Ky informacion është marrë nga vetë partitë politike pasi listat zyrtare të kandidatëve nuk janë vënë ende në dispozicion nga KQZ.

⁸⁴ Partia Socialiste e Shqipërisë u gjobit me 6 milionë lekë, për gjashtë zona zgjedhore: Tiranë, Durrës, Elbasan, Kukës, Gjirokastrë dhe Dibër.

Partia Demokratike e Shqipërisë u gjobit me 4 milionë lekë për katër zona zgjedhore: Elbasan, Dibër, Berat dhe Kukës.

Në parlamentin e ardhshëm qarqet e Kukësit dhe Dibrës, potencialisht nuk do të kenë asnjë përfaqësuese grua, pasi asnjë prej partive kryesore nuk kishte vendosur gra në listat përkatëse shumëemërore.

Përsa i përket përfaqësimit të grave në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve u konstatua respektim i kuotës gjinore prej 30% në rang vendi, për dy partitë kryesore, sikundër parashikohet në ligj.

Në propozimet e para për anëtarë të KZAZ-ve, rezultoi se Partia Socialiste ka propozuar 80 anëtare gra nga 267 gjithsej, Partia Demokratike 89 gra nga 267 gjithsej, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 8 gra nga 89 anëtarë gjithsej dhe PBDNJ 14 gra nga 89 anëtarë gjithsej.

Megjithatë, pavarësisht respektimit fillestar të kuotës, me ndryshimet e anëtarëve të KZAZ-ve që mund të bëjë secila prej partive politike **ekziston rreziku i ndryshimit të numrave të mësipërm apo edhe ai i mosrespektimit të kuotës së përfaqësimit** prej dy partive të mëdha.

Gjithësesi, në fushatën elektorale të nisur vihet re lehtë një pjesëmarrje më e gjerë e grave si në takimet apo mitingjet elektorale të zhvilluara nga forcat politike, në konventat e partive politike, ashtu edhe në drejtimin e grupeve të punës të ngritura pranë tyre, ndryshe nga fushatat e mëparshme ku kjo pjesëmarrje ka qenë më e ulët.

K. VËZHGUESIT

Neni 6 i Kodit Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga partitë politike dhe kandidatët e paraqitur nga një grup zgjedhësish. Po ashtu përfaqësues të shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje.

Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të emërojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë numërimi në një VNV. Në rast se partitë formojnë koalicion, e drejta e emërimit të vëzhguesve i takon koalicionit dhe jo partive. Çdo koalicion ka të drejtë të propozojë jo më shumë se 3 vëzhgues.

Çdo organizatë joqeveritare shqiptare nuk mund të kenë më shumë se një vëzhgues në një qendër votimi në të njëjtën kohë, ndërkohë që çdo organizatë e huaj apo ndërkombëtare nuk mund të kenë më shumë dy vëzhgues të huaj në një qendër votimi në të njëjtën kohë.

Kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten KQZ-së jo më vonë se 15 ditë përpara zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 8 qershor 2013.

Ndërsa, kërkesat e vëzhguesve të huaj paraqiten në KQZ jo më vonë se 72 orë para datës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 19 qershor 2013.

Deri në këto momente KQZ ka akredituar disa organizata shqiptare dhe ndërkombëtare të cilat kanë akredituar vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër.⁸⁵

Lëvizja Socialiste për Integrim u gjobit me 4 milionë lekë për katër zona zgjedhore, Berat, Kukës, Durrës dhe Gjirokastrë.

Partia Popullore Kristian Demokrate u gjobit me 8 milionë lekë, pasi në listat e saj nuk ishte respektuar balanca gjinore (për prezencën e burrave). Kjo parti e ka apeluar vendimin e KQZ në Kolegjin Zgjedhor.

⁸⁵ Shoqata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut ka akredituar 520 vëzhgues afatgjatë. Qendra "Polit on" ka akredituar 47 vëzhgues afatgjatë, 52 vëzhgues afatshkurtër si dhe 18 përkthyes. Ndërkohë, për 67 emra në listën e paraqitur prej kësaj të fundit është refuzuar akreditimi për pasaktësi.

KQZ ka refuzuar kërkesën e një organizate shqiptare, pasi drejtuesi i saj rezultonte kandidat për deputet i një prej subjekteve zgjedhore të regjistruara pranë KQZ-së⁸⁶.

Gjithashtu, pas misionit të vlerësimit të bërë në Mars, edhe OSBE/ODIHR ka akredituar tashmë pranë KQZ-së vëzhguesit e vet⁸⁷.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) ka filluar që prej konstituimit të KQZ-së në tetor 2012 monitorimin e këtij institucioni.

Përveç vëzhguesve të KVV-së, pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve janë atashuar edhe vëzhgues të organizatave ndërkombëtare si OSBE/ODIHR dhe Instituti Demokratik Amerikan.

Ndërkohë, nga informacionet e marra nga vëzhguesit e KVV-së, rezulton se ende pranë Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor nuk janë alokuar vëzhgues të organizatave shqiptare apo ndërkombëtare.

L. ANKESAT DHE APELIMET

Sipat nenit 21 pika 17 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve “shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore për zhvillimin e procesit zgjedhor, në përputhje me rregullat e këtij Kodi”.

Karakteret gjyqësor është një prej tre elementëve të natyrës së KQZ-së⁸⁸.

Kodi Zgjedhor, pas gjykimit në KQZ iu jep të drejtën palëve për t’i ankimuar vendimet në Kolegjin Zgjedhor të Apelit, i përbërë nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë⁸⁹.

Ky kolegji i konstituuar për këto zgjedhje, deri tani ka marrë 10 vendime, prej të cilave 9 janë marrë në periudhën prill-maj 2013:

- “Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,

Vendimi Nr.1, datë 03.01.2013

Ky vendim është trajtuar në Raportin e Parë të Ndërmjetëm të Koalicionit⁹⁰.

- “Partia Kristian Demokrate kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,

Vendimi Nr. 2, datë 22.04.2013

Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.251 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë Kristian Demokrate, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2⁹¹.”

⁸⁶ KQZ vendosi të rrëzojë kërkesën e shoqatës ALQU për akreditimin e 120 vëzhguesve afatgjatë dhe 102 vëzhguesve afatshkurtër, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e 23 qershorit. KQZ nuk ka miratuar kërkesën e organizatës “Albanian Life Equality Union” për akreditimin e rreth 200 vëzhguesve, për arsye se presidenti i kësaj organizate rezultoi si kandidat për deputet, gjë që bie ndesh me nenin 6 pika 1, dhe nenin 7 pika 2 germa b.

⁸⁷ Në mbledhjen e datës 17 Maj, ka marrë vendim për akreditimin e 42 vëzhguesve, 12 vëzhgues core team dhe 30 vëzhgues afatgjatë, të OSBE/ODIHR.

⁸⁸ Tek veprimtaria e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve vihen re tre elementë: gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ.

⁸⁹ Neni 145 pika 1 e Kodit Zgjedhor: “Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato çenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor”.

⁹⁰ Për më shume shih tek: <http://www.zgjedhje.al/uploads/File/KVV%20-%20Raport%20I%20-%2018Mars2013.pdf>

⁹¹ Neni 64 pika 2 e Kodit Zgjedhor: “Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ:

a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;

- “Dritan Broka kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.3, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.241 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë Civile të Shqipërisë, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2.”
- “Partia e Pajtimet Kombëtar kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.4, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.226 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë së Pajtimet Kombëtar, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2.”
- “Partia e Prosperitetit Demokratik kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.5, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.251 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë së Prosperitetit Demokratik, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2.”
- “Partia Demokratike e Bashkimit Musliman të Shqipërisë kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.6, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.229 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë Demokratike të Bashkimit Musliman të Shqipërisë, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor brenda afatit kohor.”
- “Partia e Emigracionit Shqiptar kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.7, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.264 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2. Ndryshimin e tij dhe pranimin e paditësit për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Emigracioni Shqiptar për Zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013”
- “Partia e Emigracionit Shqiptar kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.8, datë 26.04.2013
Objekti: “Regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Emigracioni Shqiptar për Zgjedhjet për Kuvendin e date 23.06.2013”
- “Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.9, datë 26.04.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr.210 datë 19.04.2013, i cili vendoste mos regjistrimin e Partisë Alternativa Liberale e Shqipërisë, me arsye mos regjistrimin si subjekt zgjedhor në përputhje me kërkesën e nenit 64 pika 2.”
- “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”,
Vendimi Nr.10, datë 06.05.2013
Objekti: “Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së N.272 datë 25.04.2013, i cili vendoste lirim nga detyra të anëtarëve të KZAZ-ve, të propozuar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.”

Këto vendime të fundit të Kolegjit Zgjedhor (maj-prill), kanë të bëjnë me vendime të KQZ-së, e cila i ka rrëzuar disa partive kërkesën për regjistrim si subjekte zgjedhore në Zgjedhjet e 23 Qershor 2013.

Prej 9 ankimeve të mbërritura në Kolegjin Zgjedhor, dy u pranuan, një u pezullua për shkak të tërheqjes së paditësit dhe të tjerat u rrëzuan⁹².

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;

c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;

ç) specimenin e vulës së partisë;

d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe

dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.”

⁹² U pranuan: “Partia Emigracionit Shqiptar kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve” dhe “Partia Prosperitetit Demokratik kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve”.

IV. REKOMANDIME**- KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

- Të jetë i vëmendshëm në mbikëqyrjen e fushatës zgjedhore si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, në veçanti për të ndjekur çdo shqetësim në lidhje me përdorimin e “burimeve” të administratës shtetërore.

- Të bëj kujdes me vlerësimin si ende në fuqi të akteve të mëparshme të nxjerra prej KQZ-së në funksion të organizimit të proceseve të mëparshme zgjedhore.

- Për të gjithë subjektet zgjedhore që shkelën Kodin Zgjedhor duke e filluar fushatën zgjedhore para kohe, të marrë masa mbi bazë të vetë parashikimeve që bën ligji zgjedhor. Ky veprim përveçse është një detyrim ligjor, është një mesazh i fortë për zbatimin e ligjit në funksion të vazhdimësisë së këtyre zgjedhjeve si dhe të së ardhmës së zbatimit të ligjit në proceset e ardhshme zgjedhore.

- Të marrë vendim për ecurinë e mëtejshme të teknologjive SEN dhe SEV. KQZ duhet të përcaktojë sesa do jetë e mundshme zbatimi i tyre dhe të përgatisë infrastrukturën për atë pjesë të gjeografisë ku do të mund të zbatohen teknologjitë e reja.

- Të miratojë sa më parë manualin për trajnimin e Komisionerëve të Qendrave të Votimit dhe të zhvillojë trajnimet e këtyre komisionerëve, duke u kujdesur maksimalisht për një përfitim sa më të mirë prej pjesëmarrësve.

- Të nxisë subjektet zgjedhore të përcaktuara nga ligji, që të ngrenë sa më shpejt Komisionet e Qendrave të Votimit.

- Të miratojë sa më parë Vendet e Numërimit të Votave.

- Të jetë më transparent dhe më i kujdesshëm në publikimin e akteve që miraton dhe dhënien e informacionit për ecurinë e të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor.

- Të jetë i kujdesshëm me zëvendësimet e mundshme të komisionerëve të KZAZ-ve prej partive përkatëse politike, duke ruajtur kuotën gjinore prej 30% të kërkuar nga Kodi Zgjedhor për dy partitë e mëdha.

- Të jetë i kujdesshëm në marrjen parasysh të propozimeve që mund të vijnë prej KZAZ-ve për gjobitjen e operatoreve mediatike, veçanërisht të atyre lokalë, në lidhje me mosrespektimin e balancës në minutazhin politik të edicioneve informative. Propozimet të merren në shqyrtim me kujdesin e duhur, pa i nënvlerësuar apo mbivlerësuar ato.

- Të miratojë sa më parë dy udhëzimet e kërkuara nga Kodi Zgjedhor në lidhje me fushatën zgjedhore:

a) udhëzimin mbi mënyrën e përdorimit të materialeve të përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore;

b) udhëzimin në lidhje me kohën televizive që i vihet falas në dispozicion subjekteve politike dhe përllogaritjen që i bëhet asaj si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore.

KQZ duhet të nxisë në këtë pikë edhe KKRT-në dhe Ministrinë e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse sikundër e kërkon Kodi Zgjedhor.

- KOMISIONEVE ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

- Të jenë të përgjegjshëm në kryerjen e detyrës dhe t'i përgjigjen vetëm Kodit Zgjedhor në punën e tyre, pa marrë në konsideratë përkatësinë politike.

- Anëtarët e KZAZ-vë të jenë sa më të informuar mbi procesin e adresimit të pasaktësive në listat e zgjedhësve, në mënyrë që të informojnë qytetarët në mënyrën e duhur.

- PARTIVE POLITIKE

- Të zgjidhin sa më parë ngërçin e krijuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, në mënyrë që ai të funksionojë i plotë.

- Të angazhohen për të pranuar dhe nënshkruar "*Kodin e Etikës dhe të Sjelljes së mirë për Partitë Politike gjatë Fushatës Zgjedhore*".

Në çdo rast Partitë Politike duhet të angazhohen publikisht për të respektuar dhe zbatuar parimet e afirmuara në këtë kod.

- Gjatë fushatës së tyre zgjedhore, të mbështeten në ide dhe në argumente që janë konkrete dhe rrisin cilësinë e jetesës së votuesve, duke qëndruar larg një fushate negativiste dhe përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

- Të kontrollojnë atmosferën e fushatës brenda normave të qytetëruara, si dhe të ushtrojnë autoritetin e tyre për të mos lejuar aktivistët apo ndjekësit e tyre në kryerjen e akteve jo-ligjore apo akteve që prishin atmosferën e një garimi të ndershëm e të barabartë.

- Të ndalohet kategorikisht përdorimi i burimeve të administratës shtetërore, qoftë kjo në nivel qendror apo lokal.

- Të ndalohet kategorikisht përdorimi i fëmijëve nën 18 vjeç si dekor në mitingjet e konventa apo si pjesë e stafeve mbështetëse apo organizatore në aktivitetet elektorale.

- Partitë politike duhet të përdorin një gjuhë sa më korrekte në komunikimet e tyre publike.

- Të ruajnë dhe të zhvillojnë një marrëdhënie me median në përputhje me ligjin, duke e lejuar atë në kryerjen e detyrës në mbulimin e fushatave zgjedhore.

- KVV inkurajon të gjitha partitë politike, të nxisin pjesëmarrjen e mëtejshme të grave në të gjithë elementët organizative të partive të tyre, përgjatë fushatës elektorale apo në takimet me qytetarë që ata zhvillojnë.

- KVV nxit partitë politike të sigurojnë një përfaqësim sa më të lartë në numër të grave në Komisionet e Qëndrave të Votimit, që pritet të formohen, duke influencuar përveç të tjerash për një klimë të qetë e sa më funksionale brenda këtyre komisioneve.

- KVV inkurajon anëtarët gra të partive politike që të marrin pjesë në mënyrë sa më aktive në fushatën zgjedhore apo në aspekte të tjera të procesit zgjedhor, duke dhënë kontributin e tyre për një fushatë sa më të qetë dhe konstruktive.

- Të përpiqen që të minimizojnë apo të shmangin zëvendësimet e komisionerëve të tyre pranë KZAZ-ve dhe KQV-ve që priten të ngrihen, sikundër ka ndodhur në proceset e mëparshme zgjedhore.

- KVV fton të gjithë subjektet elektorale që në përgatitjen e materialeve elektorale e propagandistike apo edhe institucionet shtetërore, të ndjekin qëllime miqësore ndaj mjedisit, duke përdorur psh. letër të ricikluar për prodhimin e posterave, etj.

- MEDIAS

- Të jetë e vëmendshme në mbulimin e fushatës zgjedhore duke patur parasysh gjatë punës së saj kriteret që vendos Kodi Zgjedhor, duke u udhëhequr përherë nga parimi i vërtetësisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

- Pavarësisht se Ligji zgjedhor lejon marrjen parasysh të materialeve zgjedhore të përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore, mediat janë të lira të marrin pjesë vetë dhe të përgatisin e pasqyrojnë me objektivitet fushatën zgjedhore të subjekteve politike. KVV i nxit mediat të mos tradhtojnë besimin e publikut por t'ua paraqesin atyre me vërtetësi e objektivitet fushatën zgjedhore mbi bazën e materialeve të përgatituara nga stafet e veta të gazetarëve.

Mediat duhet ti qëndrojnë besnik politikës së tyre editoriale në misionin madhor të informimit të publikut dhe mos të lejojë ndërhyrjen në këtë mision të fabrikimeve që vijnë nga stafet elektorale të partive politike.

Publiku ju ndjek ju për linjën editoriale dhe objektivitetin që ju manifestoni.

- Të evidentojë dhe publikojë të gjitha rastet e shkeljeve ligjore përgjatë fushatës elektorale duke informuar publikun dhe servirur sa më shumë fakte dhe prova.

- Operatorët zgjedhorë si Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, subjektet zgjedhore, Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme, Njësitë Vendore, etj., por edhe të gjithë aktorët e tjerë institucionalë duhet të përpiqen të jenë sa më transparentë në veprimtarinë e tyre si dhe të reagojnë publikisht nëpërmjet qëndrimeve zyrtare mbi problematikat, akuzat apo çështjet që ngrihen në media dhe nga opinionin publik në lidhje me aspekte jo-ligjore të fushatës zgjedhore.

V. AKSIONI I KOALICIONIT TË VËZHguesVE VENDORË

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV), është një aleancë organizatash jo-qeveritare dhe jo-politike thelbi i aktivitetit të cilave është zhvillimi i demokracisë në Shqipëri, veçanërisht vëzhgimi i proceseve elektorale.

Filozofia dhe strategjia e KVV bazohet në tri shtylla: pavarësi, paanësi dhe objektivitet në respekt total të mosdiskriminimit.

Pas vëzhgimit të Zgjedhjeve 2011 dhe ndjekjes në mënyrë aktive të procesit të reformës zgjedhore (Nëntor 2011 – Korrik 2012), KVV nisi angazhimin e vet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare duke filluar monitorimin e periudhës parazgjedhore që prej hyrjes në fuqi të amendimeve që iu bën Kodit Zgjedhor.

KVV do të vëzhgojë të gjitha nivelet e administrimit dhe të gjitha fazat e përgatitjes, realizimit deri në publikimin e rezultateve finale të zgjedhjeve të 23 qershorit.

Ky Raport është Raporti i Dytë që KVV publikon, duke përmbledhur monitorimin e situatës parazgjedhore prej **datës 15 Mars deri më datën 23 Maj 2013, një ditë para fillimit zyrtar të fushatës elektorale.**

VI. FJALORTH

GNV	Grup i Numërimit të Votave
KQV	Komisioni i Qëndrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LSI	Levizja Socialiste për Integrim
PBDNJ	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste
QV	Qënder Votimi
SEN	Sistemi Elektronik i Numërimit
SEV	Sistemi Elektronik i Verifikimit
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor

SHTOJCA

**QËNDRIMET PUBLIKE TË KOALICIONIT
PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA TË SHPREHURA NËPËRMJET
DEKLARATAVE DHE LETRAVE TË HAPURA**

ANEKS I

LETËR E HAPUR

Drejtuar: Kryetarit të Partisë Demokratike
z. Sali BERISHA
Kryetarit të Partisë Socialiste
z. Edi RAMA

Për dijeni:

Partive Politike
Misionit të OSBE / ODHIR
Delegacionit të Bashkimit European
Zyrës së Këshillit të Europës
Ambasadës së Shteteve të Bashkuara
Opinionit Publik

Të nderuar zotërinj!

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë po ndjek më shumë shqetësim situatën e krijuar në organin më të lartë administrativ të procesit zgjedhor të 23 qershorit si dhe prononcimet tuaja publike në lidhje me vazhdimësinë e punës dhe funksionimit të KQZ-së, apo procesit në tërësi.

Të shqetësuar në lidhje ecurinë e mëtejshme të procesit, premisave për përmbushjen e standarteve dhe të besimit të shtetasve në të, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë sjell në vëmendjen tuaj:

1. Përcaktimin ligjor mbi Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor

Kodi Zgjedhor përcakton organizimin e procesit zgjedhor nëpërmjet tre niveleve: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (në këto zgjedhje janë 89 KZAZ) si dhe nëpërmjet Qendrave të Votimit (rreth 5500 QV).

KQZ-ja është “organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor”⁹³.

Përbërja e KQZ-së është prej 7 anëtarësh, ku 6 anëtarë kanë mandat 6 vjeçar dhe Kryetari ka mandat 4 vjeçar;

- Dy anëtarë i përzgjedh partia më e madhe e mazhorancës*
- Dy anëtarë i përzgjedh partia më e madhe e opozitës*
- Një anëtar e përzgjedh partia e dytë më e madhe e mazhorancës*
- Një anëtar e përzgjedh partia e dytë më e madhe e opozitës*
- Kryetari, anëtari i shtatë, nuk vjen me përzgjedhje politike si 6 anëtarët e tjerë, por përzgjidhet prej Kuvendit ndërmjet kandidatëve të ardhur pas një thirrjeje publike të vakancës⁹⁴.*

⁹³Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 2 pika 7 “Përkufizime”.

⁹⁴Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 15 “Zgjedhja e Kryetarit të KQZ-së”.

Ky lloj konfigurimi i KQZ-së është bërë në vazhden e tërë përpjekjes 20 vjeçare deri në reformën e fundit zgjedhore, për të ngritur një institucion të pavarur dhe jo politik për organizimin e zgjedhjeve⁹⁵.

Ndonëse të përzgjedhur politikisht, gjashtë anëtarët, ashtu si edhe Kryetari, marrin përsipër një sjellje dhe votim jashtë interesave të subjekteve politike që i kanë përzgjedhur⁹⁶.

Pra shihet qartë se KQZ megjithëse krijohet mbi një miratim parlamentar (politik), qëndron dhe sillet si një trupë jo politike, e pavarur, një *quasi (gati) qeveri*⁹⁷, përgjegjëse për organizimin e procesit zgjedhor⁹⁸.

Në piramidën e organizimit të zgjedhjeve, poshtë KQZ-së qëndrojnë komisionet e nivelit të dytë (KZAZ-të) dhe komisionet e nivelit të tretë (KQV-të).

Të dy këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë. Gjashtë prej anëtarëve emërohen me të njëjtën formulë si me 6 anëtarët e KQZ-së. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve, që është Kryetari, përzgjidhet me short të organizuar prej KQZ-së, ku në gjysmën e komisioneve (në KZAZ-të me numër çift) i takon partisë më të madhe të mazhorancës dhe në gjysmën tjetër (në KZAZ-të me numër tek) partisë më të madhe të opozitës.

Edhe komisionet e Qendrave të Votimit ndërtohen nga KZAZ-të përkatëse sipas të njëjtit kriter të parashikuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor.

Në përmbledhje të tërë skemës organizative, rezulton se kemi një KQZ të pavarur, ndërkohë që KZAZ-të bashkë me KQV-të janë të ndërtuara në frymën e baraspeshimit politik, ashtu siç e kërkon shprehimisht gërma “a” e pikës 1 të nenit 29 të Kodit Zgjedhor⁹⁹.

Madje, në funksion të konsolidimit të pavarësisë dhe heqjes së mundësive për të ndikuar apo lëvizur anëtarët e KQZ-së, legjislatori në nenin 18/2 të Kodit Zgjedhor parashikon shprehimisht rastet e ndërprerjes së mandatit të një anëtari

⁹⁵“Anëtarët e KQZ-së nuk duhet të jenë politikë, ata janë administruesit e ligjit. Dhe nëse ata fillojnë ta perceptojnë veten si politikanë dhe të fillojnë të mbajnë fjalime në KQZ, atëherë rezultati behët shumë i qartë për mua që këtu se me çfarë KQZ-je kemi të bëjmë”.

Pjesë e fjalimit të Konsulentit të Komisionit të Venecias, Nikolai Vulchanov, të mbajtur në takimin “Trashëgimia zgjedhore europiane. Kodi i praktikave të sjelljes së mirë, lidhur me çështjet elektorale”, datë 02.06.2012. <http://www.panorama.com.al/2012/07/03/%E2%80%9CAnetaret-e-kqz-te-jene-gjyqtare%E2%80%9D/>

⁹⁶Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 13: “Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së”: “Përpara fillimit të detyrës, anëtari i zgjedhur i KQZ-së kryen betimin para Kuvendit, në një ceremoni publike. Teksti i betimit është: “Betohem në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj”.

⁹⁷“Procesi zgjedhor nuk është ekskluzivitet dhe përgjegjësi vetëm e institucioneve zgjedhore, por edhe rezultat i kontributit të përbashkët pozitiv dhe ligjor të të gjithë aktorëve dhe partive politike”

Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2011”, miratuar më 19 Korrik 2012 me 70 vota pro të mazhorancës dhe 58 kundër të opozitës. Për më shumë tek: http://www.parlament.al/web/19_Korrik_2012_Rezolute_Per_vleresimin_e_veprimtarise_se_KQZ_se_per_vitin_2011_14584_1.php

⁹⁸Operatorë të tjerë zgjedhorë, që janë në funksion të KQZ-së në organizimin e zgjedhjeve, janë Ministria e Brendshme, Njësitë Vendore, Prefektët, etj. Këto organe, pjesë e Qeverisjes Qendrore dhe Qeverisjes Vendore, janë pjesë e mekanizmit zgjedhor, por KQZ-ja mbetet qendra operative në organizim.

⁹⁹“... Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë.”

të KQZ-së si dhe mënyrat se si kjo procedurë duhet të nisë në KQZ, duke marrë jo më pak se 5 nga votat e anëtarëve (neni 24) dhe më pas është sërish vetë KQZ e cila investon Kuvendin për zëvendësimin sipas vakancës së krijuar dhe njoftimit të bërë po nga vetë KQZ-ja.

2. Situatën pas publikimit të aleancës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim me Partinë Socialiste

Më datë 03.04.2013 u bë e ditur për publikun, që partia e dytë më e madhe e mazhorancës, Lëvizja Socialiste për Integrim, do lidhte koalicionin me Partinë Socialiste, duke kaluar kështu në opozitë.

Ky kalim politik, sillte si rrjedhojë që KQZ-ja në përbërjen e saj të kishte 4 anëtarë të propozuar prej forcave opozitare dhe dy prej forcave mazhoritare. Ndërsa në KZAZ dhe KQV, partitë mazhoritare do përfaqësoheshin vetëm prej Partisë Demokratike dhe në tëra komisionet në rang vendi do ishte në pakicë.

- Në 50% të KZAZ-ve do qëndronte në pakicë 2 nga 5 (anëtarë)
- Në 50% të KZAZ-ve do qëndronte në pakicë 3 nga 4 (anëtarë)
- Në 50% të KQV-ve do qëndronte në pakicë 2 nga 5 (anëtarë)
- Në 50% të KQV-ve do qëndronte në pakicë 3 nga 4 (anëtarë)

Kodi Zgjedhor nuk e parashikon në asnjë dispozitë rastin kur kemi lëvizjen e subjekteve politike, që përzgjedhin anëtarë në KQZ, prej mazhorancës në opozitë ose anasjelltas.

Formalisht, legjislacioni në këtë rast nuk kërkon riformulime në të tre nivelet e komisioneve zgjedhore duke e lejuar procesin të ndjekë rrjedhën e tij.

3. Shkarkimin e z. Ilirjan Muho si anëtar i KQZ dhe zëvendësimin e tij

Forcat politike të së djathtës (mazhorancës), duke afirmuar se lëvizja politike e ndodhur kishte prishur tashmë balancën e strukturës zgjedhore duke e bërë atë të njëanshme, ndërmori disa hapa ligjorë.

Më datë 09.04.2013, Partia Republikane dorëzoi në KQZ shkresën, ku kërkonte të përzgjidhte anëtarin e saj në KQZ si subjekti i dytë tanimë i rradhitur në mazhorancë.

Ky veprim u ndoq më pas nga Partia Demokratike e cila më datë 10.04.2013 dorëzoi në Kuvendin e Shqipërisë një kërkesë për lirim nga detyra të komisionerit Ilirjan Muho, emëruar si anëtar i KQZ-së prej LSI-së.

Argumenti i përdorur prej PD-së në këtë kërkesë ishte parimi i baraspeshimit politik dhe i frymës së Kodit¹⁰⁰, i mbështetur në nenin 14 të Kodit Zgjedhor¹⁰¹.

100 “Kodi Zgjedhor përcakton parimet dhe rregullat për ndërtimin e administratës zgjedhore të të gjitha niveleve, nga KQZ-ja deri te niveli më i ulët i saj. Në të gjitha përcaktimet ligjore, Kodi bazohet në një parim themelor, atë të baraspeshimit politik maxhorancë parlamentare- opozitë parlamentare. Baraspeshimi është themeli i kompozimit të KQZ-së, i secilës KZAZ-je, KQV-je apo grupi numërimi. Baraspeshimi është parimi themelor, që rregullon ndarjen e barabartë të kontrollit të maxhorancës vendimmarrëse të komisioneve zgjedhore, ku gjysma e komisioneve të secilit kontrollohet nga maxhoranca qeverisëse dhe gjysma kontrollohet nga opozita parlamentare.” Fjala e mbajtur nga z. Gent Strazimiri, parashtruesi i Kërkesës së Partisë Demokratike Demokratike “Për lirim nga detyra të një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” në “Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, Proçes-verbali i mbledhjes së datës 10.04.2013 të këtij Komisioni.

101 Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 14, Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së

Sipas PD-së, Komisioneri Muho ishte emëruar prej LSI-së si subjekti i dytë më i madh i mazhorancës. Në momentin që ai subjekt politik kalon në opozitë, vota e komisionerit Muho sjell prishjen e balancës së vendim-marrjes në KQZ¹⁰² dhe kjo përbën arsye për lirim të tij nga detyra dhe emërimin e një kandidati të përzgjedhur nga Partia Republikane, si forca e dytë më e madhe e mazhorancës¹⁰³.

Projekt-vendimi i Partisë Demokratike “Për lirim nga detyra të një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, datë 10.04.2013, u amendua dy herë para se të votohej në Kuvend.

Në amendimin e parë¹⁰⁴ ndryshohet baza ligjore dhe argumentimi i lirim. Në preambulën e projekt-vendimit “Neni 14” (Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së) ndryshohet me “gërma “ë” e Neni 12” (Përbërja e KQZ-së)¹⁰⁵.

Në arsyet për lirim të komisionerit Muho shtohet se “është emëruar në shkelje të neni 12, gërma “ë” të Kodit Zgjedhor, si person i shkarkuar nga funksioni publik i prokurorit me dekret të Presidenit të Republikës nr. 3727 datë 13.03.2003, duke i fshehur Kuvendit, gjatë procedurës së emërimit, deklarin e fakteve që pengonin emërimin në detyrën e anëtarit të KQZ”¹⁰⁶.

Pra në argumentimin për lirim të Komisionerit, veçmas parimit të baraspeshës politike sillet dhe fakti që kandidatura e Ilirijan Muhos nuk ka qenë në përputhje me Kodin Zgjedhor. Në gërmën “ë” pika 2 të neni 12 kërkohet që kandidatura për t’u emëruar anëtar në KQZ duhet “të mos jetë larguar nga administrata publike apo çdo funksion publik për shkelje të detyrës”.

Në amendimin e fundit baza ligjore do mbesë vetëm “gërma “ë” e pikës 2 të Neni 12” dhe argumenti për lirim të Ilirijan Muhos do jetë vetëm “si person i shkarkuar nga funksioni publik i prokurorit me dekret të Presidenit të Republikës nr. 3727 datë 13.03.2003, duke i fshehur Kuvendit, gjatë procedurës së emërimit, deklarin e fakteve që pengonin emërimin në detyrën e anëtarit të KQZ”.

Projekt-vendimi i Partisë Demokratike “Për lirim nga detyra të një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, u votua në Kuvendin e Shqipërisë me 15.04.2013 dhe u miratua me 73 vota.

¹⁰² “Ndryshimi i baraspeshimit politik, sipas Partisë Demokratike shuan shpresat për një proces të ndershëm të shqyrtimit të ankesave zgjedhore nga administrata zgjedhore. Prishja e baraspeshës, në formën si është realizuar, me zhvillimet e fundit politike, është paralajmërim i manipulimit dhe provë e platformës përsëri për manipulim.” Relacioni i Kërkesës së Partisë Demokratike “Për lirim nga detyra të një anëtari të KQZ-së”, datë 10.04.2013.

¹⁰³ “... Bazuar nga sa më sipër, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i kërkojmë Kuvendit të lirojë nga detyra anëtarin e KQZ-së, zotin Ilirijan Muho, të emëruar si anëtar i KQZ-së në anën e mazhorancës qeverisëse, me propozim të LSI-së, si dhe ta nisë pa vonesë procedurën për zëvendësimin e vakancës së krijuar, në përputhje me parimin e baraspeshimit politik dhe rregullat e tjera të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.” Fjala e mbajtur nga z. Gent Strazimiri, parashtuesi i Kërkesës së Partisë Demokratike në “Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, Procesverbali i mbledhjes së datës 10.04.2013.

¹⁰⁴ Shkresa me Nr. 768, datë 15.04.2013.

¹⁰⁵ Gërma ë: “Anëtar i KQZ -së mund të emërohet çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili përmbush këto kritere:

c) të mos jetë larguar nga administrata publike apo çdo funksion publik për shkelje të detyrës.”

¹⁰⁶ Në vitin 2003, Ilirija Muho është shkarkuar si Prokuror i Rrethit të Fierit me dekretin nr. 3727, datë 13.03.2003, të Presidentit të Republikës z. Alfred Moisiu mbi bazën e Neni 32/b dhe Neni 33/1/ç të “Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë”, Nr.8737, datë 12.02.2001.

Neni 32/b: “Quhen shkelje të disiplinës në punë: b) zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve ose të detyrave të tjera të ngarkuara ose mospërmbushja e detyrave”; Neni 33/1/ç - 1. “Për shkelje të disiplinës ndaj prokurorëve merren këto masa: ç) shkarkim nga detyra”.

Gjithashtu Kuvendi i Shqipërisë emëroi kandidaturën e Partisë Republikane, për anëtar të KQZ-së, z. Klement Zguro.

Ndërrimi i anëtarit të KQZ-së nga ana e Kuvendit, u pasua nga dorëheqja në shenjë proteste dhe e njëpasnjëshme e tre anëtarëve të KQZ-së të përzgjedhur nga opozita¹⁰⁷.

Tre vakancat (vende të lira) për të cilat subjektet politike opozitare duhet të sillnin në Kuvend propozimet e tyre brenda 48 orëve nga dorëheqja e komisionerëve¹⁰⁸ janë ende të paplotësuara.

Subjektet politike përgjegjëse për zëvendësimin e anëtarëve të dorëhequr, refuzojnë të sjellin kandidatura në parlament me pretendimin për të patur një rindërtim të KQZ-së, sepse ajo aktualja është me efekt nul pra e pavlefshme ligjërisht¹⁰⁹.

Në gjithë ecurinë e procesit të emërimit dhe lirimit të anëtarit të përzgjedhur nga Lëvizja Socialiste për Integrim vërehen një sërë boshllëqesh që mbart ligji, për të cilat nuk mund të ishte Kuvendi arbitri, por gjykata.

Kuvendi, ndonëse gëzon një supremaci si institucion, nuk mund ta lironte komisionerin Muho me efekt a posteriori (prapaveprues) të ligjit kur rregullat janë vënë më parë, qofshin ato të dobëta.

Konkretisht, Kodi Zgjedhor parashikon se dy nga kriteret që duhet të përmbushë një kandidaturë për tu bërë anëtar i KQZ-së janë: a) mosqenia anëtar partie në 5 vitet e fundit dhe b) mos të jetë i larguar nga detyra në administratën publike për shkelje detyre¹¹⁰.

Së pari, z. Ilirjan Muho deri në Shkurt të vitit 2011 ka qenë Zv. Ministër i Punëve Publike dhe Transportit. I ngarkuar pra në një detyrë politike, ndonëse sipas vetë Ilirjan Muhos, ai nuk ka qenë pjesë e një force politike¹¹¹.

Me të drejtë ngrihet pyetja mbi qëllimin e dispozitës.

Kërkohet një kandidat që nuk mban librezë anëtarësie apo që nuk është përkrahës aktiv i një force politike?

Së dyti, në mars të vitit 2003 Z. Muho është shkarkuar me dekret të Presidentit Alfred Moisiu nga detyra e Prokurorit në Rrethin e Fierit¹¹².

Në dosjen e dorëzuar prej tij në Kuvend ky fakt nuk gjendet i përmendur dhe Kodi nuk shprehet për një rast të tillë se çfarë masash duhet të ndiqen.

¹⁰⁷Deklaratë për ndërprerjen e vullnetshme të funksionit: “Në rrethana si këto, kur mbrojtja ligjore e institucionale që supozohej se e kishim të garantuar si anëtarë të institucionit të ngarkuar nga ligji për tu dhënë shqiptarëve zgjedhje të lira e të ndershme është përdhosur haptazi, vlerësoj se duhet të jap dorëheqjen nga detyra e Zëvendëskryetarit dhe njëherësh anëtarit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.” Shkresa e komisionerit Denar Biba dërguar Kryetares dhe anëtarëve të KQZ-së datë 16.04.2013.

¹⁰⁸Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 19.3 “Në rast se mandati i një anëtarit të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga Kuvendi sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.”

¹⁰⁹Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 19.2 “Të drejtën për propozimin e kandidaturave e ka i njëjti subjekt politik që kishte propozuar anëtarin që i kishte mbaruar mandati, nëse subjekti i plotëson kriteret e përcaktuara në pikën I të nenit 14 të këtij Kodi.”

¹¹⁰Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 12/d, Neni 12/ë: “Përbërja e KQZ-së”.

¹¹¹Risjellim në kujtesë në këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor rastin e Haki Mustafës, një prej katër kandidaturave finaliste për Kryetar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Një kandidat që mbante funksionin e Kryetarit të Njësisë Nr.11 në Tiranë, pra një i votuar dhe i deklaruar politik në zgjedhjet Lokale të 2011, por që kaloi në Kuvend për votim.

¹¹²Dekreti Nr. 3727, 13.03.2003 “Për Shkarkim Prokurori”

Pavarësisht se dy faktet e sipërpërmendura u bënë publike prej shtypit të kohës¹¹³, në mbledhjen e Komisionit Parlamentar kandidatura e tij kaloi pa asnjë diskutim dhe Z. Ilirian Muho u miratua si kandidaturë që plotësonte kushtet e vëna nga ligji ndaj kandidatura e tij u kalua për në seancë plenare, ku Kuvendi e emëroi si anëtar të KQZ-së.

Kodi Zgjedhor nuk shprehet se çfarë ndodh në rastin e mësipërm. Madje në Kod lista e arsyeve për të patur shkarkim ose lirim nga detyra të komisionerëve është shtruese.

Po ashtu procesi i zëvendësimit të z. Muho me z. Zguro nga Kuvendi është në kapërcim të plotë të ligjit, edhe nëse pjesa e krijimit të vakancës do të konsiderohej si në përputhje me të.

Akti i miratuar më 15.04.2013 nga Kuvendi “Për lirim nga detyra të një anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” kishte në argumentin e vet lirimin e komisionerit Ilirjan Muho si në mospërputhje me kërkesat e Kodit, si i larguar nga administrata publike për shkelje të detyrës, duke e hequr argumentimin fillestar, atë të një baraspeshimi politik.

Bazuar mbi këtë vendim, në bazë të pikës 2 të Nenit 19 të Kodit Zgjedhor “të drejtën për propozimin e kandidaturave e ka i njëjti subjekt politik që kishte propozuar anëtarin që i kishte mbaruar mandati”, çka duhet të ngarkonte sërish LSI-në dhe jo Partinë Republikane për të propozuar kandidaturën zëvendësuese.

4. Rikonfigurimin e KZAZ-ve

Me katër anëtarë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrtoi në vazhdim rikonfigurimin e komisioneve të nivelit të dytë (Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor).

Me Vendimin Nr. 265, të datës 23.04.2013, KQZ pranoi pjesërisht kërkesën e Partisë Republikane “Për përcaktimin e Partisë Republikane si parti që ka të drejtë të paraqesë propozime për anëtarë të KZAZ-ve, KQV-ve në rang vendi dhe të marrë pjesë në shortin për propozimin e anëtarit të GNV-së”.

Me këtë vendim KQZ-ja amendoi gjermën “c”, të pikës 1 të vendimit të KQZ-së Nr.1, datë 07.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”¹¹⁴.

Amendimi përcaktoi Partinë Republikane si partia e dytë më e madhe e mazhorancës, duke i dhënë të drejtën për të patur anëtarin e saj në KZAZ.

¹¹³<http://gazetadita.al/procesverbali-deputetet-e-pd-se-nuk-i-bene-asnje-pyetje-ilirjan-muhos/>
<http://www.gazetatema.net/web/2012/10/02/beteja-per-kqz-lsi-nje-kandidat-te-shkarkuar-si-prokuror/>

¹¹⁴“Nisur nga fakti se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim deklaroi largimin e saj nga grupi i partive që i përkasin shumicës parlamentare, rezulton se vendimi i KQZ-së nr. 1, datë 7.01.2013 pjesërisht nuk i përgjigjet më rrethanave apo kushteve konkrete, duke u bërë njëkohësisht edhe pengesë për rregullimin e mëtejshëm të marrëdhënieve juridike, pasi me kushtet e reja të krijuara, prish pikërisht baraspeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-ve. Në këto kushte KQZ si organi administrativ i cili ka nxjerr vendimin nr. 1, datë 7.01.2013 “ Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013” në bazë të nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative ka të drejtë të bëjë ndryshimin e tij, në mënyrë që të respektojë dispozitat e Kodit Zgjedhor për sa i përket përbërjes së KZAZ-ve.” Vendimi Nr. 265 i KQZ-së , datë 23.04.2013

Me një tjetër vendim, KQZ-ja pranoi kërkesën e Lëvizjes Socialiste për Integrim për të patur anëtarin e saj në KZAZ¹¹⁵, tanimë si forca e dytë më e madhe e opozitës. Me këtë vendim KQZ-ja amendoi gjurmën “d”, të pikës 1 të vendimit të KQZ-së Nr.1, datë 07.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”.

Ndërkohë në lidhje me anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, KQZ-ja u shpreh me Vendimin Nr. 272, datë 25.04.2013.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi se PBDNJ sipas Vendimit Nr.1, datë 07.01.2013, të amenduar me Vendimin Nr. 266 dhe Nr. 270, nuk ka më të drejtë të përfaqësohet me anëtarë në KZAZ, sepse nuk është më forca e dytë më e madhe e opozitës. Me këtë arsye KQZ vendosi për lirim të komisionerëve të KZAZ-ve të emëruar nga PBDNJ.

Pavarësisht legjitimitetit në frymën e Kodit, formalisht Kodi Zgjedhor i liston në mënyrë shteruese të gjitha rastet për shkarkimin apo lirim të komisionerëve të KZAZ-ve, dhe nuk parashikon argumentimin e përdorur më sipër nga KQZ¹¹⁶.

5. Mangësitë e evidentuara në Kodin Zgjedhor

Formulimi aktual i komisioneve të administrimit zgjedhor ka për bazë përzgjedhjen politike apo propozimin nga partitë politike, i cili është i ngjashëm me përvojën zgjedhore të viteve 1991-1997¹¹⁷.

Një periudhë, që duhej të ishte marrë parasysh përgjatë Reformës Elektorale në hartimin aktual të Kodit Zgjedhor, për hir të traditës ligjore dhe përvojës në organizimin e zgjedhjeve që ofron.

Ngërçi aktual nuk do të ekzistonte nëse do të ishte marrë parasysh praktika e dekretit presidencial të vitit 1996 për ndërtimin e KQZ-së.

Në këtë dekret presidencial parashikohet qartë e në mënyrë të hollësishme se nëse partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në KQZ rishpërndahen brenda grupimit përkatës¹¹⁸.

Komisioni i Reformës Elektorale nisur nga kjo praktikë duhej ta kish parashikuar këtë rast.

Madje, vetë legjislatori nëse do ishte treguar më i matur dhe më i vëmendshëm në përvojën e patur deri më sot, i kishte të gjitha mundësitë për të

¹¹⁵“Për caktimin e anëtarit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në përbërje të KZAZ-ve” Vendimi Nr. 270 i KQZ-së, datë 24.04.2013.

¹¹⁶Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 32 “Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së”.

¹¹⁷Në ecurinë kohore të ndërtimit të KQZ-së evidentohen dy trajektore kryesore.

Ecuria e parë, është ajo e një KQZ-je që reflekton në anëtarësinë e saj terrenin politik. Pra, konfigurimi politik i Kuvendit sjell reflektimin në atë moment të partive politike në KQZ. Ndërsa ecuria tjetër është ndërtimi i një institucioni me përzgjedhje ndërinstytucionale. Institucione si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Presidenti dhe Kuvendi përzgjidhnin anëtarësinë e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

¹¹⁸Dekreti Nr. 1579, datë 13.08.1996 “Për ndërtimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë”, Neni 4 ... Në rast se partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës, largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve rishpërndahen brenda grupimit përkatës në përputhje me kriterin e vendosur në paragrafin 2 të nenit 3.

mos e lejuar pikëpyetjen ligjore që krijoj ngërçe siç është rasti se “*çfarë ndodh me KQZ-në kur kemi lëvizje politike*”. Apo çfarë ndodh me vakancat në KQZ kur ato nuk plotësohen nga subjektet që parashikon ligji, rast i cili është i parashikuar disi në krijimin e vakancave në KZAZ.

Pamaturia e legjislatorit vihet re edhe tek terminologjia e përdorur në dispozitën e cila përcakton se si përzgjidhen anëtarët e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve¹¹⁹.

Kodi përdor togfjalëshat “parti të shumicës parlamentare” dhe “parti të opozitës parlamentare”, të cilat janë të paverifikueshëm formalisht, dhe ligjërish të është e pamundur të sillen si një fakt. Edhe në traditën tonë ligjore janë të pakta referencat që mund të përdoren si argumente për të ngritur vijë ndarëse midis asaj se çfarë është njëra dhe çfarë është tjetra¹²⁰.

Duhet sjellë në kujtesë se ngërçi ligjor mbi lëvizjen e komisionerëve, në një vit përvojë të Kodit Zgjedhor dhe Komisionit Zgjedhor, nuk është i pari. Në pak muaj janë shtruar në diskutime të ashpra ligjore dhe politike, edhe dy çështje madhore për zhvillimin e zgjedhjeve. Ajo që i përket përcaktimit të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe të ndarjes së mandateve. Dy vendim-marrje të kritikueshme që kanë qenë një reflektim i handikapeve ligjore në Kod¹²¹.

6. KQZ-në si një institucion jo politik

Qëndron një pikëpyetje sot nëse KQZ-ja është një institucion politik ose jo, sidomos pas prononcimeve publike të aktorëve politikë pas ngërçit të KQZ-së. Kodi vetë nuk mbart një pohim të qartë ku e afirmon plotësisht natyrën e KQZ-së, duke lënë shteg për interpretime të shumta.

Në qëndrimin e KVV-së, por edhe të aktorëve të tjerë që kanë ndjekur nga afër proceset dhe reformat zgjedhore, jo vetëm sot, por gjithmonë ka patur një përpjekje për të patur një KQZ apolitike dhe kuadri ligjor është në funksion të këtij qëllimi¹²². Madje, amendimi i bërë për përzgjedhjen e kryetarit të KQZ-së përgjatë reformës së fundit elektorale e përforcon këtë fakt.

¹¹⁹Kodi Zgjedhor, Neni 14 “Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së”

¹²⁰Vetë Gjykata Kushtetuese në traditën e vet të marrjes së vendimeve, termat shumicë dhe pakicë parlamentare i përdor si grupime që diferencojnë nga numra mandateve dhe nuk janë grupime politike. Në marrjen e vendimeve të saj vendos një shenjë mosbarazimi mes termit “ekzekutiv” apo “qeveri” dhe “shumicë parlamentare”. Një shembull për këtë është edhe vendimi me objekt “*Interpretimi përfundimtar i nenit 77 pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë*”. “... Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjet në duart e **pakicës parlamentare** për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt **ekzekutiv** dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë të mbajtësve të pushtetit. Në një sistem parlamentar, duke qenë se **qeveria** formohet nga **shumica parlamentare**, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, e drejta e kontrollit hetimor i është njohur sidomos pakicës, që duke i patur të kufizuara mjetet e saj, ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.” Vendimi Nr.18, datë 14.05.2003, i Gjykatës Kushtetuese.

¹²¹ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, Raporti i Parë i Ndërmjetëm i monitorimit 12 Shtator 2012 - 14 Mars 2013. Për më shumë tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=40&gj=sh>

¹²²“Anëtarët e KQZ-së nuk duhet të jenë politikë, ata janë administruesit e ligjit. Dhe nëse ata fillojnë ta perceptojnë veten si politikanë dhe të fillojnë të mbajnë fjalime më KQZ, atëherë rezultati behët shumë i qartë për mua që këtu se me çfarë KQZ-je kemi të bëjmë”. Pjesë e fjalimit të Konsulentit të Komisionit të Venecias, Nikolai Vulchanov, të mbajtur në takimin “Trashëgimia zgjedhore europiane. Kodi i praktikave të sjelljes së mirë, lidhur me çështjet elektorale”, datë 02.06.2012. <http://www.panorama.com.al/2012/07/03/%E2%80%9CAnetaret-e-kqz-te-jene-gjyqtare%E2%80%9D/>

Anëtarët e KQZ-së, në nisje të detyrës së tyre, në momentin e betimit deklarojnë se “Betohem në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe do të tregojë profesionalizëm në kryerjen e saj”¹²³.

Në rastin në fjalë, të qenurit të paanshëm pashmangshmërisht të bën edhe të pavarur. Anëtarët, duke gjykuar mbi subjektet të cilët i kanë propozuar dhe përzgjedhur, duke u treguar të paanshëm tregohen edhe të pavarur.

Gjithashtu, edhe procedura e përzgjedhjes së Kryetarit është një tregues në këtë pikë. Nëse 6 anëtarët janë të ndarë në mënyrë të barabartë për nga propozimi politik, Kryetari vjen në këto zgjedhje jo më me miratim politik, por si votë përcaktuese e shumicën vendimmarrëse, jashtë vullnetit të politikës¹²⁴.

Për më tepër, nëse do t’i referohemi një rezolute të miratuar nga Kuvendi menjëherë pas miratimit të Amendamenteve të Kodit Zgjedhor, më datën 19 Korrik 2012 (rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2011”, e cila u miratua me shumicë nga mazhoranca me 70 vota pro dhe me 58 vota kundër të opozitës) citohet se: “... Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2012, në mënyrë të veçantë fokusimin në këto drejtime: - Të forcojë pavarësinë dhe drejtimin kompetent të institucionit në zbatimin e kornizës ligjore të zgjedhjeve”¹²⁵.

7. Sjelljen e KQZ-së dhe ngërçin aktual

Komisionerët e KQZ-së që prej konstituimit më 26.10.2012, në përqindje tejet të madhe kanë patur një vendim-marrje unanime përsa i përket administrimit të teknikaliteteve të procesit zgjedhor.

Problematika në vendimmarrjen e tyre është vërejtur tek të gjithë aktet për të cilët subjektet politike kanë patur qëndrime të ndryshme duke ndikuar në një votim në bllok të komisionerëve, ku në njërin anë janë komisionerët e propozuar nga mazhoranca dhe në anën tjetër ata të propozuar nga opozita.

Madje, kryetarja e KQZ-së znj. Lefteri Lleshi (Luzi) ka deklaruar publikisht ekzistencën e presionit politik si dhe i ka kërkuar politikës të qëndrojë jashtë vendimmarrjes së KQZ-së si një institucion jopolitik¹²⁶.

¹²³Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 (ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012) “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 13 “Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së”.

¹²⁴Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 15, “Zgjedhja e Kryetarit të KQZ-së”

¹²⁵http://www.parlament.al/web/19_Korrik_2012_Rezolute_Per_vleresimin_e_veprimtarise_se_KQZ_se_per_vitin_2011_14584_1.php

¹²⁶ Fjala e Kryetares së KQZ-së, Lefterije Luzi (Lleshi), në konferencën “Mbështetja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zgjedhjet Parlamentare 2013 në Shqipëri”, e organizuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë. “Në asnjë moment, në këto pak muaj pune si Kryetare e KQZ-së, nuk kam vënë re që subjektet politike të gjejnë kurajë për të mos ushtruar presion politik në tavolinën vendimmarrëse të KQZ-së, dhe aq më pak të vlerësojnë votën individuale dhe ndonjëherë edhe vendimmarrjen kolegjiale të saj!”, datë 28.03.2013.

http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=410:njoftim-per-shtyp-27032013&catid=51:deklarata-2010&Itemid=158&lang=sq

Koalicioni në trajtimin që i bën shkaqeve të ngërçit të sotëm në KQZ dhe tërë historikut të ngërceve të mëparshëm, vëren se të gjitha ato kanë një kryefjalë: Një vullnet politik që prevalon gjithmonë mbi shtetin ligjor¹²⁷, pa diskutuar këtu një shtet të së drejtës (ndërkohë që gjithë reformat ligjorë kanë synuar të kundërtën, duke u përpjekur të largojnë KQZ-në prej vullnetit politik).

Kjo sjellje e klasës politike e konkretisht e dy partive të mëdha, Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste, ka vendosur dy standarte tejet negative përsa i përket pritshmërive në lidhje me të ardhmen e procesit zgjedhor:

- a) Përtëritja e ligjit për çdo zgjedhje sipas kërkesave të tyre të ngushta politike nuk i jep kohë ligjit të shfaqet në tërë efektet dhe problemet që krijon.
- b) Ligji ndërtohet për të zgjidhur një problem apo proces zgjedhor të rradhës dhe jo me largpamësi për të ngritur një infrastrukturë zgjedhore të përhershme.

Madje, KVV konstaton se dy partitë kryesore, përgjatë procesit të diskutimit të reformës elektorale, udhëhiqen nga principi i krijimit të sa më shumë dispozitave “mbrojtëse” apo boshllëqeve që mund të kthehen nesër në avantazhe sulmi ndaj kundërshtarit. Ndërkohë që në këtë proces ato duhet domosdoshmërisht të udhëhiqen në ndërtimin e një kuadri ligjor me rregulla të barabarta e të drejta për këdo, duke pasur si qëllim të vetëm interesat e vendit dhe respektimin katërcipërisht të vullnetit të shtetasve shqiptarë.

Sikundër konstatohet lehtë situata aktuale në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, është një ngërç i cili nuk ka asnjë argument, qoftë ligjor qoftë politik, për të ekzistuar.

Madje, ky ngërç po tërheq vëmendjen nga shumë elementë të rëndësishëm të procesit zgjedhor siç janë listat e zgjedhësve, teknologjia e re informative, fushata, etj.

Koalicioni e konsideron të pakuptimtë mungesën e deritanishëm të vullnetit për ta zgjidhur këtë ngërç, madje është i pamoralshëm përdorimi i tij për përfitime elektorale apo kredite politike qoftë tek faktorët ndërkombëtarë, qoftë tek militantët apo aktivistët tuaj, apo, qoftë edhe përdorimi i tij i mundshëm si shkak për të justifikuar fitoren apo humbjen pas 23 qershorit.

Koalicioni konstaton me keqardhje se Kodi Zgjedhor i ndërtuar dhe i miratuar nga dy partitë që Ju drejtoni është një Kod i cili varet kryekeput në çdo hallkë të tij nga vullneti politik, duke vënë pikëpyetje serioze mbi zbatimin e ligjit dhe ndërtimin e shtetit ligjor aq shumë të përmendur në programet tuaja politike.

I nderuar zoti Berisha dhe z. Rama!

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë nxit kurajon dhe vizionin tuaj për të kapërcyer interesat e ngushta partiake dhe ngërçet e panevojshme, duke u orientuar drejt interesit afatgjatë në të mirë të të gjithë shqiptarëve për ndërtimin e shtetit ligjor, të

¹²⁷Lirimi i Komisionerit Muho nuk është rasti i parë që sjell diskutime në lidhje me largimin e Komisionerëve të KQZ-së me shkak vullnetin politik. Bëhet fjalë për rastin e Komisionerit Maksim Shimani, i emëruar prej Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mandati kushtetues i të cilit në Nëntor të vitit 2004 u ndërpre, dhe ai u zëvendësua me Komisionerin Çlirim Gjata. Shkak për këtë ndërrim u bë dakortësia e dy forcave të mëdha politike për rivendosur balancat në KQZ-në e asaj kohe.

institucioneve të konsoliduara e të pavarura, në funksion të interesave dhe të të drejtave të qytetarëve.

Koalicioni ju fton të gjeni kurajën dhe vullnetin e duhur duke sjellë frymën e bashkëpunimit dhe të vlerësimit reciprok, duke e futur ecurinë e mëtejshme të procesit zgjedhor në shtratin e duhur ligjor si dhe duke nxitur më tej një fushatë të qetë, të qytetëruar si dhe të orientuar drejt përballjes së platformave programore dhe çështjeve konkrete në interes të qytetarëve.

Për Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë

Përfaqësuesit e organizatave Drejtuese

Gerta META
Drejtoresh Ekzekutive

Premto GOGO
Kryetar

Rajmonda PRIFTI
Drejtoresh Ekzekutive

**Shoqata për Kulturë
Demokratike**

KRIIK Albania

**Shoqata për Gratë
dhe Fëmijët**

Tiranë, më 14 Maj 2013!

ANEKS II**DEKLARATË****Fushata zgjedhore korrekte dhe zbatimi i ligjit domosdoshmëri për ushtrimin e lirë të vullnetit të votuesit**

Fushata zgjedhore është periudha më e rëndësishme e një procesi elektoral. Është kjo periudha kur nis gara mes subjekteve politike të cilat konkurojnë midis tyre për t'i prezantuar votuesve platformat elektorale, mbi bazën e të cilave kërkojnë votën dhe besimin e publikut.

Është kjo periudha kur të gjitha subjektet që janë regjistruar për të garuar monitorohen nga një sërë mekanizmash dhe dispozitash ligjore në funksion të respektimit dhe zbatimit të një parimi themelor dhe kushtetues atë të barazisë në përdorimin e mundësive dhe burimeve.

Kodi Zgjedhor parashikon fillimin e fushatës zgjedhore më datën 24 Maj 2013 (30 ditë para datës së zgjedhjeve) deri në datën 21 Qershor 2013, pas së cilës fillon heshtja elektorale.

Koalicioni e ka bërë bërë prezent edhe më parë¹²⁸ se fushata ka muaj që ka nisur prej gati të gjithë subjekteve politike¹²⁹.

Në përvojat botërore gjenden legjislacione që nuk e kufizojnë periudhën e fushatës zgjedhore. Por legjislatori ynë, me të drejtë, e ka parë me vend që ta kufizojë fushatën zgjedhore në një segment të caktuar kohor, për një sërë arsyesh ndër të cilat mund të përmendim lehtësitë që krijohen për: sigurimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve elektorale; shmangien e politizimit të administratës publike; shmangien e shfrytëzimit të burimeve të administratës publike; vëzhgimin e financave të subjekteve politike apo mbikqyrjen e mbulimit që i bën media fushatës zgjedhore, etj.

Pikërisht për të adresuar shqetësimet në lidhje me çështjet e sipërpërmendura, legjislatori ka hartuar dhe vendosur një numër të konsiderueshëm dispozitash në Kodin Zgjedhor. **Janë 32 pika dhe gërma në këtë Kod, të cilat vendosin afate kohore në lidhje me fushatën zgjedhore** dhe përcaktojnë zhvillimin e fushatës zgjedhore nga të gjithë aktorët pjesëmarrës¹³⁰ në proces si: Këshilli i Ministrave, Njësitë e Qeverisjes

¹²⁸ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, *Raporti i Parë i Ndërmjetëm i monitorimit 12 Shtator 2012 - 14 Mars 2013*. Për më shumë tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=40&gj=sh>

¹²⁹ Fushata zgjedhore kuptohet si një “aktivitet politik i ndërmarrë për të nxitur fitoren apo humbjen elektorale të një kandidati ose disa kandidatëve për një zyrë shtetërore”.

¹³⁰ Nenet në Kodin Zgjedhor: “Ndalimi i përdorimit të forcave dhe strukturave të posaçme” (Neni 5, pika 1 dhe 3), “Kompetencat e KQZ-së” (Neni 21, pika 15), “Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore” (Neni 77, pika 1), “Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës” (Neni 78, pika 1 dhe 5), “Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore në radiotelevizionin publik” (Neni 80, pika 1, 2 dhe 4), “Orari i transmetimeve” (Neni 83, pika 2), “Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private” (Neni 84, pika 1, 5 dhe 9), “Monitorimi i fushatës zgjedhore” (Neni 85, pika 1 dhe 6), “Mënyra e formimit të Bordit të Monitorimit të Medias” (Neni 85/1, gërma a, b dhe ç), “Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje” (Neni 87, pika 6 dhe 7), “Burimet e financimit të fushatës zgjedhore” (Neni 87/1), “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore” (Neni 88, pika 2), “Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike” (Neni 89, pika 1), “Regjistrimi i fondeve jopublike” (Neni 90, pika 2 dhe 3), “Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave” (Neni 93, pika 2/c), “Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës” (Neni 173, pika 1 dhe 3), “Plani i Veprimit për përdorimin e teknologjive të informacionit në zgjedhje” (Neni 179, pika 6).

Vendore, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, mediat private dhe Radio Televizioni Shqiptar, Bordi i Monitorimit të Medias, subjektet politike, etj.

Koalicioni vëren se pikërisht infrastruktura zgjedhore e cila ndërtohet në disa etapa dhe në një raport të caktuar me fushatën zgjedhore zhbëhet automatikisht kur vetë periudha e fushatës nuk respektohet.

Për më tepër **mbarëvajtja dhe mbikqyrja e kësaj fushate prej autoriteteve përgjegjëse del jashtë kontrollit, pasi ligji e rregullon këtë mbikqyrje dhe monitorim vetëm për një muaj nga rreth 6 muaj fushatë të zhvilluar tashmë.**

Kjo situatë e jashtëligjshme adreson përgjegjësi të cilat duhen marrë dhe zhvilluar në zbatim të ligjit nga “qeveria” organizatore e procesit zgjedhor që është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Pavarësisht faktit se janë gati të tërë subjektet politike e kanë injoruar dhe shkelur ligjin duke e goditur procesin zgjedhor, është përgjegjësia e KQZ-së për një “*Maxi Proceso*” apo gjykim të të gjithë palëve, duke ushtruar autoritetin e dhënë nga ligji.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë nxit dhe mbështet Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për të vënë gjithë këtë proces në shina ligjore, duke marrë masa dhe vendosur sanksione administrative ndaj të gjitha subjekteve politike që kanë shkelur afatin e çeljes së fushatës zgjedhore, në zbatim të Nenit 171 pika 2 e cila përbën bazën e nevojshme ligjore¹³¹.

Nga monitorimi i bërë gjithë procesit para-elektoral të deritanishëm si dhe me shqetësimin për të filluar më datë 24 Maj një fushate zgjedhore në respekt dhe zbatim të plotë të ligjit, Koalicioni sjell në vëmendje të të gjithë aktorëve :

1. Ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

Koalicioni konstaton se kuadri ligjor i sotëm është i plotë dhe përbën një garanci që duhet të shfrytëzohet maksimalisht si një mjet efikas për të ndaluar përdorimin e burimeve publike nga subjektet zgjedhore.

Kodi Zgjedhor vetëm në periudhën e fushatës zgjedhore, pra nga 24 Maji deri më 21 Qershor, sipas Nenit 88 pika 1 parashikon se “... **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota...**”.

Kodi gjithashtu shpjegon se, në kuptim të nenit të mësipërm, “...“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...”.

Vetëm gjatë kësaj periudhe dhe vetëm gjatë orarit zyrtar, sipas pikës 2 të Nenit 88, Kodi citon se ndalohet “... përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore...”.

¹³¹ Neni 171, pika 2 e Kodit Zgjedhor : “Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë nga 1000 deri në 2500 lekë”.

Po ashtu, **vetëm gjatë kësaj periudhe, sipas Nenit 88 pika 3, jepet garanci për nëpunësit e administratës** pasi “*e ndalon gjatë fushatës zgjedhore marrjen në punë, pushimin nga puna, lirim, lëvizjen dhe transferimin në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura*”¹³².

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor ofron garanci në veçanti për mos abuzim me burimet e administratës vetëm gjatë fushatës zgjedhore, Koalicioni sjell në vëmendje **garancitë që ofrohen dhe jepen nga Kodi Penal të cilat nuk janë të kufizuara në kohë dhe janë të vlefshme në çdo kohë.**

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë me ndryshimet e kryera me konsensus politik në vitin 2012, ka sjellë risi mbi mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore, sidomos në nenet 328 dhe 328/a.

Në nenin 328/a, të shtuar në amendimet e fundit të **Kodit Penal**, në mënyrë “*eskplícite*” **ndalohet detyrimi dhe përdorimi i nëpunësve të administratës shtetërore në aktivitete elektorale**¹³³, madje sanksioni i parashikuar për këtë kryerje të veprës është dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Gjithashtu, **neni 328 parashikon “dënimin” e shit-blerjes së votës në dyja kahet.**

Konkretisht sipas tij, jo vetëm që ndalohet ofrimi i shpërblimeve apo premtimeve për “*të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime*”, por edhe “*pranimi i të hollave, të mirave materiale, premtimeve dhe favorizimeve të tjera kundrejt kryerjes së veprimeve të mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë*”¹³⁴.

Këto muaj fushata zgjedhore “*pre-mature*” ka sjellë në vëmendjen e mediave dhe publikut shqetësime mbi veprimtarinë e subjekteve politike. Mediat dhe forcat opozitare ngrenë dita-ditës shqetësime për përdorim të burimeve të administratës shtetërore apo shkelje të tjera.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka informacione të besueshme, për raste ku administrata shtetërore imponohet për tu bërë pjesë e fushatës elektorale pas

¹³² Neni 88, pika 3 e Kodi Zgjedhor: “*Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë*”.

¹³³ Neni 328/a i Kodit Penal “*Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Detyrimi apo organizimi për të marrë pjesë në veprimtari elektorale të një subjekti zgjedhor i nxënëseve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.*”

¹³⁴ Neni 328 i Kodit Penal “*Ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet. Pranimi i të hollave, të mirave materiale, premtimeve dhe favorizimeve të tjera kundrejt kryerjes së veprimeve të mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.*”

orarit zyrtar apo për të marrë pjesë në takime elektorale të liderëve politikë, apo për raste të tjera në shkelje të ligjit.

Koalicioni vëren me shqetësim dhe **tërheq vëmendjen e titullarëve të institucioneve** që të mos përdorin pozicionin shtetëror apo zyrtar në varësi për t'i përdorur për fushatë politike të partisë ku aderojnë.

Në veçanti, **Koalicioni i kërkon anëtarëve të Këshillit të Ministrave** që të mos përdorin foltoret, zëdhënësit apo faqet zyrtare të ministrive të tyre për të bërë politika partiake apo denigruar kundërshtarët politikë¹³⁵.

Koalicioni nxit të gjithë aktorët politikë ose jo si edhe qytetarët që të denoncojnë pranë organeve kompetente të gjitha rastet e abuzimit me ligjin nga ana e subjekteve elektorale apo nga pushtetarë.

Madje Koalicioni tërheq vëmendjen se shqetësimet e ngritura në media deri më sot dhe në vazhdim **duhet të përbëjnë indicie për Prokurorinë, si trupa përgjegjëse e të hetuarit në Republikën e Shqipërisë.**

Është kjo e fundit, që mbart një përgjegjësi të madhe që një kuadër ligjor në këtë pikë të plotë, ta vendosë në mbrojtje të qytetarëve.

2. Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga media dhe pavarësia e saj.

Media, pavarësisht fillimit në mënyrë joligjore të fushatës, ka transmetuar gjerësisht takimet elektorale të subjekteve zgjedhore si dhe spotet elektorale të disa prej tyre, përmendim këtu spotin elektorale të Partisë Demokratike, i cili ka filluar të transmetohet përpara disa ditësh.

Transmetimi i parakohshëm i spoteve elektorale prek barazinë në kohën e transmetimit të spoteve elektorale midis subjekteve zgjedhore, duke favorizuar në kohë mediatike subjekte të caktuara.

Transmetimi në këtë kohë **ndodh në një boshllëk ligjor, pasi sipas Kodit Zgjedhor vetëm pas datës 24 Maj**, kur fillon zyrtarisht periudha e fushatës zgjedhore, Bordi i Monitorimit të Medias por edhe vetë operatorët mediatikë në zbatim të dispozitave dhe kohës së parashikuar për çdo subjekt, kujdesen që

¹³⁵ - Ministria e Arsimit, Njoftim për Shtyp i vendosur në faqen zyrtare të internetit me datë 29.04.2013: “Sot zoti Rama lëshoi nga selia e tij mavi sulme të padëgjueshme ndonjëherë, këtë radhë ndaj fëmijëve dhe të rinjve, duke u thënë që 57 përqind e tyre janë analfabetë. ... Zoti Rama gjithashtu i ka fyer ata duke u thënë se atyre u intereson vetëm të pijnë, të lozin kumar dhe të jenë në Facebook... . Partia Demokratike beson se ky brez është ndër më të talentuarit, inteligjentët dhe motivuarit në historinë e kombit, se ata meritojnë zgjidhje konkrete për të vazhduar përpara me shkollimin dhe jo pranojnë e durojnë ofendimet djallëzore të zotit Rama, të prodhuara nga salloni i tij mavi”. Për më shumë tek: <http://www.mash.gov.al/njoftim.php?id1=12&id=391>

- Ministrin Olldashin reagon ndaj një deklarate të Edi Ramës me një deklaratë në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit: “Reagim i ministrit Olldashi ndaj deklaratës së Edi Rames. Olldashi: Ky qenka me karavidhe se Pandi!”. Për më shumë tek: <http://www.mppt.gov.al/>.

- Kryetari i Bashkisë së Vlorës z. Shpëtim Gjika në një deklaratë për mediat pozicionet si funksionar partiak dhe sulmon një kandidat të pavarur: “... Ne, si përfaqësues të mandatuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë e të zgjedhur me votë popullore në pushtetin vendor, në emër edhe të të gjitha strukturave të PS në Vlorë... . Ndaj ju bëjmë thirrje z. Malaj, të hiqeni mënjatë e të mos na futeni në mes, se rrezikoni të bëheni parzmorë e mburojë e Sali Berishës. Ne e kemi të qartë se çdo votë që mund të marrësh ti, është votë pro Sali Berishës... .”. Për më shumë tek: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/05/16/shpetim-gjika-socialistet-e-vlores-nuk-do-ta-mbeshtesin-arben-malaj-n-votat-e-tij-shkojne-per-pd/>.

koha mediatike të jetë e barabartë dhe në respekt të dispozitave ligjore të parashikuara.

Transmetimi i parakohshëm i këtyre spoteve prek barazinë në garën elektorale, ndaj Koalicioni i bën thirrje **Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të gjejë hapësirat që i ofron ligji dhe të marrë masa për ndalimin e menjëhershëm të transmetimit** të tyre si dhe masat e parashikuara administrative ndaj subjektit elektoral përkatës.

Gjithashtu, Koalicioni ka konstatuar se në disa prej mediave audivizive prej ditësh po shfaqet **një spot (reklamë televizive) e Ministrisë së Mbrojtjes mbi “anëtarësimin e Shqipërisë në NATO”**.

Koalicioni vëren se ky **transmetim është në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor**, i cili në Nenin 84 pika 10 sanksionon se “*institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, u ndalohen reklamat, me përjashtim të atyre që i shërbejnë qëllimit të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për aspekte të procesit zgjedhor ose njoftime të tjera të parashikuara nga ligji*”.

Ndaj Koalicioni i kërkon Ministrisë së Mbrojtjes që ta ndalojë urgjentisht këtë transmetim si dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të marrë masat sanksionuese përkatëse.

Ndërkohë, pasqyrimi i fushatës zgjedhore që nis më datën 24 maj 2013, nga operatorët mediatikë shtetërorë dhe privatë zhvillohet me një bazë ligjore të përmirësuar nga reforma elektorale e Korrikut të vitit 2012.

Me synim mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit, **Koalicioni fton Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve që të informojë nëpërmjet një Njoftimi për Shtyp të gjithë operatorët mediatikë**, qendrorë apo lokalë, shtetërorë apo privatë mbi risitë e këtyre ndryshimeve e në veçanti në lidhje me mbikqyrjen e mbulimit që do t’i bëjë media fushatës zgjedhore.

Ky njoftim duhet parë si një detyrim dhe përgjegjësi e KQZ-së për të rritur vëmendjen mbi zbatueshmërinë e ligjit, por **sidomos për të shmangur goditjen e qëllimshme apo të njëanshme të operatorëve mediatikë**, e cila përbën kërcënim serioz për lirinë dhe pavarësinë e medias në vend.

Instrumenti ligjor i parashikuar në këtë rast mund të kthehet lehtësisht nga instrument monitorimi në një mjet presioni.

Konkretisht, në rast të mos respektimit të raporteve kohore në minutazhin politik të edicioneve informative të operatorëve privatë, tashmë nuk është vetëm Bordi i Monitorimit të Medias që i propozon KQZ-së vendosjen e gjobave, por është **vetë KQZ e cila kryesisht apo me propozimin e KZAZ-ve, në çdo kohë, ka të drejtë gjobisë operatorin radioteleviziv**¹³⁶.

¹³⁶ Neni 84, pika 2 gërma “a” e Kodit Zgjedhor: “*Minutazhi politik i edicioneve informative ndahet në raporte kohore, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 81 të këtij Kodi. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie, KQZ-ja, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1 500 000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3 000 000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, KQZ-ja urdhëron KKRT-në të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 1800 e ditës pasardhëse*”.

Dispozita nuk përcakton limite të masës së shkeljes, pra mjafton që koha mos të jetë e barabartë, dhe një KZAZ ka të drejtë që t'i propozojë KQZ-së gjobitjen e një operatori televiziv.

Nga ana tjetër duke qenë se KZAZ-të mund ta marrin një vendim të tillë në gjysmën e tyre vetëm me katër vota të mazhorancës dhe në gjysmën tjetër vetëm me katër vota të opozitës, **ekziston hapësira e kanosjes apo goditjes për shkaqe me natyrë politike ndaj operatorëve të ndryshëm televizivë**, me gjoba të cilat sikundër parashikohen në ligj janë në shifra të konsiderueshme.

Në Nenin 84 pika 1, **legjitimohet tashmë përdorimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore** për të përgatitur dhe transmetuar informacione mbi aktivitete të tyre gjatë fushatës zgjedhore, në edicionet informative të radio-televizioneve private¹³⁷.

Në këtë rast Kodi kërkon që këto informacione që do të transmetohen duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.

Ndaj **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet urgjentisht të miratojë një udhëzim** në përmbushje të kësaj dispozite sa më parë, përpara fillimit zyrtar të fushatës më 24 Maj 2013.

Po ashtu Neni 84 pika 6 parashikon se *“Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t’ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore.”*

Në zbatim të kësaj dispozite **Kodi i kërkon Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit si dhe Ministrin të Financave që të nxjerrin udhëzimet përkatëse.**

Sërisht, Koalicioni iu kërkon institucioneve të lartpërmendura që të miratojnë udhëzimet përkatëse sa më parë, përpara fillimit zyrtar të fushatës elektorale.

Në përfundim Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë **nxit dhe mbështet Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve që të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe autoritetin e vet për zbatimin me përpikmëri të ligjit**, duke siguruar një fushatë zgjedhore konform dhe në përmbushje të plotë të legjisllacionit në fuqi.

Gjithashtu, Koalicioni iu kërkon të gjithë subjekteve politike dhe institucionale që në zbatim të Kodit Zgjedhor si dhe të Urdhrit të Kryeministrit të datës 8 Prill 2011, të zhvillojnë një fushatë të qetë dhe të qytetëruar duke iu **siguruar të gjithë votuesve komoditetin dhe informacionin e nevojshëm në mënyrë që ditën e votimit ata të shprehin në liri të plotë vullnetin e tyre.**

Tiranë, më 18 Maj 2013!

137 Neni 84, pika 1 e Kodit Zgjedhor: *“Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private” “1. Në radiot dhe televizionet private, pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative. Radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre. Informacionet mbi aktivitete të fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative, bazuar në materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore, duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së”*.

ANEKS III**DEKLARATË****Transparenca e financimit të subjekteve elektorale
element kyç për një proces zgjedhor ligjor, transparent dhe të barabartë**

Rregullimi i financimeve të partive politike dhe fushatave zgjedhore janë një faktor shumë i rëndësishëm për të siguruar një proces të rregullt zgjedhor¹³⁸.

Këto financime para së gjithash duhet të jenë transparente dhe duhet të dokumentohen, merren dhe shpenzohen në zbatim të plotë të dispozitave ligjore të parashikuara.

Kuadri ligjor për partitë politike ka patur përmirësime përsa i përket financave. Me ndryshimet e bëra në “*Ligjin për Partitë Politike*” nëpërmjet Ligjit Nr. 10374, datë 10.02.2011, dhe me Vendimin Nr.188, datë 15.04.2013, të marrë nga Komisioni Qëndror të Zgjedhjeve, sigurohet në mënyrë të plotë auditim i veçantë i financimit të partive politike, edhe përgjatë vitit kalendarik, edhe përgjatë fushatës zgjedhore.

Financimet e partive politike për të zhvilluar fushatat zgjedhore vijnë nga buxheti i shtetit, kontributet nga anëtarësia, donatorët privatë dhe kreditë nga bankat.

Konkretisht në Kodin Zgjedhor parashikohet se:

Kodi Zgjedhor i kanalizon të ardhurat për fushatat zgjedhore në katër katetori:

- a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore.*
- b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit.*
- c) dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna.*
- ç) kreditë e marra nga partitë politike sipas ligjit.*

Për sa i përket donatorëve privatë qofshin persona fizikë apo juridikë, për dhurimet për fushatën zgjedhore, vendosen disa kushte.

Kodi Zgjedhor në neni 89 ndalon dhënien e fondeve:

- a) nga çdo person fizik ose juridik në shuma më të mëdha se 1 milion lekë ose kundërvlehtë në sende ose shërbime.*
- b) nga çdo person fizik ose juridik që ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë.*
- c) çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtari në fushën e medias.*
- d) çdo person fizik ose juridik që ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme.*
- e) çdo person fizik ose juridik që ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.*

Ndërsa përsa i përket subjekteve zgjedhore, Kodi Zgjedhor vendos disa kushte të tjera në lidhje më çështjet e tyre financiare nga të ardhura jo publike.

Sipas nenit 90 të Kodit Zgjedhor subjekteve zgjedhore i vendosen këto detyrime:

- a) të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit.*
- b) dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor.*

138 Pika 107 e 108 e Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore [CDL-AD (2002) 23 rev], Komisioni European për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias).

Pika 109. “... Në rastin e devijimeve nga norma ose në rast se tejkalohe kufijtë e detyrueshëm të financimit, zgjedhjet duhet të anulohen. ...”

c) shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike.

Kontrolli ndaj financave që lëvizën përgjatë fushatës zgjedhore ushtrohet nëpërmjet një mekanizmi ligjor i cili mbikqyret nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. “Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar”¹³⁹.

Në pikën 3 të nenit 91, Kodi Zgjedhor i jep një hapësirë të madhe veprimi auditëve¹⁴⁰ që verifikojnë pasqyrat financiare të subjekteve elektorale. Sipas tij, ata janë të plotfuqishëm t’i kërkojnë subjekteve zgjedhore çdo informacion që i nevojitet në punën e tyre.

Por, Koalicioni vëren se as legjislatori dhe as KQZ në udhëzimet e miratuara nuk i jep audituesit të gjitha mjetet e nevojshme për ta përdorur këtë hapësirë dhe liri në punën e tyre.

Nga monitorimi në vazhdimësi i proceseve zgjedhore të 2009 dhe 2011, dhe të auditimeve financiare të kryera ndaj subjekteve pjesëmarrëse në to, konstatohen një sërë rastesh me shkelje, të evidentuara në raportin e auditëve sikundër janë:

- pamundësia e komunikimit dhe e kontaktit direkt me subjektin elektorale¹⁴¹;
- ushtrimi i aktivitetit elektorale nga parti pa numër NIPT-i¹⁴², çka është një detyrim ligjor për çdo subjekt juridik;
- deklarimi i pasqyrave financiare të pashoqëruara me fatura tatimore sikundër parashikohet nga ligji¹⁴³ apo pa fatura fare¹⁴⁴;

¹³⁹ Neni 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor

¹⁴⁰ Neni 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor: “Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion çdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin ose të autorizojnë auditorin për tërheqjen e tyre nga të tretët. KQZ-ja vë në dispozicion të auditorit në çdo fazë të auditimit informacionet që i paraqiten nga të tretët mbi objektin e auditimit.”

¹⁴¹ Sipas informacionit të depozituar në KQZ nga auditi i autorizuar ka qenë shumë i vështirë kontakti me Partinë Aleanca e Maqedonasve për Integritim Europian. Kontakti u bë i mundur pas shumë përpjekjesh nëpërmjet telefonit me kryetari e partisë, i cili po nëpërmjet telefonit i deklaroi auditit se partia e tij nuk ka përdorur fonde në Fushatën Zgjedhore 2009, madje nuk kishte as financiar partie në atë kohë. Për më shumë tek raporti i auditit: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/fin_subjekteve/rap_auditimi%20ne%20pdf/amie.pdf

¹⁴² Sipas raportit të auditit të bërë ndaj Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, rezultoni se përveçse deklarohet se nuk ka pasur asnjë të ardhur dhe nuk ka kryer asnjë shpenzim gjatë fushatës elektorale të Zgjedhjeve Lokale të 8 Majit 2011, kjo parti nuk është as e regjistruar në organet e tatim-taksave dhe nuk është e pajisur me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatuësëm (NIPT). Për më shumë tek raporti i auditit: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-vendore/2011/raportet_auditimi/partite_politike/15_PMDE.pdf

¹⁴³ - Sipas raportit të auditit të bërë ndaj Partisë Aleanca për Demokraci e Solidaritet, për Fushatën Zgjedhore 2009, evidentohet se “... subjekti duhet të tregojë kujdes në lidhje me vërtetimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve të kryera me dokumente justifikues sipas kërkesave të ligjeve fiskale (tatimore), ...”. Për më shumë tek raporti i auditit: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/fin_subjekteve/rap_auditimi%20ne%20pdf/ads.pdf.

- Raporti i auditit ndaj Partisë Agrare Ambientaliste, për Fushatën Zgjedhore 2009: “... tërheq vëmendjen se subjekti duhet të tregojë kujdes në lidhje me vërtetimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve të kryera me dokumente justifikues sipas kërkesave të ligjeve fiskale (tatimore), ...”. Për më shumë tek raporti i auditit: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/fin_subjekteve/rap_auditimi%20ne%20pdf/paa.pdf. Etj.

¹⁴⁴ Raporti i auditit ndaj Partisë Aleanca Demokratike për Fushatën Zgjedhore 2009: “...nuk kam ndonjë vrejtitje me perjashtim të mungesës së faturave për shpenzimet e dhena Qarqeve që akoma nuk ishin terheq faturat e shpenzimeve të cilat duhet të ishin në sektorin e finances”. Për më shumë tek raporti i

- apo deklarimi i shpenzimeve zero gjatë aktivitetit elektoral të partisë, etj.
Madje ka raste kur auditimet e subjekteve elektorale publikohen të paplota¹⁴⁵ në faqen zyrtare të KQZ sikundër është detyrimi ligjor, apo nuk publikohen fare¹⁴⁶.

Pavarësisht shkeljeve të vërejtura, vërehet se deri më sot, KQZ nuk ka marrë asnjë masë ligjore në këtë drejtim, madje është treguar e pakujdesshme në ushtrimin e autoritetit dhe të funksionit të vet në përmbushje të ligjit, ndërkohë që sipas ligjit¹⁴⁷ është KQZ e cila “monitoron, mbikëqyr dhe auditon financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre” dhe është sërish KQZ e cila ngarkohet nga ligji për të vendosur sanksione¹⁴⁸ kur konstaton shkelje të dispozitave të ligjit të sipërpërmendur.

Situata aktuale në këtë drejtim bëhet akoma më pak e kontrolluar duke pasur parasysh edhe një mangësi të vetë Kodit Zgjedhor. Sipas tij, dhuruesit e shumave mbi 100 mijë lekë duhet ta kryejnë kalimin e parave “vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor”.

Në funksion të kësaj kërkesë të ligjit, subjekti zgjedhor “jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim”.

Nga këto dy dispozita lind një problematikë jo e vogël, që sidomos në këtë proces zgjedhor shfaqet qartazi.

Një subjekt zgjedhor, qoftë i vogël apo i madh, lëvizjet e veta financiare sidomos ato të rëndësishmet i bën para fillimit të fushatës¹⁴⁹. Nëse vëzhgimi i tyre fillon tre ditë pasi

auditit: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/fin_subjekteve/rap_auditimi%20ne%20pdf/ad.pdf

¹⁴⁵ Raporti i auditit të Partisë Forca Albania për Fushatën Zgjedhore 2009, *Për më shumë tek:* http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/fin_subjekteve/rap_auditimi%20ne%20pdf/pfa.pdf

¹⁴⁶ Partia Rruga e Lirisë me numër rendor 18, Lidhja Demokristiane Shqiptare me numër rendor 28, Partia e Çështjeve Shqiptare me numër rendor 50, për Fushatën Zgjedhore 2011. *Për më shumë tek:* http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=304%3Araportet-audit&catid=126%3Asubjektet-zgjedhore&Itemid=315&lang=sq.

¹⁴⁷ Neni 15/2 pika 2 gërma “ç” e Ligjit nr.10374, datë 10.2.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar”.

¹⁴⁸ Neni 23/4 i Ligjit nr.10374, datë 10.2.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar”, pika: “2. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

3. Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar a të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 5 000 000 lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

4. Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë”.

¹⁴⁹ Në këtë pikë përmendim dy shembuj nga dy raporte të auditëve për zgjedhjet e vitit 2009.

- Pjesë e raportit të audituesit Mihal Ziu, datë 01.11.2009 ndaj Partisë Socialiste: “Fushata për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë ka filluar më 28 Maj 2009 dhe ka mbaruar më 28 Qershor 2009. **Aktiviteti financiar në shërbim të kësaj fushate shtihet në një periudhë më të gjatë se ky kufi zyrtar.** Për Partinë Socialiste periudha financiare e fushatës zgjedhore shtrihet në muajt Maj-Qershor-Korrik dhe, më tej këtij kufiri, priten ngjarje të mëvonëshme lidhur me arkëtimin e kështit të dytë të financimit buxhetor dhe për pagesën e disa shpenzimeve të kryera e të faturuara nga disa furnitorë gjatë fushatës zgjedhore.”

- Pjesë e raportit të audituesit Lavdimi Fusha, datë 02.11.2009 ndaj Partisë Demokratike: “Kalimi i një pjese të dhurimeve mbi 100 mijë lekë me arkë dhe jo me bankë si kërkesë e Kodit Zgjedhor, ka ardhur si rezultat i financimeve para fillimit të fushatës zgjedhore dhe para vendimit nr.2666, ora 18:00 të Komisionit Qendror Zgjedhor për miratimin e formatit të deklaratës.”

vetë fushata ka filluar, atëherë nuk ka mbetur shumë për t'u mbikëqyrur në lëvizjet financiare të partive.

Aq më tepër në rastin e këtij procesi zgjedhor, ku fushata zgjedhore ka nisur rreth gjashtë muaj para datës kur do të mbahen zgjedhjet.

Në këtë situatë problematike dhe me këtë kuadër ligjor i cili lejon “*rrjedhje*” në pasqyrimin e financave të subjekteve zgjedhor gjatë fushatës, është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, i cili në përmbushje të misionit dhe kompetencave të dhëna si dhe në frymën e ligjit, duhet të luajë rolin e tij madhor, jo vetëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur nga afër financimet e partive politike, por edhe të ndërmarrë hapat e duhur në hartimin e udhëzimeve plotësuese që të mund të vënë në lëvizje verifikimin dhe funksionimin e plotë të mekanizmit kontrollues të parashikuar nga ligji.

Koalicioni nxit dhe mbështet KQZ që sa më parë të plotësojë udhëzimin për mënyrën e funksionimit të auditëve dhe përmbushjen e detyrës së tyre.

Ky udhëzim duhet të parashikojë mekanizma të qarta që të detyrojnë auditin që në rast të mos ofrimit të gatishmërisë apo informacionit të kërkuar nga subjektet elektorale të njoftojnë zyrtarisht KQZ-në, e cila duhet të marrë masa të menjëhershme sipas legjislacionit në fuqi.

Po ashtu, KQZ duhet të përcaktojë qartë mekanizma për të mbështetur fort auditët në punën dhe ekspertizën e tyre, por njëkohësisht duhet të parashikojë edhe sanksione për raportim jo profesional apo jo korrekt nga ana e tyre.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në përmbushje të Nenit nr. 90 të Kodit Zgjedhor, duhet të miratojë urgjentisht me vendim modelin e regjistrimit të posaçëm për regjistrimin e fondeve të përfituara nga subjektet zgjedhore prej donatorëve private¹⁵⁰, pasi modeli i cili përdoret aktualisht i miratuar me vendimin nr. 266 datë 01/06/2009, ka qenë i specifikuar për tu përdorur për zgjedhjet parlamentare të vitit 2009.

Koalicioni i kërkon KQZ që të publikojë sa më parë raportet e auditëve mbi Raportet Financiare Vjetore për vitin 2012 për të gjitha Partitë Politike, pasi afati i parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin për Partitë Politike, ka kaluar, ndërkohë që në faqen Zyrtare të KQZ-së janë të publikuara vetëm Raportet Vjetore të pesë partive.

Në përfundim, Koalicioni nxit Partitë Politike që të zbatojnë katërcipërisht dispozitat ligjore në përdorimin e financave të tyre, veçanërisht përgjatë fushatës zgjedhore, si dhe të japin kontributin e tyre në rritjen e transparencës në përdorimin e këtyre fondeve për një proces zgjedhor ligjor, transparent dhe të barabartë.

Tiranë, më 23 Maj 2013!

¹⁵⁰ Neni 90 i Kodit Zgjedhor “Regjistrimi i fondeve jopublike”, pika 1: “Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi.”

Kontakt:

i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

Gerta Meta (Shoqata për Kulturë Demokratike) mob. 0692469393
Rajmonda Prifti (Shoqata për Gratë dhe Fëmijët) mob. 0682152667
Premto Gogo (KRIIK Albania) mob. 0682039297

Tel/fax: + 355 4 2245078;

E-mail: info@zgjedhje.al
koalicioni2013@gmail.com;

Website: www.zgjedhje.al;